Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

RAPORTI VJETOR 2017

Prishtinë, mars 2018

Adresa: Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

PËRMBAJTJA

1 ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI 9

1.1 Përshkrimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji 9
1.2 Struktura organizative dhe burimet njerëzore 9
1.3 Bordi i ZRRE-së 11
1.4 Departamentet e ZRRE-së 12
1.5 Trajnimi i stafit të ZRRE-së 13
1.6 Projektet e asistencës teknike 13
1.7 Aktivitetet e prokurimit 14
1.8 Financimi i ZRRE-së 14

2 AKTIVITETET E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI 15

2.1 Kompletimi i kornizës ligjore dhe rregullative 15
2.2 Licencimi i aktiviteteve të energjisë 16
2.3 Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) 18
2.4 Autorizimi - ndërtimi i kapaciteteve të reja 19
2.5 Monitorimi i ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese 25
2.6 Kontestet gjyqësore 27
2.7 Bilanci vjetor i energjisë elektrike dhe termike 29
2.8 Aktivitetet e ZRRE-së në fushën e rregullimit të çmimeve 29
2.9 Nxitja e prodhimit të energjisë elektrike nga BRE 37
2.10 Procesi i certifikimit të OST 38
2.11 Monitorimi i tregut 39
2.12 Monitorimi i ndërprerjeve të energjisë elektrike 40
2.13 Aktiviteti i ZRRE-së në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve 40

3 BASHKËPUNIMI ME PALËT TJERA DHE TRANSPARENCA 45

3.1 Raportimi dhe bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës 45
3.2 Bashkëpunimi me palët tjera dhe aktivitetet e partneritetit 45
3.3 Pjesëmarrja e ZRRE-së në aktivitetet ndërkombëtare 46
3.4 Transparenca dhe përfshirja e publikut në proceset rregullative 52

4 RAPORTIMI FINANCIAR PËR ZRRE 54

4.1 Buxheti i ZRRE-së 54

5 SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE 59

5.1 Karakteristikat e sektorit të energjisë elektrike 59
5.2 Prodhimi dhe konsumi i linjitit 63
5.3 Prodhimi i energjisë elektrike 64

5.4 Sistemi i transmetimit 68
5.5 Sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike 79
5.6 Furnizimi me energji elektrike 86
5.7 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike 90
5.8 Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike 97

6 SEKTORI I ENERGJISË TERMIKE 109

6.1 Zhvillimet kryesore në sektorin e energjisë termike 109
6.2 Karakteristikat teknike të sistemeve të energjisë termike 110
6.3 Përformanca e ndërmarrjeve të energjisë termike 111
6.4 Prodhimi, furnizimi dhe humbjet e gjithmbarshme të energjisë termike 115
6.5 Faturimi, arkëtimi dhe sipërfaqja e ngrohjes 115

7 SEKTORI I GAZIT NATYROR 118

7.1 Perspektiva e zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Kosovë 118

Lista e shkurtesave

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AERS	Rregullatori i Serbisë
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
CCP	Customer Care Programme (Programi për përkujdesje të konsumatorëve)
CEER	Këshilli i Rregullatorëve Evropian për Energji (Council of European Energy Regulators)
DETG	Departamenti për energji termike dhe gaz;
DLL	Departamenti ligjor dhe i licencimit
DMK	Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve
DTÇ	Departamenti i tarifave dhe i çmimeve
DTE	Departamenti për treg të energjisë
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
EC	European Commision (Komisioni Evropian)
EMS	Operatori i Sistemit të Transmetimit të Serbisë
SKE	Energy Community Secretariat (Sekretariati i Komunitetit të Energjisë)
ECRB (BRKE)	Energy Community Regulatory Bord (Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë)
EJL	Evropa Juglindore
ENS	Energy Not Supplied (Energjia e pafurnizuar)
ENTSO-E	Europian Network of Transmission System Operators for Electricity (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energji Elektrike)
GPG	Grupi Punues për Gaz
GPNL	Grupi i përhershëm i nivelit të lartë (Permanent High Level Group - PHLG)
GWh	Gigavatorë
HC	Hidrocentral
IAP	Ion-Adriatik-Pipeline – Gazsjellësi Përtej Adriatikut
ITC	Inter TSO Compensation (Kompensimi ndërmjet OST-ve)
KE	Komuniteti i Energjisë
KEEJL	Komuniteti i Energjisë në Evropën Juglindore
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KESH	Korporata Energjetike e Shqipërisë
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim me energji elektrike/Kosovo Electricity Distribution and Services
KESCO	Kompania për furnizim me energji elektrike e Kosovës (Kosovo Electricity Supply Company)
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KM	Këshilli i Ministrave
km	Kilometër
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut
KPSC	Komisioni Rregullativ për Shërbime Publike
kV	Kilovolt
kW	Kilovat
LP	Largpërçues
HLM (MAR)	Të Hyrat e Lejuara Maksimale

MAP	Ministria e Administratës Publike
MBE	Marrëveshja për Blerjen e Energjisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MVA	Megavoltamper
MW	Megavat
MW_{TH}	Megavat termik
MWh	Megavatorë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NARUC	National Association of Regulatory Utility Commissioners (Asociacioni Nacional i Komisionarëve të ndërmarrjeve Rregullative)
NQ	Ngrohje Qendrore
NS	Nënstacioni
OSSH	Operator i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operator i Sistemit të Transmetimit
OT	Operator Tregu
PECI	Projects of Energy Community Interest (Projekti i Interesit të Komunitetit të Energjisë)
PG TSO KOSTT	Grupi punues për inkuadrimin e KOSTT në ENTSO-E
RG CE	Grupi Rajonal i Evropës Kontinentale
RoR	Rate of Return (Norma e kthimit)
RAB	Regulated Asset Base (Baza e Rregulluar e Aseteve)
SCADA	Supervisory Control and Data Acquisition (Sistemi Mbikëqyrës dhe i Mbledhjes së të Dhënave)
SAIDI	Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjeve në sistem
SAIFI	Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve në sistem
TAP	Trans-Adriatik-Pipeline – Gazsjellësi Përtej Adriatikut
TC	Termocentral
TF	Task Forcë
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
TR	Transformator
TM	Tensioni i Mesëm
TU	Tensioni i Ulët
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA	Udhëzimi administrativ
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
WACC	Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit (weighted average cost of capital)
WBIF	Western Balkans Investment Framework (Korniza për Investime në Ballkanin Perëndimor)
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejmë ZRRE), në përputhje me detyrimet e përfshira në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 05/L-084), paraqet Raportin Vjetor për vitin 2017 për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Raporti Vjetor përmban informata mbi aktivitetet e ndërmarra dhe rezultatet e arritura në lidhje me fushëveprimin e ZRRE-së, si dhe analiza rreth aktiviteteve të ndërmarrjeve të energjisë, sipas të dhënave të licencuarve, si dhe paraqet një pasqyrë të zhvillimit të tregut të energjisë në Kosovë. Pjesë përbërëse e këtij raporti është gjithashtu edhe Raporti financiar i buxhetit të ZRRE-së për vitin 2017.

ZRRE gjatë vitit 2017 (në pesë muajt e parë derisa bordi ka qenë funksional) ka nxjerrë një numër vendimesh, ka aprovuar rregulla, metodologji dhe procedura të sektorit të energjisë. Ndër çështjet e rëndësishme mund të përmenden rregulla për vendosjen e të hyrave për furnizuesin me shërbim universal, rregullat e çmimeve mbi bazën e të cilave janë përcaktuar çmimet e energjisë për vitin 2017, si dhe harmonizimi i një pjesë të legjislacionit sekondar në pajtueshmëri me ligjet e reja të energjisë dhe Pakon e Tretë të Energjisë të BE-së.

Për furnizimin e konsumatorëve me energji elektrike me pakicë janë të licencuar tre furnizues, ndërsa një numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve posedojnë licenca për tregtim me energji elektrike si dhe licenca për prodhim, transmetim dhe shpërndarje të energjisë elektrike dhe termike. Gjatë vitit 2017, ZRRE ka shqyrtuar aplikacione për licencim të subjekteve juridike të ndryshme.

ZRRE ka pranuar dhe shqyrtuar një numër të konsiderueshëm të aplikacioneve për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtrishme të Energjisë (BRE) të teknologjive të ndryshme dhe gjatë vitit 2017 përveç autorizimeve preliminare ka lëshuar edhe tetë (8) autorizime finale. Poashtu ZRRE ka monitoruar proceset e ndërtimeve të kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE-të prej të cilave një është përfunduar gjatë vitit dhe është futur në operim.

ZRRE është ballafaquar me disa konteste gjyqësore lidhur me aktivitetin e saj, ndërsa me ndikim më të madh ka qenë kontesti dhe vendimi mbi masën e përkohshme i Gjykatës së Apelit lidhur me trajtimin e energjisë së pafaturuar (humbje) në katër komunat e veriut të vendit.

ZRRE-së gjatë vitit 2017 ka kryer procesin e përshtatjeve vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) dhe shqyrtimin e aplikimeve për tarifat e reja nga ana e të licencuarve në sektorin e energjisë, përfshirë veprimtarinë e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal, si dhe të licencuarve në sektorin e energjisë termike. Nga data 1 prill 2017, ZRRE ka ndryshuar strukturën tarifore me pakicë në sektorin e energjisë elektrike. Ndryshim esencial është largimi i tarifave sezonale (verë/dimër) që do të përfshijnë të gjithë konsumatorët fundor, si dhe largimi i bllok tarifave për konsumatorët familjar.

Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve ZRRE gjatë vitit ka pranuar dhe shqyrtuar ankesa nga konsumatorët, si dhe iu ka ofruar konsultime, sqarime dhe udhëzime për veprimet e nevojshme për zgjidhjen e ankesave të tyre.

ZRRE gjatë përmbushjes së aktiviteteve të veta ka pasur bashkëpunim me institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare, si dhe ka bërë raportime në Kuvendin e Kosovës, por edhe ka informuar mediat rreth zhvillimeve në sektorin e energjisë.

Në vitin 2017 janë ndërmarrë veprime përgatitore për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit, për përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit si dhe për përgatitjen e rregullave dhe procedurave tjera për funksionim të sistemit energjetik dhe në harmoni me kërkesat e Pakos së Tretë të Energjisë.

Në realizimin dhe kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara me ligj, ZRRE-ja është asistuar nga USAID – "Repower Kosova" dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në mënyrë të vazhdueshme.

Përveç pjesës së raportit që përshkruan aktivitetet e ZRRE-së, raporti përmban edhe aktivitetet e të licencuarve në sektorin e energjisë ku analizohen veçmas energjia elektrike, energjia termike dhe gazi natyror.

ZRRE-ja përmes udhëzuesit për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike ka vendosur që të bëjë hapjen e tregut me shumicë duke filluar nga gjenerimi dhe pastaj në mënyrë graduale edhe liberalizimin e tregut me pakicë duke e përshtatur me rrethanat e sektorit të energjisë në Kosovë.

Hapja e tregut ka filluar me daljen e konsumatorëve të nivelit të tensionit 220kV dhe 110kV në treg me çmime të parregulluara të furnizimit me energji elektrike, që përbënë rreth 8% të kërkesës për energji. Po ashtu në treg të lirë përfshihen edhe mbulimi i humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes (përfshirë energjinë për katër komunat e veriut) që përbënë rreth 28% të kërkesës së energjisë.

Konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal furnizohen me çmime të rregulluara të përcaktuara nga ZRRE përmes shqyrtimeve tarifore, të cilat janë kosto - reflektive, të arsyeshme, jo-diskriminuese, duke marrë në konsideratë mbrojtjen e konsumatorëve, të bazuara në kritere objektive, si dhe të vendosura në mënyrë transparente.

Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2017 është karakterizuar me një rënie krahasuar me prodhimin në vitin 2016. Kjo rënie e prodhimit ka ndodhur për shkak të problemeve të shpronësimit në fshatrat Hade dhe Shipitullë dhe si rrjedhojë ka pas rritje të importit të energjisë elektrike për mbulimin e konsumit.

Kërkesa e përgjithshme për energji elektrike në sistem si dhe konsumi në shpërndarje është në rritje të vazhdueshme ndër vite, mirëpo mbetet shqetësuese cilësia e furnizimit e cila në disa raste është nën standardet e kërkuara dhe që vërehet përmes indeksave matës (SAIDI, SAIFI, ENS ,etj.), si dhe cilësia e shërbimeve.

Humbjet në rrjetin e transmetimit janë në nivel të pranueshëm, ndërsa humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë mjaft të larta. Humbjet teknike arrijnë vlerën 12.28%, kurse konsumi i paautorizuar i energjisë (më tutje në tekst humbjet komerciale) përbëjnë 17.03% të kërkesës në shpërndarje, prej të cilës energjia e pa faturuar në pjesën veriore të Kosovës përbën 5.31% (265 GWh).

Tabela e mëposhtme pasqyron të dhënat kryesore të realizuara në vitin 2017 krahasuar me bilancin e vitit 2017 dhe me realizimin në vitin 2016.

Tab. I. Krahasimi i të dhënave 2017me bilanc dhe vitin 2016

	Njësia	Prodhimi	Kërkesa	Importi	Eksporti	Humbjet	
						Transmetim	Shpërndarje
Realizimi 2017	GWh	5,300	5,686	1,242	880	118	1,464
Bilanci 2017	GWh	5,827	5,464	724	1,088	113	1,321
Realizimi 2016	GWh	5,835	5,342	534	1,121	120	1,427

Ndër vite energjia e faturuar ka pasur rritje të vazhdueshme, e posaçërisht rritje më të theksuar ka pasur në arkëtim, i cili arrin në 99.09% për konsumatorët e kyçur në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes.

Sa i përket sektorit të energjisë termike situata mbetet kryesisht e pandryshuar. Projekti i kogjenerimit në NQ Termokos ka dhënë rezultate të mira duke ngritur cilësinë e ngrohjes për konsumatorët e kyçur në rrjet, ndërsa projekti i kogjenerimit në NQ Gjakova është në proces të realizimit.

1 ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI

1.1 Përshkrimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është agjenci e pavarur dhe e ndarë në aspektin ligjor dhe funksional nga çdo person tjetër fizik a juridik. Detyrat dhe funksionet e ZRRE-së janë të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, të cilat përfshijnë: krijimin dhe funksionimin efikas, transparent dhe jo-diskriminues të tregut të energjisë; përcaktimin e kritereve dhe kushteve si dhe dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë; përcaktimin e kritereve dhe kushteve dhe dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja; monitorimin e tregut dhe përkujdesen për përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji; vendosjen e tarifave për aktivitetet e energjisë në mënyrë të arsyeshme dhe në bazë të metodologjisë tarifore; monitorimin dhe parandalimin e krijimit të pozitës dominuese dhe praktikave jo-konkurruese nga ndërmarrjet e energjisë, si dhe zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë.

ZRRE-ja është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e kornizës rregullative për sektorin e energjisë në Kosovë, me qëllim që të arrihet pajtueshmëri me detyrimet e Traktatit të KEEJL-së dhe harmonizimit me *"acquis communautaire"* për energji, për të siguruar qasje jo diskriminuese të të gjithë shfrytëzuesve të rrjetit të energjisë me çmime që reflektojnë shpenzimet e vërteta ekonomike.

1.2 Struktura organizative dhe burimet njerëzore

Struktura organizative e ZRRE-së është e përcaktuar nga Bordi i ZRRE-së bazuar në përgjegjësitë dhe detyrat që parashihen në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 dhe Rregullën për organizimin dhe funksionimin e ZRRE-së.



Fig. 1.1 Skema organizative e ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së përbëhet nga kryesuesi dhe katër anëtarë të tjerë dhe është i ngarkuar për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ZRRE-së. Bordi merr vendime me shumicë votash dhe ka kuorumin e nevojshëm për marrjen e vendimeve nëse së paku tre anëtarë të Bordit janë të pranishëm.

Personeli i ZRRE-së është i strukturuar në departamente organizative të përcaktuara në bazë të veprimtarive të veçanta operacionale dhe administrative.

Përshkrimi shkurtër i strukturës organizative me vendet e punës në vitin 2017 është dhënë në tabelën më poshtë.

Tab. 1.1 Struktura organizative me vendet e punës

Pozitat e vendeve të punës	Pozitat e planifikuara	Punësuar	Vendet e lira
Bordi i ZRRE-së	**5**	**2**	Kryesuesi dhe dy anëtarë të Bordit
Drejtor menaxhues	1	1	0
Zyrtare për marrëdhënie me publikun	1	1	0
Zyrtare për asistencë të Bordit	1	1	0
Njësia e administratës			
Udhëheqëse e njësisë së administratës	9	9	0
Zyrtar kryesor financiar			
Menaxhere e prokurimit			
Zyrtare e administratës			
Zyrtar për menaxhimin e të dhënave			
Ekspert për zhvillim të bazës së të dhënave			
Përkthyes i gjuhës angleze			
Recepcionist			
Mirëmbajtës/Vozitës			
Departamenti ligjor dhe i licencimit (DLL)			
Udhëheqës i dpt. ligjor dhe të licencimit	3	3	0
Ekspert për çështje ligjore dhe të monitorimit			
Analiste për monitorim të licencave			
Departamenti i cmimeve dhe Tarifave (DTÇ)			
Udhëheqës i dpt. për çmime dhe tarifa	4	4	0
Ekspert ekonomik për çështje rregullative dhe të tarifave			
Analist për tarifa dhe çmime			
Analist për strukturë tarifore			
Departamenti I tregut të energjisë (DTE)			
Udhëheqës i dpt. për treg të energjisë	4	4	0
Analiste për furnizim me energji dhe strukturë të tregut			
Analist për sisteme elektroenergjetike			
Analist për monitorim të tregut			
Departamenti për gaz dhe energji termike (DGET)			
Udhëheqës i dpt. për energji termike dhe gaz	2	2	0
Analiste për energji termike			
Departamenti për mbrojtje të konsumatorëve (DMK)			
Udhëheqës i dpt. për mbrojtje të konsumatorëve	3	2	0
Zyrtar për mbrojtje të konsumatorëve			
Analist për përmbushje të standardeve			1
Gjithsej	**33**	**29**	**4**

Personeli i ZRRE-së është një ekip ekspertësh me performancë të dëshmuar në fushat e përgjegjësive që ata mbulojnë.

Ky kompozim eksperiencash inxhinierike, ekonomike, juridike dhe të tjera e përforcon besimin për një institucion me strategji të qartë drejt suksesit në zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë.

1.3 Bordi i ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së përbëhet nga pesë (5) anëtarë përfshirë kryesuesin, të cilët emërohen me orar të plotë të punës nga Kuvendi i Kosovës me mandat pesë (5) vjeçar. Bordi i ZRRE-së është organ vendimmarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ZRRE-së. Bordi merr vendime me shumicë votash dhe ka kuorumin e nevojshëm për marrjen e një vendimi nëse së paku tre anëtarë të Bordit janë të pranishëm por duhet të ketë tri (3) vota pro për të qenë vendimi i plotfuqishëm. Bordi paraqet qëndrimet e veta rreth çështjeve që trajtohen përmes vendimeve, të cilat merren në mbledhje të hapura dhe të njoftuara qysh më parë në faqen zyrtare të ZRRE-së. Qysh nga shtatori i vitit 2016 ZRRE ka funksionuar me tre anëtarë të bordit, ndërsa nga maji i vitit 2017, me skadimin e mandatit edhe të një anëtari tjetër, Bordi i ZRRE-së ka mbetur pa kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje. Me 31 dhjetor 2017 Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji përbëhej nga anëtarët si në vijim:

Arsim Janova, Ushtrues detyre i kryesuesit të Bordit, dhe

Besim Sejfijaj, anëtar i Bordit

Për qëllime të vendimmarrjes, në përputhje me autoritetin e dhënë sipas legjislacionit në fuqi, Bordi i ZRRE-së ka mbajtur takime të vazhdueshme deri me 15 maj 2017, në të cilat është diskutuar lidhur më funksionimin e sistemit energjetik në Kosovë dhe janë marrë vendime adekuate si dhe aprovime/miratime të dokumenteve të nevojshme për sektorin.

Bordi i ZRRE-së deri në maj të vitit 2017 ka mbajtur gjithsej shtatë (7) mbledhje publike, në të cilat janë marrë 43 vendime që kanë të bëjnë me:

- Monitorimin e tregut dhe aktiviteteve të sektorit të energjisë;
- Liberalizimin e tregut të energjisë;
- Rregullimin e çmimeve;
- Licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë;
- Autorizimin e ndërtimeve të kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme;
- Mbrojtjen e konsumatorëve;
- Aprovimin e rregullave, metodologjive dhe dokumenteve tjera të sektorit të energjisë, dhe
- Çështje të tjera në kuadër të përgjegjësive të tij.

Pjesa më e madhe e dokumenteve të shqyrtuara dhe të miratuara fillimisht janë vënë në diskutim publik, ashtu siç parashihet me ligj, për të përfshirë të gjitha palët e involvuara në proceset e vendimmarrjes dhe janë të publikuara në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Për të gjitha aktivitetet, Bordi është mbështetur nga: Drejtori Menaxhues, Njësia administrative dhe pesë (5) departamente si në vijim:

- Departamenti ligjor dhe i licencimit (DLL)
- Departamenti i tregut të energjisë (DTE)
- Departamenti i tarifave dhe çmimeve (DTÇ)
- Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (DMK)
- Departamenti për energji termike dhe gaz natyror (DETG)

Bordi i ZRRE-së ka përkrahur ngritjen profesionale të stafit të ZRRE-së duke synuar specializimin e punonjësve në profilet përkatëse në kuadër të përgjegjësive të tyre, përmes trajnimeve të ndryshme të organizuara brenda dhe jashtë vendit.

1.4 Departamentet e ZRRE-së

Departamenti ligjor dhe i licencimit (DLL)

Departamenti ligjor dhe i licencimit është përgjegjës për hartimin e legjislacionit sekondar, vlerësimin e aplikacioneve për licencim të ndërmarrjeve të energjisë, vlerësimin e aplikacioneve për dhënien e autorizimeve për ndërtim të kapaciteteve të reja. Ky departament gjithashtu bën mbikëqyrjen dhe monitorimin e aktiviteteve të të licencuarve.

Departamenti i tregut të energjisë (DTE)

Departamenti i tregut të energjisë është përgjegjës për strukturën e tregut, monitorimin e performancës së pjesëmarrësve të tregut, vlerësimin dhe analizën e të dhënave në sektorin e energjisë. Departamenti gjithashtu monitoron konkurrencën dhe sjelljen e pjesëmarrësve në treg në mënyrë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

Departamenti i tarifave dhe çmimeve (DTÇ)

Departamenti i tarifave dhe çmimeve është përgjegjës për vlerësimin e aplikacioneve tarifore të ndërmarrjeve të licencuara, të cilat i prezanton te Bordi për aprovim, monitoron realizimin e shpenzimeve operative dhe kapitale përmes shqyrtimeve tarifore, ndërmerr të gjitha masat që tarifat të jenë kosto - reflektive, të arsyeshme, jo-diskriminuese, të bazuara në kritere objektive, si dhe të vendosura në mënyrë transparente, duke marrë në konsiderim mbrojtjen e konsumatorëve.

Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (DMK)

Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve është përgjegjës për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve energjetike, si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve energjetike. Gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, ky departament bashkëpunon me të gjitha institucionet dhe organizatat, të cilat në mënyrë legjitime i përfaqësojnë konsumatorët.

Departamenti për energji termike dhe gaz natyror (DETG)

Departamenti për energji termike dhe gaz natyror është përgjegjës për shqyrtimin dhe implementimin e strategjive, standardeve të performancës dhe praktikave tjera operacionale, që

kanë të bëjnë me këta sektorë. Ky departament kryen monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara përmes mbledhjes, analizës dhe vlerësimit të të dhënave dhe informatave përkatëse, e gjithashtu kontribuon në zhvillimin e sistemeve raportuese të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore duke u fokusuar në elementet tekniko-teknologjike dhe në integrimin e masave nxitëse dhe caqeve për efiçiencë. Po ashtu bashkëpunon me departamentet tjera të ZRRE duke dhënë mbështetjen dhe ekspertizën teknike për çështjet e ndërlidhura me energjinë termike dhe gazin natyror.

Njësia e administratës (NjA)

Njësia e administratës mbështet funksionimin e ZRRE-së, administrimin e financave, organizon rekrutimin efikas të stafit të ZRRE-së, koordinon trajnimet e stafit të ZRRE-së, furnizimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës dhe ndihmon në rregullimin e zyrës, duke e bërë atë të përshtatshme për punë për të gjithë stafin e ZRRE-së.

1.5 Trajnimi i stafit të ZRRE-së

ZRRE vlerëson personelin si një ndër resurset me rëndësi të veçantë dhe vazhdimisht angazhohet për mbështetjen e tyre që t'u sigurojë njohuri të duhura, aftësi dhe ekspertizë adekuate për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive sipas standardeve më të larta për arritjen e potencialit të plotë të tyre përmes:

- trajnimeve në procesin e punës;
- seminareve afatshkurtra brenda dhe jashtë vendit;
- trajnimeve dhe kurseve afatgjata brenda dhe jashtë vendit;

Gjatë vitit 2017 janë mbajtur një varg takimesh rajonale, tryeza punuese dhe trajnime që kanë kontribuar në ngritjen e mëtejme të njohurive të punonjësve të ZRRE-së, mbi rregullimin e sektorit të energjisë në përputhje me standardet e BE-së.

Stafi i ZRRE-së ka marrë pjesë në trajnime, punëtori, vizita studimore profesionale kryesisht të organizuara nga ECS, REPOWER-USAID, NARUC, etj.

Në vitin 2017, me mbështetjen e projektit REPOWER nga USAID, studentët nga Universiteti i Prishtinës dhe nga Universiteti Amerikan (AUK) kanë ndjekur praktikën në ZRRE.

1.6 Projektet e asistencës teknike

ZRRE edhe gjatë këtij viti ka përfituar nga projekti i asistencës teknike "Repower Kosova" i financuar nga USAID. Projekti ka për qëllim të mbështesë ZRRE dhe institucionet tjera përkatëse që merren me çështjen e energjisë. Gjatë vitit 2017, "Repower Kosova" ka mbështetur ZRRE-në në harmonizimin e legjislacionit sekondar, çështjet që kanë të bëjnë me liberalizimin e tregut dhe çështje tjera për sektorin e energjisë duke përfshirë edhe vizita studimore që kanë të bëjnë me ngritje të kapaciteteve të zhvillimit të infrastrukturës ligjore për BRE.

1.7 Aktivitetet e prokurimit

ZRRE është duke u përballur me shumë probleme si pasojë e mosrealizimit të procedurave të prokurimit nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). Si pasojë e ndryshimit të ligjit për prokurimin publik, operimi i zyrës është vështirësuar nga procedurat e stërzgjatura të ndjekura nga AQP, gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit. Kjo ka bërë që zyra akoma të mbetet pa shërbime dhe furnizime të cilat janë të domosdoshme për një funksionim normal të saj. Rrjedhimisht plani i prokurimit të vitit 2017 është realizuar vetëm 47 %.

1.8 Financimi i ZRRE-së

ZRRE financohet nga të hyrat e dedikuara, që mblidhen nga taksat e inkasuara nga të licencuarit në bazë të nenit 24 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

ZRRE-ja mbledh të hyra nga:

- Taksat fillestare dhe vjetore të licencimit;
- Taksat nga aplikacionet për lëshimin dhe modifikimin e licencave;
- Taksat për lëshimin e certifikatave të origjinës;
- Taksa për shqyrtim/rishikim të aplikacioneve për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja.

2 AKTIVITETET E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

2.1 Kompletimi i kornizës ligjore dhe rregullative

Kuvendi i Republikës së Kosovës në gusht të vitit 2016 ka miratuar Ligjin për Energji Nr. 05/L-081, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 dhe Ligjin për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085. Ndryshimi dhe aprovimi i Ligjeve të cekura më lartë është bërë për të transpozuar pakon e III të Legjislacionit për energjinë të Bashkimit Evropian.

Ligji për Rregullatorin e Energjisë ka përcaktuar periudhën nëntë (9) mujore brenda së cilës periudhë ZRRE duhet të nxjerrë apo harmonizoj të gjitha aktet nënligjore në kompetencë të saj, duke përfshirë edhe harmonizimin e Licencave të lëshuara. Ky proces ka filluar gjatë tremujorit të fundit të vitit 2016, ndërsa finalizimi dhe aprovimi i tyre është bërë kryesisht në vitin 2017.

Aktet nënligjore të reja dhe ato të harmonizuara janë si në vijim:

- Rregulla për licencimin e aktiviteteve të energjisë
- Rregulla e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese
- Rregulla për informatat konfidenciale
- Rregulla për masat administrative dhe gjobat
- Rregulla për kushtet e përgjithshme për furnizim me energji
- Rregulla për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë
- Rregulla për shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë
- Rregulla për taksat
- Rregulla për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike
- Rregulla për vendosjen e të hyrave për furnizuesin me shërbim universal
- Parimet për caktimin e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe tregut
- Parimet për caktimin e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes
- Rregulla për furnizuesin e mundësisë së fundit
- Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të OSSH
- Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të OST dhe OT-së
- Rregulla për Vlerësimin e Projekteve Kapitale në Rrjetin e Transmetimit dhe Shpërndarjes në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Pas aprovimit të akteve nënligjore të cekura më lartë, ndryshimit dhe harmonizimit i janë nënshtruar edhe të gjitha Licencat e lëshuara nga ZRRE. Ky proces ka përfunduar në maj të vitit 2017, dhe me këtë ZRRE, brenda afatit nëntë (9) mujor të dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ka përfunduar dhe aprovuar tërë kornizën rregullative tani më të harmonizuar me kërkesat e pakos së III të Legjislacionit për energjinë të Bashkimit Evropian.

2.2 Licencimi i aktiviteteve të energjisë

Kryerja e aktiviteteve të energjisë në Kosovë bëhet nga ndërmarrjet e energjisë të cilat janë pajisur me licencë të lëshuar nga ZRRE. Sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Ligji Nr. 05/L-084, dhe Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, Rregullatori ka bërë licencimin e këtyre aktiviteteve: prodhimin e energjisë elektrike; prodhimin e energjisë termike; bashkëprodhimit të energjisë elektrike dhe termike; transmetimin e energjisë elektrike përfshirë operimin e sistemit të transmetimit; shpërndarjen e energjisë elektrike duke përfshirë operimin e sistemit të shpërndarjes; shpërndarjen e energjisë termike; furnizimin me energji elektrike dhe energji termike, duke përfshirë transitin, importimin ose eksportimin e energjisë elektrike; furnizimin me shumicë (tregtimin) e energjisë elektrike; si dhe operimin e tregut të energjisë elektrike.

Përveç licencave të sipërpërmendura, me ligjet në fuqi lejohen të kryhen disa aktivitete energjetike pa pasur nevojë të aplikojnë në Rregullator për licencë, e të cilat nuk kanë aq ndikim në sistemin elektroenergjetik të Kosovës. Pra, aktivitetet të cilat nuk kanë nevojë për licencë janë:

- prodhimi i energjisë elektrike në lokacionin energjetik me kapacitet që nuk tejkalon 5 MW;
- prodhimi i energjisë termike të prodhuar nga ngrohtoret për konsum vetanak apo me kapacitet që nuk tejkalon 1 MW;
- prodhimi i energjisë elektrike për konsum vetanak, ku stabilimenti i prodhimit apo konsumatorët e energjisë elektrike nuk lidhen në sistemin e transmetimit apo shpërndarjes.

Edhe gjatë vitit 2017 rregullatori ka pranuar aplikacione për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike, furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike, vazhdim licence, etj.

2.2.1 Licencimi i aktivitetit të furnizimit me energji elektrike

ZRRE, për furnizimin e konsumatorëve me pakicë ka të licencuar tre furnizues, mirëpo i tërë furnizimi i konsumatorëve në vend është bërë nga KESCO, ndërsa furnizuesit tjerë të licencuar HEP dhe GSA gjatë tërë vitit kanë qenë pasivë për sa i përket furnizimit të konsumatorëve.

Subjektet të cilat kanë aplikuar dhe janë në proces të licencimit janë: "JAHA COMPANY” SH.P.K., Korporata Energjetike e Kosovës, dhe "SharrCem" SH.P.K.

Më poshtë janë të dhënat e ndërmarrjeve të cilat kanë aplikuar në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike.

Tab. 2.1 Ndërmarrjet që kanë aplikuar dhe janë në proces për licencim gjatë vitit 2017.

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit të Licencuar	Numri i licencës	Adresa, selia e të licencuarit	Vlefshmëria e licencës
1	"Future energy trading and exchange dynamics" SH.P.K	Furnizim me energji elektrike	ZRRE/Li_55/16	Lagjja Kalabria, A1, CII, Nr.25, Prishtinë, Republika e Kosovës	në proces...
2	"Jaha company" SH.P.K	Furnizim me energji elektrike	ZRRE/Li_59/17	Lagja Arbëri, Rr. Ismail Qemali Nr.17 Prishtinë, Republika e Kosovës	në proces...
3	"Korporata Energjetike e Kosovës" SH.A	Furnizim me energji elektrike	ZRRE/Li_60/17	Rr. Nënë Tereza, Nr.36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës	në proces...
4	"SharrCem" SH.P.K	Furnizim me energji elektrike	ZRRE/Li_61/17	Rruga, "Adem Jashari" Nr.280, Hani i Elezit	në proces...

"Future energy trading and exchange dynamics" SH.P.K. dhe "SharrCem" SH.P.K kanë përfunduar të gjitha procedurat që kërkohen nga Rregullatori për licencim, ndërsa dy ndërmarrjet tjera janë në proces të kompletimit të dokumentacionit.

Gjatë vitit 2017 Rregullatori ka licencuar dy (2) subjekte juridike për aktivitetin e furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike, një (1) është në proces të licencimit, ndërsa dy (2) subjekte janë në proces për vazhdim licence për këtë aktivitet.

Detajet e ndërmarrjeve që janë licencuar, janë në proces të licencimit dhe për vazhdim licence të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtisë) së energjisë elektrike janë si në vijim:

Tab. 2.2 Ndërmarrjet që janë licencuar, që janë në proces të licencimit dhe në vazhdim të licencës për furnizim me shumicë (tregtisë) me energji elektrike gjatë vitit 2017

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit të Licencuar	Numri i licencës	Adresa, selia e të licencuarit	Vlefshmëria e licencës
1	"Interenergo d.o.o-Kosova" SH.P.K.	Furnizim me shumicë (tregti) e energjisë elektrike	ZRRE/Li_56/16	Sali Çeku gogaj Building, app.14, Deçan, Republika e Kosovës	27.02.2017-26.02.2022
2	"MTSP KOSOVO" L.L.C	Furnizim me shumicë (tregti) e energjisë elektrike	ZRRE/Li_58/17	Rr. Bedri Pejani Nr 3, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës	13.04.2017-12.04.2022
3	"Energy & Energy" SH.P.K.	Furnizim me shumicë (tregti) e energjisë elektrike	ZRRE/Li_57/17	Rr.Luan Haradinaj, Ob.9 Hy.17 Nr.10, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës	në proces të licencimit
4	"Danske Commodities Kosovo" SH.P.K.	Furnizim me shumicë (tregti) e energjisë elektrike	ZRRE/Li_39/17	Q.Pejton, Rr.Mujo Ulqinaku Nr.5 Ap 4, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.	në proces për vazhdim licence
5	MCM COMMODITIES SH.P.K	Furnizim me shumicë (tregti) e energjisë elektrike	ZRRE/Li_40/17	Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës	në proces për vazhdim licence

2.2.2 Licencimi i aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike

Gjatë vitit 2017, ZRRE ka shqyrtuar aplikacionin që kanë të bëjë me vazhdim të licencës për KEK TC Kosova A. Në mungesë të kuorumit të Bordit të ZRRE-së për vendimmarrje nuk është marrë vendim për vazhdim të licencës për KEK TC Kosova A. Procesi i lëshimit të licencës për ndërmarrjen "Kelkos Energy" Sh.P.K (HC Deçani dhe HC Belaje) mbetet ende i papërfunduar për shkak të lejes mjedisore që duhet lëshuar nga MMPH.

2.2.3 Modifikimi i licencave

Në përputhje me ndryshimet e bëra në legjislacionin primar dhe sekondar, Bordi i ZRRE gjatë vitit 2017 ka bërë modifikimin/harmonizimin e të gjitha licencave në fuqi.

2.3 Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE)

Me Direktivën 2009/28/EC është përcaktuar mbështetja e shfrytëzimit të energjisë elektrike nga BRE të nxjerr nga Parlamenti dhe Këshilli i Evropian i datës 23 prill 2009, e aplikueshme dhe e zbatueshme edhe për shtetet e Komunitetit të Energjisë.

Me Vendimin nr. D/2012/04/MC-EnC të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë të Evropës Juglindore (KE EJL), Kosovës i është vendosur caku i detyrueshëm për BRE deri në vitin 2020. Sipas këtij detyrimi, 25% të konsumit përfundimtar të energjisë, duhet të jetë nga BRE.

Me Ligjin për Energjinë Nr. 05/L-081 në fuqi është përcaktuar politika e BRE-ve, e cila ka për qëllim promovimin e shfrytëzimit ekonomik e të qëndrueshëm të potencialeve vendore të BRE-ve, në funksion të plotësimit të nevojave për energji, rritjes së sigurisë së furnizimit dhe mbrojtjes së mjedisit e cila është pjesë përbërëse e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës.

Për zbatimin e politikave të BRE-ve, Ministria përkatëse sipas legjislacionit në fuqi ka përcaktuar me akt të veçantë nënligjor caqet e energjisë nga BRE në harmoni me kërkesat e direktivës përkatëse të Bashkimit Europian.

Me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-84 është përcaktuar se ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese (BRE), sistemeve të reja për bartjen dhe shpërndarjen e gazit natyror, përfshirë interkonektorët, si dhe linjat direkte elektrike dhe gazsjellësit direkt për bartjen e gazit natyror do të bëhet në pajtim me procedurat e autorizimit sipas këtij ligji, e cila do të ndërmerret nga Zyra e Rregullatorit për Energji, në përputhje me kritere objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Maj të vitit 2017 ka rishikuar Udhëzimin Administrativ për Caqet e BRE-ve, Nr. 01/2013 dhe ka nxjerr aktin e ri nënligjor për caqet e BRE në (MW) që do të ndërtohen deri në vitin 2020, dhe ndryshimet e vetme janë (Energjia Fotovoltaike është rritur nga 10 MW sa ishte me UA nr. 01/2013 në 30 MW kapacitet të instaluar dhe Biomasa nga 14 MW sa ishte në 20 MW.

Udhëzimi Administrativ ka përcaktuar se, caku i detyrueshëm nga BRE deri në 2020, është 25 % të konsumit përfundimtar bruto të energjisë siç është përcaktuar në nenin 4 të Vendimit të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë Nr. D/2012/04/MC –EnC.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur caqet e BRE-ve sipas udhëzimit administrative Nr. 05/2017 të MZHE-së.

Tab. 2.3 Caqet sipas udhëzimit administrativ të MZHE-së

Burimet e ripërtritshme të energjisë	Njësia	Caqet sipas UA 05/2017
Caku BRE	%	29.89
Solare	MW	30.00
Biogaz/Biomasë	MW	20.00
Erë	MW	150.00
HC ekzistuese	MW	46.21
HC të reja	MW	240.00
Gjithsejt BRE	MW	486.21
Zhuri	MW	305.00

Në mënyrë që të arrihen caqet për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE, të përcaktuar me Udhëzimin e cekur më lartë, dhe në përputhje me mandatin ligjor të dhënë me Legjislacionin për energjinë në fuqi, ka zbatuar Rregullën për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, Rregullën për Skemën Mbështetëse dhe Metodologjitë për llogaritjen e Tarifave Nxitëse.

2.4 Autorizimi - ndërtimi i kapaciteteve të reja

ZRRE, edhe gjatë këtij viti ka vazhduar me zbatimin e procedurës së autorizimit, shqyrtimin e aplikacioneve për lëshimin e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), për shoqëritë që kanë aplikuar për marrjen e autorizimit.

ZRRE në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të caktuara me legjislacionin në fuqi, ka lëshuar Autorizime Finale për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese, ku çdo aplikues për marrjen e autorizimit i është nënshtruar analizës së rregullshmërisë dhe plotësimit me korrektësi të dokumentacionit ligjor, administrativ, teknik, financiar dhe mjedisor, si dhe marrjes së lejeve përkatëse, për përdorim e ujit në rastet e hidrocentraleve, të drejtën e shfrytëzimit të tokës, zgjidhjet teknike të kyçjes dhe pëlqimin mjedisor, të lëshuara nga institucionet relevante në përputhje me aktivitetin që subjektet kanë kërkuar për marrjen Autorizimit final për lejimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në BRE.

Gjatë vitit 2017 ZRRE nga subjektet e ndryshme juridike ka pranuar 16 aplikacione për marrje të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE. Janë pranuar dhe shqyrtuar 7 kërkesa për shndërrimin e Autorizimit Preliminar në Autorizim Final nga burimet e ndryshme të energjisë. Është rritur numri i aplikacioneve për prodhimin e energjisë elektrike nga Energjia Solare dhe Energjia nga Era. Gjatë këtij viti ka pasur kërkesa për Modifikim të Autorizimit Final. Ndërsa kërkesat për shtyrje të afatit të Autorizimit Preliminar dhe Autorizimit final kanë qenë në numër të vogël. Gjithashtu janë pranuar edhe kërkesa tjera për marrje të Autorizimit Preliminar dhe të Autorizimit Final, mirëpo në mungesë të kuorumit të Bordit për marrje të vendimeve nga 15 maji 2017 nuk kanë mundur të shqyrtohen.

2.4.1 Lëshimi i autorizimit preliminar

ZRRE gjatë vitit 2017 ka lëshuar Autorizime Preliminare për aplikacionet që kanë plotësuar kriteret fillestare dhe që mbeten të plotësojnë edhe disa kritere që kërkohen për marrje të Autorizimit Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri i Autorizimeve Preliminare të lëshuara nga Bordi i ZRRE-së sipas Burimeve të ndryshme gjatë vitit 2017.

Tab. 2.4 Autorizimet preliminare të BRE-ve

Autorizime preliminare nga BRE	Nr. i vendimeve të lëshuara
Hidrocentrale	7
Energjia nga Era	1
Gjithsej	8

ZRRE për hidrocentralet ka lëshuar Autorizime Preliminare për 7 subjekte juridike, për ndërtimin e Turbinave të Erës është lëshuar 1, ndërsa për ndërtimin e paneleve solare / fotovoltaike nuk ka lëshuar asnjë Autorizim Preliminar, dhe totali i kapacitetit të instaluar është rreth 44.5 MW, nga të cilat:

- 7 autorizime preliminare për hidrocentrale me gjithsej kapacitet 9.5 MW
- 1 autorizim preliminare për turbinë të erës me kapacitet 35 MW

Në vazhdim në tabelën 2.5 janë paraqitur shoqëritë të cilave iu është lëshuar Autorizimi preliminar.

Tab. 2.5 Shoqërive të cilave u është lëshuar Vendimi për Autorizim Preliminar

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Lëshimit të Autorizimit Preliminar
1	Hidro Forca SH.P.K.	Hidrocentral	HC Strazhë Komuna e Kaçanikut	1.08 MW	17 mars 2017
2	Security Team Kabashi e K SH.P.K.	Hidrocentral	HC Erenik. Komuna e Junikut	1.86 MW	17 mars 2017
3	Hidrocom SH.P.K.	Hidrocentral	HC Kaqandollë, Komuna e Vushtri	2.6 MW	17 mars 2017
4	Monten SH.P.K.	Hidrocentral	HC Llapi 1 Komuna e Podujevës	0.79 MW	17 mars 2017
5	Monten SH.P.K.	Hidrocentral	HC Llapi 2 Komuna e Podujevës	0.8 MW	17 mars 2017
6	Prishtina – Energy SH.P.K.	Turbina të Erës	Wind Park- KOZNICA, komuna e Novobërdës	35. MW	17 mars 2017
7	Puna SH.P.K.	Hidrocentral	HC Radesha 1 Komuna e Dragashit	0.715 MW	10 maj 2017
8	Puna SH.P.K.	Hidrocentral	HC Radesha 1 Komuna e Dragashit	1.7 MW	10 maj 2017

Krahasuar me vitin 2016, ku ZRRE kishte lëshuar njëzetetre (23) Autorizime preliminare, gjatë vitit 2017, në mungesë të vendimmarrjes së Bordit janë lëshuar vetëm shtatë (7) vendime për Autorizime Preliminare me kapacitet total të instaluar prej 44.54 MW, të cilat brenda afate ligjore pas kompletimit të kërkesave ligjore mund të Autorizohen nga ZRRE për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE.

Vendimet mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar kanë përcaktuar se aplikuesit kanë dëshmuar përshtatshmërinë e tyre për ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese, por se nuk i kanë plotësuar ende kërkesat e tjera relevante, ku njëkohësisht përcaktohet se nuk u jep të drejtë poseduesve të autorizimit preliminar që të vazhdojnë ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese para se t'i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Vendimet e tilla, obligojnë që brenda periudhës një (1) vjeçare, nga lëshimi i autorizimit preliminar, aplikuesit të bëjnë kërkesë me shkrim duke kërkuar që t'u lëshohet Autorizimi Përfundimtar (Final) për ndërtimin.

Autorizimi Preliminar i cili është lëshuar për shoqërinë Prishtina – Energy SH.P.K. (Turbina të Erës) është jashtë caqeve të BRE-ve të përcaktuara me Udhëzim Administrativ Nr. 05.2017 nga Ministria, por është përfshirë në Skemën Mbështetëse si aplikacion "në pritje", përderisa të lirohen caqet apo të caktohen caqe të reja këto mbeten si aplikacione në pritje për tu pranuar në skemën mbështetëse, dhe afatet ligjore nuk rrjedhin përderisa ZRRE me shkrim ti njofton për rrjedhjen e afateve ligjore.

Vlen të theksohet se me rastin e lëshimit të vendimit për autorizimin preliminar, është përcaktuar edhe disponueshmëria e caqeve si dhe pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse dhe garantimin automatik të tarifës nxitëse dhe po ashtu edhe garantimin e shitjes së energjisë elektrike, për periudhën e përcaktuar me legjislacion në fuqi.

2.4.2 Aplikacionet që janë në proces të shqyrtimit në ZRRE

ZRRE, gjatë këtij viti ka pranuar aplikacione për marrje të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, të cilat janë në fazën e kompletimit të aplikacioneve. Në vazhdim, në tabelën 2.6 është paraqitur lista e aplikacioneve të cilat janë në proces të shqyrtimit.

Tab. 2.6 Shoqëritë që janë në proces të shqyrtimit për marrjen e vendimit për autorizim preliminar

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Aplikimit
1	Alsi & Kosove L.L.C.	Panele Solare	Madanja, Kusar, Komuna e Gjakovës	3 MW	19 prill 2017
2	Bulding Construction L.L.C.	Panele Solare	Madanaj, Kusar, Komuna e Gjakovës	3 MW	19 prill 2017
3	Jaha Solar SH.P.K.	Panele Solare	Madanaj, Kusar, Komuna e Gjakovës	3 MW	15 maj 17
4	Jaha Solar SH.P.K.	Panele Solare	Madanaj, Kusar, Komuna e Gjakovës	3 MW	15 maj 17
5	Jaha Company SH.P.K.	Panele Solare	Buroj, Komuna Skenderajt	3 MW	15 maj 17
6	Jaha Company SH.P.K.	Panele Solare	Buroj, Komuna Skenderajt	3 MW	15 maj 17
7	Jaha Company SH.P.K.	Panele Solare	Buroj, Komuna Skenderajt	3 MW	15 maj 17
8	Ev Wind Park SH.P.K.	Turbina të Erës	Wind Park – Zatric, Komuna e Rahovecit	32.4 MW	27 tetor 2017
9	Ev Wind Park SH.P.K.	Turbina të Erës	Wind Park – Zatric, Komuna e Rahovecit	32.4 MW	27 tetor 2017

ZRRE ka vlerësuar aplikacionet për lëshimin e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, duke i respektuar të gjitha procedurat dhe kriteret ligjore për plotësimin e caqeve të

BRE-ve, të përcaktuara me udhëzimet në fuqi, mirëpo në mungesë të vendimmarrjes nuk ka mundur të lëshoj Autorizimet Preliminare për aplikuesit e lartcekur.

2.4.3 Përfundimi i afateve të autorizimit preliminar

ZRRE gjithashtu ka rishqyrtuar edhe vendimet për përfundimin e autorizimit preliminar. Në vazhdim, në tabelën 2.7 janë paraqitur shoqëritë të cilave iu është ndërprerë autorizimi preliminar sipas fuqisë ligjore.

Tab. 2.7 Shoqëritë të cilave iu është ndërprerë autorizimi preliminar

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Skadimit
1	Triangle General Contractors – INC Branc	Hidrocentral	HC Jasiq Erenik, Komuna e Junikut	5 MW	28 janar 2017
2	Triangle General Contractors – INC Branc	Hidrocentral	HC Mal Erenik, Komuna e Junikut	7.5 MW	28 janar 2017
3	Fidani Water Energy SH.P.K.	Hidrocentral	HC Radoniqi, Komuna e Gjakovës	0.43 MW	19 maj 2017

Përfundimi i autorizimit preliminar ka ardhur si pasojë e skadimit të afatit të vlefshmërisë, ku aplikuesi ka qenë i obliguar që të paraqesë kërkesën për shndërrimin e vendimit për autorizimin preliminar në Autorizim Final, brenda afatit të paraparë ligjor.

2.4.4 Projektet në proces të shtyrjes së afatit të autorizimit preliminar

ZRRE, gjatë këtij viti, nga poseduesit e vendimeve të autorizimeve preliminare ka pranuar kërkesa për shtyrje të afatit të vlefshmërisë, për mundësinë e kompletimit të dëshmive relevante kryesisht të Lejes ndërtimore të lëshuar nga organet kompetente dhe të marrëveshjes për kyçje varësisht prej nivelit të tensionit nga operatorët e sistemit në Kosovë.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten subjektet juridike të cilat kanë parashtruar kërkesë për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së autorizimit preliminar në ZRRE.

Tab. 2.8 Shoqëritë në proces të shtyrjes së afatit të autorizimit preliminar

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Aplikimit për Shtyrje
1	gEnCi SH.P.K.	Hidorcentral	HC Prizreni 9, Komuna Prizren	1.93 MW	02 nëntor 2017
2	gEnCi SH.P.K.	Hidorcentral	HC Prizreni 9, Komuna Prizren	2.1 MW	02 nëntor 2017
3	gEnCi SH.P.K.	Hidorcentral	HC Prizreni 9, Komuna Prizren	2.83 MW	02 nëntor 2017
4	Hidroforca SH.P.K.	Hidorcentral	HC soponica, Komuna e Kaçanikut	3 MW	03 nëntor 2017
5	Matkos Group SH.P.K.	Hidrocentral	HC Vica, komuna e Shtërpcës	4.6 MW	06 nëntor 2017
6	Sowi Kosovo L.L.C.	Turbina të Erës	Wind Park, Selac 1, Komuna e Mitrovicës	35 MW	06 nëntor 2017
7	Sowi Kosovo L.L.C.	Turbina të Erës	Wind Park, Selac 2, Komuna e Mitrovicës	35 MW	06 nëntor 2017
8	Sowi Kosovo L.L.C.	Turbina të Erës	Wind Park, Selac3, Komuna e Mitrovicës	35 MW	06 nëntor 2017

Kërkesat për shtyrje e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Preliminar janë parashtruar brenda afateve të rregullta ligjore, mirëpo në mungesë të vendimmarrjes nuk kanë mundur të shqyrtohen dhe të vendoset për kërkesat e tilla nga ZRRE.

2.4.5 Projektet në pritje për marrje të autorizimit final

ZRRE gjatë këtij viti ka pranuar kërkesa për shndërrimin e autorizimit preliminar në autorizim final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE. Kërkesat e tilla janë vlerësuar si të kompletuara me dëshmitë relevante të lëshuara nga institucionet relevante në Republikën e Kosovës, në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për procedurën e autorizimit.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten subjektet juridike të cilat kanë parashtruar kërkesë për shndërrimin e autorizimit preliminar në autorizim final për ndërtim.

Tab. 2.9 Shoqëritë në pritje për marrje të autorizimit final

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Aplikimit për Autorizim Final
1	N.P.N. Renelual Tahiri SH.P.K.	Hidrocentral	HC Dragash, Komuna Dragash	3.4 MW	19 korrik 2017
2	Afa Energy SH.P.K.	Hidrocentral	HC Katlina 1, Komuna Kaçanik	2.4 MW	24 korrik 2017
3	Afa Energy SH.P.K.	Hidrocentral	HC Katlina2, Komuna Kaçanik	2.7 MW	24 korrik 2017

Kërkesat për shndërrimin e Autorizimit Preliminar janë parashtruar brenda afateve të rregullta ligjore, mirëpo në mungesë të vendimmarrjes nuk kanë mundur të pajisen me Autorizim Final për Ndërtim nga ZRRE.

2.4.6 Lëshimi i autorizimit përfundimtar (final)

ZRRE gjatë vitit 2017 ka shqyrtuar aplikacionet për lëshimin e Autorizimit Final, së bashku me dokumentacionin e kompletuar për shndërrimin e vendimit mbi njoftimin për autorizimin preliminar në Autorizim final për ndërtim.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri i autorizimet finale të lëshuara nga Bordi i ZRRE-së sipas Burimeve të ndryshme gjatë vitit 2017.

Tab. 2.10 Autorizimet finale të BRE-ve

Autorizime finale nga BRE	Nr. i vendimeve të lëshuara
Hidrocentrale	6
Energjia nga Panelet Solare (Fotovoltaike)	1
Totali	7

Për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga hidrocentralet janë lëshuar 6 autorizime finale dhe një për ndërtimin e paneleve solare / fotovoltaike me kapacitet total të instaluar prej 11.3 MW, nga të cilat:

- 6 autorizime për hidrocentrale me gjithsej kapacitet 10.9 MW
- 1 autorizim për panele solare me kapacitet 0.4 MW

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur subjektet juridike të cilave iu është lëshuar Autorizimi final për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese.

Tab. 2.11 Shoqërive të cilave iu është lëshuar autorizim final për ndërtim

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Lëshimit të Autorizimit Final
1	2 KORRIKU SH.P.K.	Hidrocentral	HC Soponica Komuna e Kaçanikut	1.3 MW	18 janar 2017
2	EUROKOS JH SH.P.K.	Hidrocentral	HC Brodi I. Komuna Dragash	1.06 MW	09 shkurt 2017
3	EUROKOS JH SH.P.K.	Hidrocentral	HC Restelica 3 Komuna Dragash	1.49 MW	09 shkurt 2017
4	Hidro Line SH.P.K.	Hidrocentral	HC Albaniku 1 Komuna Mitrovicës	1.86 MW	27 shkurt 2017
5	Hidro Line SH.P.K.	Hidrocentral	HC Albaniku 4 Komuna Mitrovicës	1.11 MW	27 shkurt 2017
6	RENELUAL TAHIRI SH.P.K.	Hidrocentral	HC Orqusha Komuna Dragash	4 MW	27 shkurt 2017
7	N.T.SH. ELEING	Panele Solare	Llabjan, Komuna Peja	0.4 MW	31 mars 2017

Projektet e lartcekura priten të realizohen brenda periudhës dy (2) vjeçare sipas kushteve të Autorizimit.

2.4.7 Modifikimi i Autorizimit Final

ZRRE gjatë këtij viti ka pranuar kërkesa për modifikimin e autorizimeve finale për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE. Kërkesat e tilla pas kompletimit me dëshmitë relevante të lëshuara nga institucionet relevante në Republikën e Kosovës janë vlerësuar dhe janë shqyrtuar nga Bordi i ZRRE-së, në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për procedurën e autorizimit.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur subjektet juridike të cilave iu është lejuar modifikimi i autorizimit final për kapacitet e instaluara për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE-të.

Tab. 2.12 Shoqërive të cilave iu është modifikuar autorizimi final

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Modifikimit të Autorizimit Final
1	EkoEnergji SH.P.K.	Hidrocentral	HC Binca, Komuna Vitisë	1 MW	27 shkurt 2017
2	Hidroenergji SH.P.K.	Hidrocentral	HC Lepenci 3 Komuna Kaçanikut	9.98 MW	10 maj 2017

Modifikimi i autorizimit final nga shoqëria EkoEnergji SH.P.K., është kërkuar për Hidrocentralin HC Binqa për kapacitetin instalues nga 0.6 MW i autorizuar me vendimin V-737-2015 të datës 15 qershor 2015, dhe të modifikuar me Vendimin V-892-2017 të datës 27.02.2017 në kapacitetin instalues 1 MW, në lumin Morava e Binqës, komuna e Vitisë, duke i plotësuar kërkesat mjedisore

dhe ujore. Ndërsa modifikimi i autorizimit final V-755-2016 i datës 28 janar 2016 i lëshuar shoqërisë Hidroenergji SH.P.K. nga kapaciteti fillestar i instaluar prej 8.5 MW në kapacitetin instalues prej 9.98 MW është lejuar në përputhje me Lejen Ujore të lëshuar nga MMPH. Këto modifikime janë lejuar në përputhje me kriteret dhe kërkesat ligjore të legjislacionit në fuqi.

2.4.8 Hyrja në operim e gjeneratorëve nga BRE

Gjatë këtij viti pas finalizimit të projektit të Autorizuar nga Bordi i ZRRE-së, ka hyr në operim vetëm një Hidrocentral, me fuqi totale të instaluar prej 2.01 MW.

Në tabelën e mëposhtme është paraqiten subjekti juridik i cili është futur në operim për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE-të.

Tab. 2.13 Shoqëria e cila ka hyrë në operim

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Hyrjes në Operim
1	Matkos Group SH.P.K.	Hidrocentral	HC Brezovicaja Komuna e Shtërpcës	2.01 MW	19 prill 2017

Fig. 2.1 Pamje nga objekti HC Brezovica

Projekti HC Brezovica është në operim komercial dhe nga data 19 prill 2017 ka finalizuar Marrëveshjen për Blerje të Energjisë për prodhimin e Energjisë elektrike nga BRE, marrëveshja është nënshkruar për periudhën kohore prej dhjetë (10) vite.

2.5 Monitorimi i ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese

ZRRE, gjatë këtij viti, ka bërë monitorimin e subjekteve juridike që janë të pajisura me Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE.

ZRRE ka monitoruar punimet që janë duke u realizuar nga Shoqëria Air Energy SH.P.K., e cila është e autorizuar me Vendimin V-824-2016 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Turbinat e Erës,Lokacioni “Wind park – KITKA për vendosjen e 9 turbinave me kapacitet total të instaluar prej 32.4 MW, ZK, Hogosht, Poliçkë dhe Veleglavë, Komuna e Kamenicës.

Më poshtë gjeni foto nga tereni për vendosjen e turbinave të erës, dhe të nënstacionit, të cilat janë në faza të ndryshme të ndërtimit.

Fig. 2.2 Pamje nga bazamenti i turbinave të erës dhe nënstacioni 110 kV "Wind park – KITKA"

ZRRE ka monitoruar punimet që janë duke u realizuar nga shoqëria Matkos Group SH.P.K., për projektet HC Vica, HC Shtërpca dhe HC Sharri, të Autorizuara me Vendimet V-640-2014, V-759-2016 dhe V-760-2016, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentralet, me kapacitet total të instaluar tri (3) projektet prej 16 MW, ZK Shtërpce, Komuna e Shtërpcës.

Më poshtë gjeni foto nga tereni për hidrocentralet të cilat janë në faza të ndryshme të ndërtimit.

Fig. 2.3 Pamje nga ndërtimi i HC Vica, HC Shtërpce dhe HC Sharri

ZRRE ka monitoruar punimet që janë duke u realizuar nga shoqëria HIDROENERGJI SH.P.K., për projektin HC Lepenci 1 i Autorizuar me Vendimin V-755-2016, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me kapacitet të instaluar prej 9.98 MW, ZK , Komuna e Kaçanikut.

Më poshtë gjeni foto nga tereni për hidrocentralin i cili është në fazë të ndërtimit.

Fig. 2.4 Pamje nga ndërtimi i HC Lepenci 3

ZRRE ka monitoruar punimet që janë duke u realizuar nga shoqëria EUROKOS JH SH.P.K., për projektin HC Brodi 3 i Autorizuar me Vendimin V-870-2016, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW, ZK Kukalane, Komuna e Dragashit.

Më poshtë gjeni foto nga tereni për hidrocentralin i cili është në fazë të ndërtimit.

Fig. 2.5 Pamje nga ndërtimi i HC Brodi 3

ZRRE ka monitoruar punimet që janë duke u realizuar nga shoqëria N.T.N. RENELUAL TAHIRI SH.P.K., për projektin HC Orqusha i autorizuar me Vendimin V-891-2017, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me kapacitet të instaluar prej 4 MW, ZK Orqusha, Komuna e Dragashit. Poashtu, ZRRE ka monitoruar punimet që janë duke u realizuar nga shoqëria 2 Korriku SH.P.K., për projektin HC Soponica i autorizuar me Vendimin V-880-2017, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, ZK Doganaj, Komuna e Kaçanikut.

ZRRE do të vazhdojë me monitorimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Burimet e Ripërtritshme të Energjisë, duke i respektuar të gjitha procedurat dhe kriteret ligjore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

2.6 Kontestet gjyqësore

Padia nga KEK

ZRRE me datë 22 maj 2017 është paditur nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK SH.A.) për anulimin e vendimit V-909-2017 të datës 13.04.2017 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të

kontestuar, deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Vendimi V-909-2017 ka të bëjë me azhurnimet për investimet kapitale të periudhës rregullative 2013-2016 për KEK SH.A.

ZRRE me datë 28.05.2017 nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje administrative ka pranuar aktvendimin A.nr.861/17 të datës 23.05.2017, me të cilën është refuzuar kërkesa e paditësit KEK SH.A., për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të të padituës ZRRE, Vendimi V_909-2017 të datës 13 prill 2017, deri në vendosjen e çështjes së padisë. Pas parashtrimit të ankesës nga KEK SH.A në Gjykatën e Apelit të Kosovës dhe përgjigjes në ankesë nga ZRRE, Gjykata e Apelit e Kosovës ka nxjerrë Aktvendimin AA.nr. 269/17, me të cilën ka vërtetuar aktvendimin e Gjykata Themelore në Prishtinë.

Padia nga KESCO

ZRRE me datë 25.08.2017 nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, ka pranuar Aktvendimin A.nr.1780/16 të datës 09.08.2017, me të cilën është detyruar që të parashtrojmë përgjigje në padi lidhur me inicimin e Konfliktit Administrativ nga KESCO SH.A., për shfuqizimin e vendimit të Bordit të ZRRE-së V_860-2016 të datës 14.10.2016, për licencimin e shoqërisë HEP-KS SH.P.K., për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike.

ZRRE me datë 11.09.2017 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka paraqitur përgjigjen në padi, me të cilën kërkon të refuzohet ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit KESCO SH.A. duke paraqitur faktet e nevojshme, si dhe kërkuar që vendimi i lartcekur i Bordit të ZRRE-së të mbetet në fuqi si i bazuar.

Padia nga Avokati i Popullit

ZRRE është paditur nga Avokati i Popullit të Republikës së Kosovës për anulimin e vendimit V-399-2012 të datës 06.02.2012 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar, deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Vendimi i ZRRE-së V_399_2012 ka të bëjë me parametrat rregullativ te të cilët ndër tjera përcaktohet se *"...lakorja e reduktimit të humbjeve në shpërndarje do të fillojë nga vlera e realizuar në vitin 2011 dhe do të reduktohet për 3% (pikë përqindjeje) në 3 vitet e para dhe për 2.5% (pikë përqindjeje) në 3 vitet pasuese..."*.

ZRRE me datë 18.09.2017 nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative ka pranuar Aktvendimin A.nr. 1373/17 të datës 11.09.2017, me të cilën *"Aprovohet kërkesa e paditësit-propozuesit Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës dhe shtyhet ekzekutimi i vendimit të të padituës Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, V_399_2012 i datës 06.02.2012, deri në marrjen e aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e paditësit"*. Pas pranimit të aktvendimit të lartcekur, ZRRE me datë 29.09.2017 ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës duke kontestuar në tërësi Aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë, dhe ka propozuar që të aprovohet ankesa e ZRRE-së si e bazuar, si dhe të anuloj Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

ZRRE me datë 30.10.2017 nga Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative, ka pranuar Aktvendimin AA.nr. 451/17 të datës 20.10.2017, me të cilën është refuzuar si e pabazuar ankesa e ZRRE-së, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1373/17 i datës 11.09.2017, është vërtetuar.

ZRRE me datë 29.11.2017 pranë Gjykatës Supreme të Kosovës ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën ka atakuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1373/17 të datës 11.09.2017 dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr.451/17 të datës 20.10.2017, me propozim që Aktvendimet e atakuara të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, apo Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, të ndryshohet dhe të miratohet ankesa e ZRRE-së, si e bazuar.

2.7 Bilanci vjetor i energjisë elektrike dhe termike

Sipas Ligjit për Energjinë (nr. 05/L-081) ZRRE është përgjegjëse për bilancet, ku përfshihen bilancet vjetore dhe afatgjate (10 vjeçare) të energjisë elektrike, energjisë termike dhe gazit natyror. Po ashtu sipas ligjit përcaktohen edhe obligimet e operatorëve të sistemeve për përgatitjen e këtyre bilanceve. Bilancet vjetore duhet të aprovohen nga ZRRE veçmas dhe pastaj përmblidhen si një tërësi e përbashkët për energjinë elektrike, energjinë termike dhe gazin natyror dhe publikohen në faqen elektronike. Meqenëse Kosova nuk posedon sistem të gazit natyror, nuk është përgatitur bilanci vjetor për gazin natyror.

Në vitin 2017 janë përgatitur dhe finalizuar:

- Bilanci vjetor i energjisë elektrike për vitin 2018; dhe
- Bilanci vjetor i energjisë termike (për NQ Termokos dhe NQ Gjakova) për vitin 2018;

Bilanci vjetor i energjisë i përmbledhur për vitin 2017 është i publikuar në faqen elektronike të ZRRE-së www.ero-ks.org, ndërsa pas aprovimit do të publikohet edhe bilanci vjetor i energjisë për vitin 2018.

Deri më tani bilancet janë përgatitur bazuar në metodologjinë për përgatitjen e bilanceve të energjisë dhe "Udhëzimin Administrativ Nr._07_2011 mbi Rregullat për Balancat e Energjisë".

Gjatë vitit 2017 ZRRE ka përgatitur Rregullën për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë Elektrike dhe Energjisë Termike, që përmban edhe metodologjitë për hartimin dhe procedurat për përgatitjen, dorëzimin, shqyrtimin dhe aprovimin e Bilanceve vjetore dhe shumëvjeçare të energjisë elektrike dhe termike. ZRRE është në proces të finalizimit të kësaj rregulle për aprovim nga Bordi i ZRRE-së.

2.8 Aktivitetet e ZRRE-së në fushën e rregullimit të çmimeve

ZRRE, bazuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullave për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM), në kuadër të kompetencave të dhëna është autoriteti i vetëm përgjegjës për përcaktimin e tarifave për aktivitetet e rregulluara në sektorin e energjisë.

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, një nga veprimtaritë kryesore të ZRRE-së gjatë vitit 2017 ka qenë procesi i përshtatjeve vjetore për HLM dhe shqyrtimi i aplikimeve për tarifat e reja nga ana e të licencuarve në sektorin e energjisë, përfshirë veprimtarinë e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit publik të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë dhe të licencuarve në sektorin e energjisë termike.

ZRRE-ja gjatë gjithë procesit të shqyrtimit i ka dhënë theks të veçantë konsultimeve publike. Këtu është përfshirë edhe publikimi i dokumenteve në faqen elektronike si në vijim:

- Raporti i Azhurnimeve për investime kapitale të KEK- SH.A;
- Raporti Përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH -së;
- Raporti Përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT- së;
- Njoftim për zbatimin e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA. Nr. 451/2017 i datës 20 tetor 2017.

2.8.1 Tarifat e energjisë në tregun e liberalizuar

ZRRE në muajin janar të vitit 2017 ka nxjerr ”Udhëzuesin për liberalizimin e tregut te energjisë elektrike në Kosovë”, i cili përcakton mënyrën, kushtet dhe kohën e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë në nivelin e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike. Me këtë udhëzues janë vendosur parakushtet e liberalizimit të tregut, zhvillimit të konkurrencës efektive të tregut të energjisë elektrike, derregullimin e çmimeve të prodhimit të energjisë elektrike për KEK SH.A nga muaji mars 2017, blerjen e humbjeve të energjisë elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Shpërndarjes në tregun konkurrues.

Po ashtu në këtë kuadër të reformave gjatë këtij viti është krijimi i fondit për energjinë e prodhuar nga burimet e ripërtritshme (BRE), ku diferenca e çmimeve të tregut krahasuar me çmimet nxitëse do të mbulohet nga Fondi i BRE-ve.

Përveç reformave të përshkruara më sipër lidhur me tregun me shumicë, ZRRE ka krijuar kornizën e nevojshme ligjore për të mundësuar edhe hapjen e tregut me pakicë, përkatësisht ofrimin e mundësive që konsumatorët fundor të zgjedhin lirshëm furnizuesin e tyre. Procesi i liberalizmit të tregut në nivelin me pakicë garantohet me anë të rregullave siç janë: Rregulla për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal, Rregulla për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit dhe Rregulla për Ndërrimin e Furnizuesit.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e procesit të liberalizimit të tregut, ZRRE ka paraparë që ky proces të vazhdojë në mënyrë graduale dhe në bashkëpunim me të gjithë palët përgjegjëse në sektorin e energjisë. Në këtë kuptim, në pajtim me Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të energjisë elektrike në Kosovë, hapja e tregut me pakicë është paraparë në disa faza varësisht llojit të konsumatorit, dhe nivelit të tensionit në të cilin janë të kyçur ata. Konsumatorët e kyçur në nivelin transmetimit 220kV dhe 110kV i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut nga datat 31 mars 2017, ndërsa konsumatorët komercial në nivelet e tensionit 35kV, 10kV pritet që do ti nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike nga 31 mars 2018.

2.8.2 Përshtatjet e kostove të furnizimit me energji elektrike për KEK

ZRRE, gjatë Shqyrtimit Periodik 4 vjeçar (1 prill 2013 deri me 31 mars 2017) ka përcaktuar të hyrat e lejuara maksimale të cilat kanë mundësuar një operim normal dhe kanë mundësuar kryerjen e investimeve të nevojshme kapitale për këtë periudhë. Vlera e përgjithshme e investimeve të lejuara në KEK SH.A. për periudhë katër (4) vjeçare ka qenë 208.4 milion euro, ku përfshihen investimet në: TC Kosova A, 58.4 milion euro, TC Kosova B, 44.1 milion euro, dhe divizionin e Mihjes 105.9 milion euro.

Në bazë të Rregullës për Përcaktimin e Çmimeve të Gjeneratorëve të rregulluar periudha e shqyrtimit shumë-vjeçar ka përfunduar më 31 mars 2017 dhe nga kjo datë ZRRE nuk bënë rregullimin e çmimit për KEK SH.A. Duke u bazuar në ketë Rregull, ZRRE duhet të bëjë përshtatjet për investimet kapitale të lejuara dhe të realizuara nga KEK. Gjatë këtij procesi ZRRE bënë përshtatjen e të hyrave të KEK-ut në raste se kemi dallim në mes të investimeve kapitale të lejuara dhe realizuara, duke kompensuar konsumatorët për zhvlerësimin dhe kthimin për këto investime. Ky kompensim është përshtatur për normën e interesit të përcaktuar si vlerë hyrëse gjatë periudhës rregullative.

Të dhënat e dërguara nga KEK paraqesin një gjendje jo të kënaqshme të investimeve të realizuara për periudhën 4 vjeçare. Nga vlera e përgjithshme e lejuar e investimeve për KEK-un në të gjitha divizionet, janë realizuar 101.4 milion €, apo shprehur në përqindje, 48.7%.

Tabela në vijim paraqet investimet kapitale të lejuara dhe të realizuara në KEK SH.A për periudhën 1 prill 2013 deri me 31 mars 2017.

Tab. 2.14 Investimet në KEK për periudhën katër vjeçare

INVESTIMET NË KEK								
	Mihje		TC KOSOVA A		TC KOSOVA B		Gjithsej	
Viti	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)
2013	14.51	8.44	23.02	30.46	9.07	1.87	46.60	40.77
2014	39.96	10.44	17.71	9.81	5.50	9.19	63.17	29.44
2015	41.45	6.19	10.21	8.87	16.50	6.04	68.16	21.10
2016	9.95	5.92	7.50	2.60	13.00	1.61	30.45	10.13
Gjithsej	105.87	30.99	58.44	51.74	44.07	18.71	208.38	101.43

Pas kryerjes së llogaritjeve për përshtatjet nga mos realizimi i investimeve, rezulton se duhet kompensuar konsumatorët në vlerë prej 21,534,381 euro.

ZRRE ka analizuar disa mënyra të përshtatjes së kostos kapitale të KEK-ut, në mënyrë që të kompensohen të gjithë konsumatorët të cilët kanë paguar këto kosto përgjatë viteve 2013-2016, përmes faturave të energjisë elektrike. ZRRE ka vlerësuar se mënyra më e drejtë e kompensimit të konsumatorëve është përmes sistemit të transmetimit, ku do të përfitonin të gjithë konsumatorët pavarësisht nivelit të tensionit dhe nivelit të rregullimit. Ashtu siç u cek më lartë tani veç ka filluar derregullimi i çmimeve me pakicë të konsumatorëve të kyçur në nivelin 220kV dhe 110 kV si dhe konsumatorëve tjerë, kompensimi përmes furnizuesit do të jetë shumë e vështirë të realizohet.

Duhet theksuar se KEK duhet të kthej të hyrat për pjesën e zhvlerësimit dhe kthimit të pranuar për investimet e parealizuara, të përshtatura për normën e interesit brenda një periudhe prej dy (2) vitesh.

KEK do të furnizojë KOSTT me energji për nevojat e sistemit të transmetimit pa kosto, si formë e kompensimit për konsumatorët. Sasia e parashikuar e nevojave të sistemit të transmetimit (për mbulimin e humbjeve) për energji për vitin rregullativ 2017/2018 është parashikuar të jetë 360 GWh. KEK duhet të furnizojë të paktën 302 GWh për KOSTT-in, në mënyrë që të kompensojë 10.7 milion euro në vitin e parë (prill 2017- mars 2018) nga shuma e përgjithshme që duhet të kthehet.

Ndërsa pjesa e mbetur nga vlera prej 21,5 milion euro, do të kthehet në vitin e dytë, duke marrë parasysh, sasinë e energjisë dhe çmimet e tregut për blerjen e energjisë në tregun me shumicë.
Duke filluar nga data 1 prill 2017, KEK ka pasur disa opsione të shitjes së energjisë elektrike në tregun vendor. Shitjet e energjisë elektrike të prodhuar nga KEK janë realizuar me këto çmime të tregut:

- shitjet e energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve me shërbim universal me çmim prej 28.6 euro/MWh;
- shitjet e energjisë konsumatorëve të kyçur në nivelin e tensionit 110 kV me çmim prej 35.4 euro/MWh;
- Shitjet e energjisë KOSTT-it dhe KEDS-it për mbulimin e humbjeve në rrjetet e tyre me çmim prej 35.4 euro/MWh dhe;
- Shitjet si eksport i energjisë me çmim prej 37.8 euro/MWh.

2.8.3 Tarifat e energjisë elektrike për konsumatorët fundorë

Struktura tarifore me blloqe e cila ka qenë e aplikueshme deri në muajin mars të vitit 2017, për konsumatorët shtëpiak përkundër që bazohet në parimet bazë të mbulimit të kostos dhe reflekton gjendjen aktuale ekonomike të vendit, megjithatë është pak komplekse dhe ndonjëherë e pakuptueshme nga konsumatori. Me liberalizimin e tregut të energjisë, është parë i nevojshëm edhe thjeshtësimi i saj, në mënyrë që konsumatorët të kenë më të lehtë vlerësimin, përkatësisht krahasimin e kostove të furnizimit nga furnizuesit e ndryshëm. Kjo strukturë tarifore është e bazuar në rregullat dhe metodologjitë përkatëse të cilat pasqyrojnë parimin e kostos reale të shërbimit për secilin grup të konsumatorëve në nivele të ndryshme të tensionit.

Nga data 1 prilli i vitit 2017, ZRRE ka ndryshuar strukturën tarifore me pakicë në sektorin e energjisë elektrike, ku rezulton se kjo strukturë është e thjeshtë, e kuptueshme, reflekton kostot, nxitë konsum efiçient të energjisë elektrike dhe është lehtë të administrohet nga furnizuesi. Ndryshimi i strukturës tarifore ka ndodhur për konsumatorët fundorë. Një nga ndryshimet esenciale është largimi i tarifave sezonale, ku në këtë rast, tarifat do të jenë të njëjta pavarësisht sezonës së konsumit (verë apo dimër) dhe do të përfshijnë të gjithë konsumatorët fundor. Ky propozim vie si rezultat i ndryshimeve minimale të kostove të furnizimit në mes të sezonit dimëror dhe veror. Si rezultat i këtij ndryshimi, konsumatorët fundorë do të kenë një çmim të pandryshuar në aspektin sezonal, për çdo kWh të shpenzuar. Ndryshimi i strukturës tarifore për konsumatorët familjarë ka ruajtur tarifën mesatare duke qenë e njëjtë me vitin paraprak 2016. Ndryshimi tjetër i propozuar përfshinë vetëm konsumatorët familjarë dhe ka të bëjë më heqjen e blloqeve tarifore në bazë të nivelit të konsumit. Me strukturën e re tarifore, do të eliminohen tarifat sipas blloqeve të nivelit të konsumit dhe do të kalohet në tarifa mesatare ditore (ditë/natë) për çdo kWh pavarësisht sasisë së konsumuar. Në këtë mënyrë secili konsumatorë do të ketë më të lehtë të llogarisë faturën e tij dhe të planifikojë konsumin sipas nevojës. Për të nxitur një shfrytëzim më efikas të energjisë gjatë kohës së ngarkesës maksimale (pikut), kanë mbetur në fuqi tarifat ditë/natë. Në këtë mënyrë do të ketë një nxitje për konsumatorët që të zhvendosin një pjesë të konsumit nga koha e pikut (ditën) në kohën jashtë pikut (natën).

2.8.4 Ndikimi i vendimit mbi masën e përkohëshme të Gjykatës së Apelit në ndryshimin e tarifave

ZRRE me datë 13 qershor 2017 ka pranuar një Raport me Rekomandime nga Institucioni i Avokatit të Popullit i Republikës së Kosovës lidhur me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.

ZRRE me datë 12 korrik 2017 zyrtarisht është përgjigjur në rekomandimet e dala nga Raporti i Avokatit të Popullit, duke e njoftuar në mënyrë detale se energjia e pafaturuar në katër komunat veriore janë pasojë e drejtpërdrejtë e refuzimit të autoriteteve lokale të katër komunave të pjesës veriore të vendit që të njohin legjitimitetin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ligjeve, rregulloreve, institucioneve dhe detyrimeve të ofrueseve të shërbimeve publike duke përfshirë edhe qasjen në asetet e tyre, e cila ka rezultuar në mos pagesë të vazhdueshme dhe këmbëngulëse nga konsumatorët e këtyre komunave për energjinë elektrike të furnizuar.

Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, pas pranimit të përgjigjeve me shkrim nga ZRRE, ka ushtruar Padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamentin për Çështje Administrative kundër ZRRE, për anulimin e vendimit V_399_2012 të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së të datës 06.02.2012 dhe me kërkesë-propozim për shtyrje të ekzekutimit të këtij vendimi deri në shqyrtimin meritor të kërkesë-padisë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative ka nxjerrë aktvendim për masë të përkohshme për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr. V_399_2012 të cilën e ka vërtetuar edhe gjykata e apelit.

Bazuar në vendimin gjyqësor për masën e përkohshme, ZRRE brenda afatit ligjor ka njoftuar me shkrim KOSTT-in, KEDS-in dhe KESCO-n dhe iu ka dhënë udhëzime si të zbatohet ky vendim gjyqësorë duke bërë përshtatjen e tarifave të konsumatorëve fundor dhe tarifave të OST/OT-së, për kostot e furnizimit për katër komunat e veriut të Kosovës.

Tab. 2.15 Struktura e tarifave e konsumatorëve me pakicë

Grupi Tarifor	Niveli I tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Tarifat prill-nëntor	Tarifat nga 1 dhjetor
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		12.21	11.78
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		6.40	6.16
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	5.37	5.18
			€c/kWh	Tarifë e Ulët	3.45	3.33
		Energjia reaktive (Q)	€c/kVArh		0.73	0.70
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		5.05	4.86
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.51	5.31
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	6.25	6.03
			€c/kWh	Tarifë e Ulët	4.02	3.88
		Energjia reaktive (Q)	€c/kVArh		0.73	0.70
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët me energji reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.86	2.71
		Fuqia e angazhuar	€/kW		3.23	3.13
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	7.30	7.04
			€c/kWh	Tarifë e Ulët	5.41	5.22
		Energjia reaktive (Q)	€c/kVArh		0.73	0.70
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.24	3.13
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e vetme	9.63	9.29
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	11.68	11.27
			€c/kWh	Tarifë e Ulët	5.78	5.58
5	0.4kV matësi 2 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.80	1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	7.00	6.75
			€c/kWh	Tarifë e Ulët	3.00	2.89
6	0.4kV matësi 1 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.80	1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh		5.52	5.32
7	0.4kV (familjarë pa matës)	Konsumi i vlerësuar:			1.80	
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		7.00	1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë mesatare		6.75
8	Ndriçimi Publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.50	3.38
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e vetme	10.09	9.73

Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor deri më 31 mars

Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator

Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korespondon me cos(Φ)<0.95

2.8.5 Tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit

ZRRE çdo vit Relevant tarifor ka bërë shqyrtimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale përmes përshtatjeve vjetore ku bënë përcaktimin e tarifave në përputhje me Rregullën e të hyrave të lejuara maksimale për operatorin e sistemit të transmetimit dhe tregut.

Gjatë këtij procesi të licencuarit kanë dorëzuar aplikacionin me kërkesat për të hyrat e lejuara maksimale, ku janë të përfshira kërkesat për shpenzimet operative, riparimet, mirëmbajtjen dhe shpenzimet kapitale.

ZRRE ka bërë vlerësimin e këtij aplikacioni dhe ka përgatitur Raportin konsultativ për të hyrat e lejuara maksimale të OST/OT të cilin e ka vendosur në konsultim publik për pranimin e komenteve nga të gjitha palët e perfshira në këtë proces. Pas shqyrtimit të komenteve ZRRE ka përgatitur edhe

Raportin final lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe tarifat e OST/OT-së në vlerën prej 25.22 milion euro, apo 2.85 milion euro më shumë se në vitin 2016.

Bordi i ZRRE-së pas shqyrtimit të të gjitha dokumenteve relevante, në seancat e mbajtura ne muajin mars dhe prill 2017, ka nxjerrë këto vendime:

- V_907_2017, për aprovimin e të hyrave maksimale të lejuara për Operatorin e sistemit të transmetimit dhe tregut(KOSTT);
- V_913_2017, për aprovimin e tarifave për shfrytëzimin Operatorit të sistemit të transmetimit dhe tregut (KOSTT).

ZRRE në bazë të vendimeve të cekura më lartë, ka përcaktuar tarifat e KOSTT për të mbuluar të hyrat e lejuara maksimale të tij, por në muajin dhjetor 2017 këto tarifa janë zvogëluar për të reflektuar zbatimin e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit për heqjen e kostove të katër komunave të veriut nga tarifat e konsumatorëve të rregulluar.

Në tabelën në vijim është prezantuar struktura e tarifave të OST/OT të aplikuara prej datës 1 prill deri 30 nëntor dhe nga 1 dhjetor 2017 e tutje.

Tab. 2.16 Struktura e tarifave të OST/OT

Grupi tarifor	Elementi tarifor	Njësia	Tarifat prill-nëntor	Tarifat 1 dhjetor
Prodhimi i kyçur në Transmetim	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.42	0.223
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.037	0.019
Prodhimi i kyçur në Shpërndarje	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.054	0.029
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.037	0.019
Operatori i Shpërndarjes	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.499	0.265
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.044	0.023
Furnizimi	Tarifa e SHST 400/220 kV	€/kW/vit	6.081	3.224
	Tarifa e SHST 110 kV	€/kW/vit	11.731	6.22
	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.499	0.265
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.044	0.023
	Tarifa e Fondit të BRE	€/MWh	1.763	1.763

2.8.6 Tarifat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes

Shqyrtimi i të hyrave te lejuara maksimale dhe tarifave për operatorin e sistemit të shpërndarjes (KEDS SH.A) është bërë në bazë të Rregullës për të hyrat e lejuara maksimale të OSH-së.

Bazuar në këtë Rregull të licencuarit kanë dorëzuar aplikacionin për të hyra maksimale ku janë të përfshira kërkesat për shpenzimet operative, mirëmbajtjes dhe shpenzimet kapitale te OSSH-se. Në bazë të aplikacionit, kërkesa e KEDS për të hyra për vitin relevant tarifor 2017, ka qenë në vlerë prej 86.34 milion euro.

ZRRE-ja pas vlerësimit të këtij aplikacioni ka përgatitur raport konsultativ për të hyra maksimale të OSSH-së (KEDS) të cilin e ka vendosur në konsultim publik. Pas shqyrtimit të komenteve, ZRRE ka përgatitur raportin përfundimtar dhe ka përcaktuar të hyrat e lejuara maksimale për KEDS-in në vlerën prej 67.53 milion euro, apo 19.81 milion euro më pak se kërkesa e KEDS-it, përkatësisht 9 milion euro më pak se në vitin 2016.

Zvogëlimi i të hyrave të lejuara maksimale të KEDS nga ana e ZRRE-së në këtë nivel ka ardhur si rezultat i:

- aplikimit të faktorit të efikasitetit për shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes prej 5%;
- aplikimi i cakut për zvogëlimin e humbjeve nga ana e ZRRE;
- realizimi i të hyrave të parregulluara nga ana e KEDS-it si: kyçjet e reja, dhënia me qira e aseteve, shfrytëzimi i rrjetit të OSSH-së nga operatoret e IPKO dhe Kujtesa;
- aplikimit të faktorit korrigjues të të hyrave etj.

Pas shqyrtimit të të gjitha dokumenteve relevante, Bordi i ZRRE ka nxjerr këto vendime:

- V_908_2017, për aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për KEDS;
- V_914_2017, për aprovimin e tarifave për shfrytëzim të Rrjetit të Shpërndarjes.

ZRRE-ja bazuar në Metodologjinë e Përcaktimit të Tarifave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Shpërndarjes ka aprovuar tarifat për KEDS-in.

Në tabelën në vijim është paraqitur struktura e tarifave për OSSH e aplikuar nga data 1 prill 2017.

Tab. 2.17 Struktura e tarifave për OSSH

Tarifat e konsumatorëve të kyçur në OSSH		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€c/kWh	1.07
10 kV	€c/kWh	1.45
0.4 kV	€c/kWh	2.15

Tarifat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes të përcaktuara nga ZRRE ju ngarkohen përdoruesve të sistemit të shpërndarjes nga OSSH në bazë të nivelit të tensionit.

2.8.7 Tarifat e energjisë termike

Në përputhje me dispozitat ligjore, ZRRE përcakton të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe tarifat e energjisë termike duke u bazuar në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike.

Kjo Rregull ndër tjera:

- Përcakton bazat dhe metodologjinë për llogaritjen e të Hyrave të lejuara maksimale dhe tarifave të energjisë termike;
- Vendos procedurat për paraqitjen e aplikacionit, shqyrtimin, përshtatjen dhe aprovimin e tarifave në sektorin e rregulluar të energjisë termike.

Për implementimin e kësaj Rregulle përkatësisht Metodologjisë për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifave të energjisë termike është zhvilluar (përgatitur) Modeli për llogaritjen e të Hyrave të lejuara maksimale dhe tarifave të energjisë termike.

Siç parashikohet edhe në Rregullën për përcaktimin e të hyrave maksimale të lejuara të energjisë termike, ZRRE ka bërë monitorimin respektivisht një lloj rekonsilimi i sezonit 2016/2017 për të verifikuar realizimin e të hyrave maksimale të lejuar të sezonit 2016/2017 nga NQ Termokos, me

q'rast nga ky raport është vërejtur se të hyrat e lejuara nge ZRRE janë përputhur pothuajse plotësisht me ato të realizuara nga kompania NQ Termokos për sezonin 2016/2017.

Në mungesë të kuorumit të Bordit të ZRRE-së nuk është vendosur për tarifat e energjisë termike për sezonin 2017/2018, dhe rrjedhimisht ato kanë mbetur të njëjta me ato të sezonit të kaluar.

Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos dhe NQ Gjakova është paraqitur si më poshtë.

Tab. 2.18 Tarifat e energjisë termike

Tarifat e energjisë termike					
Komponentët e tarifës me matje	Njësia	NQ Termokos		NQ Gjakova	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komponenta fikse)	[€/kW/muaj]	0.93		0.91	
Tarifa për Furnizim/Konsum të En. Term. (Komponenta variabile)	[€/MWh]	41.47		58.76	
Komponentët e tarifës pa matje	Njësia	Konsumatorë shtëpiak	Konsumatorë Kom.&Inst.	Konsumatorë shtëpiak	Konsumatorë Kom.&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik Komponenta fikse)	[€/m^2 për muaj]	0.11	0.15	0.09	0.12
Tarifa për Furnizim/Konsum të En. Term. (Komponenta variabile)	[€/m^2 për muaj]	0.67	0.82	0.88	1.27

2.9 Nxitja e prodhimit të energjisë elektrike nga BRE

Tarifat nxitëse (Feed-in) janë një mekanizëm për nxitjen e investimeve në prodhimin e energjisë elektrike nga burime e ripërtëritshme, të cilat aplikohen në vendet në zhvillim, si dhe në vendet e zhvilluara (BE-së, SHBA-së dhe më gjerë).

ZRRE bazuar në metodologjinë e llogaritjes së tarifave nxitëse ka përcaktuar nivelin e tarifave nxitëse të energjisë së prodhuar nga burime të erës, ujit, solare dhe biomasës. Në kuadër të kësaj metodologjie janë marr parasysh kostot e investimit, shpenzimet operative, kthimi në kapital dhe të dhënat tjera relevante të cilat kanë qenë të nevojshme për kalkulimin e kësaj tarife.

Në tabelën në vijim janë paraqitur tarifat nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE, sipas teknologjive, dhe të aprovuara nga Bordi i ZRRE-së.

Tab. 2.19 Tarifat nxitëse të BRE-ve sipas teknologjisë

Tarifat nxitëse të aplikueshme për BRE	
BRE	€/MWh
Era	85.00
Fotovoltaike	136.40
Hidrocentrale të vogla	67.47
Biomasa	71.30

Gjeneratorët e BRE-ve të cilët nuk janë të pranuar në skemën mbështetëse mund të zgjedhin të operojnë si gjeneratorë me çmime të rregulluara apo në treg të lirë dhe do ti nënshtrohen

rregullave në fuqi duke mbuluar imbalancet e tyre dhe duke patur prioritet në dispeçim dhe prioritet në kyçje.

Me Skemën Mbështetëse ofrohen stimulime financiare për ndërtimin e kapaciteteve të mjaftueshme për prodhimin e energjisë nga BRE-të për të arritur cakun e përcaktuar për BRE sipas udhëzimit administrativ.

Fondi për Energjinë e Ripërtërishme (FER) është krijuar dhe menaxhohet nga Operatori i tregut (OT) në përputhje me rregullën për skemën mbështetëse. OT-ja blen tërë energjinë e prodhuar (të matur) nga BRE sipas çmimeve përkatëse nga skema mbështetëse. Kjo energji pastaj mbulohet nga furnizuesit me çmime referente, të cilat përfaqësojnë çmimet e blerjes së energjisë elektrike me shumicë përfshirë edhe importin, ndërsa diferenca e çmimit sipas skemës mbështetëse dhe çmimit referent mbulohet nga të gjithë furnizuesit proporcionalisht me energjinë e furnizuar përmes FER.

Tarifa për Energjinë nga BRE është tarifë të veçantë në nivel të transmetimit e cila mbulon kostot e Fondit për Energjinë e Ripërtritshme për të cilën lëshohen certifikata të origjinës, e cila mund të azhurnohet gjatë shqyrtimeve të rregullta vjetore. Kjo tarifë është proporcioni i kostove totale të operimit të Fondit për energjinë e ripërtritshme ndaj konsumit të parashikuar të energjisë që do të ngarkohet nga operatori i tregut.

Kostot e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtritshme gjatë vitit 2017 kanë qenë 6.34 milion euro.

ZRRE në kuadër të Rregullës për skemën mbështetëse ka trajtuar edhe energjinë e prodhuar nga mikro-gjeneratorët (gjeneratorët me vete-konsum) te cilët mund "të shtyjnë" tepricat e energjisë së prodhuar në rrjet dhe të marrin atë energji në kohën që i duhet.

Duhet theksuar se gjatë vitit 2017 vërehet rritje e interesimit të investitorëve për prodhimin e energjisë nga BRE. Në bazë të dhënave deri në vitin 2017 janë investuar në kapacitetet gjeneruese nga teknologjia e ujit rreth 84.2 milion euro, ndërsa nga teknologjia e erës rreth 17 milion euro, si dhe paneleve solare rreth 1 milion euro. Pra, totali i investimeve të realizuara deri në fund të vitit 2017 është rreth 102 milion euro, derisa potencialet e mundshme që priten të realizohen sipas autorizimeve të lëshuara nga ZRRE janë rreth 341 milion euro, të cilat priten të investohen deri në vitin 2020. Këto investime kapitale financohen në pjesën më të madhe nga kreditë bankare që mbulojnë deri në 70 % të kostove të investimit ndërsa pjesa tjetër financohet nga kapitali vetanak (ekuiteti) i kompanisë.

2.10 Procesi i certifikimit të OST

ZRRE ka iniciuar procesin e Certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit (OST) – KOSTT. Certifikimi i OST-ve kërkohet me qëllim të sigurimit që OST funksionet e tij i realizon në mënyrë të pavarur nga çfarëdo biznesi tjetër në sektorin e energjisë dhe rrjedhimisht të sigurohet që OST si i tillë ofron qasje të lirë dhe jodiskriminuese në rrjetin e transmetimit për të gjithë akterët që veprojnë në sektor, duke siguruar kështu funksionim të lirë të tregut të energjisë elektrike në vend. Certifikimi është proces sipas të cilit ZRRE-ja konfirmon se ka ndarje të mjaftueshme të kontrollit mbi OST-në në njërën anë, dhe mbi prodhimin dhe/apo furnizimin në anën tjetër dhe që kontrolli i ndërmarrjes së energjisë është në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse të shthurjes. Me këtë qëllim me 16 qershor 2017 përfaqësues të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregu-KOSTT

sh.a kanë prezantuar para ZRRE aplikacionin për Certifikimin e KOSTT. ZRRE ka kërkuar që aplikacioni të plotësohet edhe me disa të dhëna shtesë të cilat janë të nevojshme për definimin e pronësisë së aseteve të OST si dhe çështje të tjera përkatëse për këtë proces. Duke qenë kërkesë e dal nga direktivat e BE-së, edhe procesi i Certifikimit është duke u përcjell dhe koordinuar me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe sapo të kompletohet Bordi do të merret vendimi final.

2.11 Monitorimi i tregut

ZRRE, në pajtim me kompetencat ligjore, është përgjegjëse për monitorimin e operimit të tregjeve të energjisë elektrike, në mënyrë që të sigurojë funksionimin efikas të tyre, si dhe të identifikojë veprimet korrigjuese që mund të jenë të nevojshme.

ZRRE gjatë vitit 2017 ka bërë monitorimin e importit dhe eksportit të energjisë elektrike të realizuar nga KESCO dhe KOSTT në kuadër të aktiviteteve të tyre të përditshme për të balancuar sistemin energjetik të Kosovës, duke kryer edhe vizita tek palët përgjegjëse. Qëllimi i këtyre vizitave ishte që ZRRE të sigurohet që janë duke u aplikuar të gjitha procedurat e prokurimit të energjisë sipas legjislacionit në fuqi.

Sipas legjislacionit në fuqi, operatorët obligohen që energjinë për mbulimin e humbjeve dhe shërbimeve tjera ndihmëse ta sigurojnë në tregun konkurrues. Pjesën më të madhe të kësaj energjie operatorët arrijnë ta sigurojnë nga prodhimi vendor, ndërsa kur nuk arrihet të mbulohet kërkesa e energjisë nga prodhimi vendor, atëherë këtë energji e sigurojnë nga importi.

Gjatë kësaj periudhe të monitorimit KOSTT ka realizuar importe për mbulimin e energjisë për humbje në transmetim dhe për energji të pafaturuar në veri të vendit, kurse KESCO ka realizuar importe për konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal, për konsumatorët me çmime të parregulluara dhe për të mbuluar humbjet në shpërndarje, si dhe ka realizuar eksporte për tepricat e energjisë elektrike.

Monitorimi i realizuar fokusohet në këto fusha:

a) Importi dhe eksporti i tërësishëm dhe problemet që i përcjellin;

b) Numri i pjesëmarrësve të tregtarëve në secilin tender;

c) Sasia e importeve/eksporteve të parealizuara.

Duke pasur parasysh se për KOSTT ky ka qenë një proces i ri (proces të cilin më herët e ka kryer KESCO) atëherë edhe vështirësitë dhe problemet fillestare kanë qenë evidente. Vështirësitë kryesisht janë shfaqur në interesimin e vogël të tregtarëve për të ofruar sasitë shumë të vogla të energjisë së kërkuar nga KOSTT, sepse një pjesë të kërkesave KOSTT e siguron nga prodhimi vendor sipas prioritetit të dhënë me Udhëzuesin për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë gjë që ka rezultuar edhe me çmime më të larta të importit krahasuar me importin e realizuar nga KESCO për të njëjtën periudhë, të cilat me kalimin e kohës janë stabilizuar.

Gjatë tregtimit të energjisë, KOSTT dhe KESCO kanë përmbushur kriteret e procedurës së prokurimit të energjisë si: çmimi më i favorshëm ekonomikisht, numri i mjaftueshëm i tregtarëve pjesëmarrës në ankande, oraret kohore të tregtimit, komunikimi me palët pjesëmarrëse, etj.

Siç u përmend edhe në paragrafët më lart, fillimisht kanë ekzistuar vështirësi në sigurimin e sasive të energjisë së importuar, kështu që një pjesë e energjisë së nevojshme ka mbetur e pa kontraktuar. Për këtë përudhë sasia e nevojshme e importeve për mbulimin e kërkesave të KOSTT ka qenë 46,215 MWh nga të cilat 38,967 MWh janë kontraktuar, ndërsa 7,248 MWh është energji e pa kontraktuar.

2.12 Monitorimi i ndërprerjeve të energjisë elektrike

Bazuar në të gjeturat nga monitorimi i ndërprerjeve të energjisë elektrike për muajin tetor–nëntor 2016, ZRRE ka përgatitur raport i cili së bashku me shkresën përcjellëse të Rregullatorit, në pajtim me rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat i është dërguar KEDS që t'i mundësohet komentimi dhe eventualisht kundërshtimi i të gjeturave në Raport.

Bordi i Rregullatorit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të përgjigjeve/komenteve të KEDS SH.A. ndaj Raportit të Rregullatorit lidhur me inspektimin e ndërprerjeve të planifikuara, ka konstatuar se KEDS SH.A. në asnjë rast dhe me asnjë fakt nuk ka mundur të kundërshtoi/argumentoj të gjeturat e Raportit të Rregullatorit dhe në mbledhjen e mbajtur me datë 27 shkurt 2017 ka nxjerr *"Njoftim lidhur me shkeljet e konstatuara për ndërprerjet e planifikuara të ndërmarra gjatë muajit tetor-nëntor 2016 nga KEDS SH.A"*.

Bordi i Rregullatorit me datë 31.03.2017 konform dispozitave ligjore të dhëna në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, dhe të Rregullës për Masat Administrative dhe Gjobat, ka marrë vendim mbi shqiptimin e gjobës ndaj Kompanisë Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike (KEDS SH.A), për shkeljet e bëra gjatë ndërprerjeve të energjisë elektrike në shumën prej **45,000** Euro.

2.13 Aktiviteti i ZRRE-së në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve

ZRRE në kuadër të kompetencave ligjore është përgjegjëse për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve energjisë, si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve të energjisë.

Sipas dispozitave të rregullave të lartcekura, të gjithë konsumatorët kanë të drejtë që të parashtrojnë ankesa që kanë të bëjnë me shërbimet e ofruara nga furnizuesi ose operatori i sistemit, të cilët bëjnë shqyrtimin e ankesës dhe lëshojnë përgjigje brenda afatit ligjor. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes mund t'i drejtohet ZRRE-së për shqyrtim të mëtutjeshëm.

Gjatë vitit 2017 numri i ankesave të paraqitura në ZRRE është rreth 20.60% më i ulët se numri i ankesave të pranuara gjatë vitit 2016. Në vitin 2017 në ZRRE janë regjistruar 233 ankesa, ndërsa në vitin 2016 janë pranuar 281 ankesa. Ankesat e pazgjidhura janë në procedurë të kompletimit të dokumentacionit dhe të fakteve relevante për zgjidhjen e tyre. Përveç ankesave të konsumatorëve të regjistruara dhe të zgjidhura, ZRRE ka ofruar mbështetje edhe në dhënien e informacionit, shpjegimeve, konsultimeve verbale, postës elektronike si dhe përmes telefonit për të gjithë konsumatorët e energjisë.

Numri i ankesave të pranuara sipas kategorive të konsumatorëve është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tab. 2.20 Ankesat e konsumatorëve sipas kategorive, 2017

Ankesat e konsumatorëve sipas kategorive	Numri	Përqindja [%]
Konsumator shtëpiak	214	91.85
Konsumator komercial	18	7.73
Konsumator industrial	1	0.43
Gjithsej	233	100.00

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranuara, janë shqyrtuar dhe zgjidhur 186 ankesa apo shprehur në përqindje rreth 79.83% e tyre. Nga numri i ankesave të zgjidhura, 121 prej tyre ZRRE i ka vendosur në favor të konsumatorëve apo shprehur në përqindje 66%, ndërsa 63 ankesa të konsumatorëve apo 34% i ka refuzuar si të pabaza. ZRRE bazuar në kompetencat ligjore, përveç ankesave zyrtare të pranuara dhe regjistruara, ka kthyer në rishqyrtim tek furnizuesi dhe operatori i sistemit të shpërndarjes edhe 68 ankesa të konsumatorëve për shkak të mangësive dhe gabimeve në dokumentacionin e ofruar nga palët. Të gjitha këto ankesa janë rishqyrtuar nga ana e furnizuesit dhe operatori i sistemit të shpërndarjes si dhe janë njoftuar konsumatorët me përmirësimet e bëra.

Fig. 2.6 Statusi i ankesave të zgjidhura, 2017

Gjithashtu duhet theksuar se ZRRE ka pranuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës, 2 ankesa të konsumatorëve, me arsyetimin e jo-kompetencës lëndore për shqyrtim nga gjykata. Këto ankesa janë shqyrtuar nga ZRRE dhe konsumatorët janë udhëzuar për procedurat e mëtejme, sipas dispozitave ligjore të nenit 61 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të konsumatorëve sipas natyrës së tyre.



Fig. 2.7 Numri i ankesave të konsumatorëve sipas natyrës së tyre

Më poshtë është paraqitur sqarimi i natyrave të ankesave të konsumatorëve të regjistruara për vitin 2017:

- **Kontestimi i faturave të energjisë elektrike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve për rastet e gabimeve në lexim dhe leximeve jo të rregullta, e që me këtë rast konsiderohet se kanë dhënë një pasqyrim jo të saktë të gjendjes reale të shpenzimit të energjisë elektrike.
- **Kontestimi i ngarkesave shtesë,** ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve lidhur me faturimet shtesë nga faturimi i rregullt. Këto ankesa janë si rezultat i mos regjistrimit të saktë të shpenzimit të energjisë elektrike, si rrjedhojë e defektit të ndonjë sistemi matës. **Kontestimi i borxhit të energjisë elektrike,** ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve që kanë të bëjnë me problemet rreth mos definimit të saktë të borxhit të energjisë elektrike të pa inkasuar nga ana e furnizuesit në rastet e shitblerjes së pronës, dhe për pronat që kanë qenë të uzurpuara.
- **Kontestimi i lidhjeve/kyçjeve të reja,** ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve të cilëve ju është mohuar e drejta për lidhje të re nga operatori i sistemit të shpërndarjes. Në këto raste të ankesave, konsumatorët për të realizuar lidhjen e re janë detyruar nga ndërmarrja që së pari të kryejnë pagesat e borxheve në shifrën e vjetër e cila ka ekzistuar më herët.
- **Kontestimi i faturave të energjisë termike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve lidhur me faturimet e energjisë termike të bëra na NQ. “Termokos”, të cilat ndërlidhen me cilësinë e ngrohjes dhe sipërfaqes së faturuar.

Numri i ankesave të konsumatorëve, të regjistruara dhe zgjidhura nga ZRRE sipas viteve është paraqitur në figurën e mëposhtme.



Fig. 2.8 Ankesat e konsumatorëve të regjistruara dhe zgjidhura 2010-2017

2.13.1 Vendimet e Bordit të ZRRE-së në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve

Në bazë të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, konsumatorët dhe të licencuarit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë kundër vendimit të DMK-së si instancë e shkallës së parë në Bordin e ZRRE-së si instancë e shkallës së dytë.

Gjatë vitit 2017, Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar tri ankesa te konsumatorëve prej të cilave një vendim dhe dy rekomandime të nxjerra nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve, me ç'rast ato i ka aprovuar.

Furnizuesi KESCO gjatë vitit 2017 ka parashtruar pesë ankesa në Bordin e ZRRE-së kundër vendimeve të shkallës së parë. Bordi i ka shqyrtuar këto ankesa dhe i ka refuzuar si të pabaza.

2.13.2 Aktivitetet tjera në mbrojtjen e konsumatorëve

ZRRE gjatë vitit 2017, përveç ankesave të regjistruara ka zhvilluar edhe 1,115 takime dhe 680 biseda telefonike me palët, përfshirë edhe komunikimin elektronik, të cilët i janë drejtuar zyrës për çështje të ndryshme mes konsumatorëve dhe të licencuarve lidhur me furnizimin me energji. Gjatë komunikimit me konsumatorët, ZRRE i ka sqaruar cështjet e ngritura si dhe ka udhëzuar palët për rregullat, procedurat, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e tyre lidhur me furnizimin me energji.

Gjatë vitit 2017 ZRRE ka pranuar edhe 15 ankesa të konsumatorëve përmes postës, të cilat edhe përkundër faktit që është dashur t'iu drejtohen të licencuarve apo gjykatave, insistimi i tyre ka qenë që t'i drejtohen ZRRE-së për zgjidhjen e ankesave të tyre. Natyra e këtyre ankesave kryesisht ka qenë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, si dhe kompensim dëmi. ZRRE në të gjitha këto raste i'u është përgjigjur me shkrim konsumatorëve duke i udhëzuar të njëjtit për procedurat e mëtejme lidhur me ankesat e tyre.

Lidhur me zbatimin e Ligjit për Faljen e Borxheve Publike (Ligji Nr. 05/L -043), ZRRE gjatë vitit 2017 ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave të konsumatorëve, të cilët kanë pretenduar se u janë mohuar të drejtat ligjore me mos përfshirjen e tyre në listat e faljes së borxheve të

energjisë (energji elektrike dhe energji termike). Lidhur me këtë ZRRE ka trajtuar një numër të madh të këtyre ankesave, duke i udhëzuar të njëjtit për të drejtat e tyre siç janë të specifikuara në ligjin e lartpërmendur.

ZRRE ka pasur bashkëpunim të ngushtë me Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ku gjatë këtij viti raportues ka pranuar disa ankesa të konsumatorëve nga ky institucion. ZRRE ka shqyrtuar ankesat e pranuara nga ky institucion në përputhje me dispozitat ligjore, ka udhëzuar palët për procedurat të cilat duhet të ndjekin për shkak të jo kompetencës ligjore të ZRRE-së për shqyrtim.

Gjatë vitit 2017 një numër i vendimeve të ZRRE-së janë apeluar nga palët e pakënaqura në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve administrative. ZRRE gjatë vitit 2017 në bazë të vendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë ka përgatitur 17 përgjigje në padi kundër paditësve KEK, KEDS, KESCO dhe konsumatorëve ndaj vendimeve të Bordit të ZRRE-së. Gjithashtu gjatë këtij viti raportues ZRRE ka qenë e përfshirë në 48 seanca gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë si palë e paditur.

Është më rëndësi të theksohet se deri më tani asnjë nga vendimet e ZRRE-së të ndërlidhura me ankesat e konsumatorëve në procedurën administrative nuk është kthyer në rishqyrtim si pasojë e moszbatimit të ligjshmërisë nga organi administrativ, por që të gjitha këto padi kundër vendimeve të ZRRE-së janë refuzuar si të pabaza duke lënë në fuqi vendimet e atakuara.

3 BASHKËPUNIMI ME PALËT TJERA DHE TRANSPARENCA

3.1 Raportimi dhe bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës

Gjatë vitit 2017, sikurse dhe në vitet e kaluara, ZRRE ka vazhduar t'i raportoj Kuvendit përmes komisioneve përkatëse parlamentare për ngjarje të rëndësishme në sektorin e energjisë sa herë që është kërkuar.

Në mars të vitit 2017, me kërkesë të Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ZRRE-ja ka prezantuar Propozimimin e Strukturës Tarifore dhe ndikimet që do të ketë kjo strukturë tek konsumatorët e të gjitha kategorive. Gjatë takimit, anëtarët e Komisionit kanë kërkuar nga përfaqësuesit e ZRRE-së, të ju prezantohen disa simulime të faturave të konsumatorëve nga grupe të ndryshme të konsumit, në mënyrë që të informohen më në detaje me ndikimet që mund të kenë këto grupe nga ndryshimet e strukturës tarifore të propozuar.

Në dhjetor të vitit 2017, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal është informuar nga ZRRE-ja në lidhje me situatën energjetike në vend, përkatësisht me vonesat në shpronësim në zonat e mihjes dhe detyrimit për implementimin e vendimit të Gjykatës së Apelit lidhur me energjinë e furnizuar në katër komunat veriore të vendit.

Poashtu gjatë muajit dhjetor, ZRRE ka raportuar para Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në lidhje me energjinë e furnizuar në katër komunat veriore të vendit.

3.2 Bashkëpunimi me palët tjera dhe aktivitetet e partneritetit

Gjatë vitit 2017 ZRRE ka pasur bashkëpunim dhe partneritet të ngushtë me MZHE, institucionet tjera të Republikës së Kosovës, të licencuarit, Sekretariatin e Komunitetit te Energjisë dhe Komunitetin ndërkombëtar që vepron në Kosovë lidhur me çështjet e ndryshme të sektorit të energjisë.

3.2.1 Bashkëpunimi me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik

ZRRE-ja ka qenë pjesëmarrëse aktive në grupet punuese të themeluara nga MZHE për përgatitjen e Strategjisë së Energjisë 2017-2026, Planit nacional të veprimit për efiçiencën e energjisë, si dhe udhëzimeve të ndryshme administrative.

Gjithashtu ZRRE-ja ka asistuar MZHE-në në plotësimin e Pyetësorëve të ndryshëm të kërkuar nga institucionet ndërkombëtare. Për më tepër gjatë vitit 2017 janë mbajtur takime të ndryshme mbi problematikën e sektorit, perspektivën e tregut të energjisë elektrike dhe format e bashkëpunimit.

3.2.2 Bashkëpunimi me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës

Gjatë vitit 2017, ZRRE-ja ka pas dy takime me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës ku janë diskutuar mënyrat e bashkëpunimit, brenda kornizës së funksioneve të tyre ligjore, për të shkëmbyer informacione dhe për të adresuar problemet që kanë të bëjnë me konkurrencën.

3.2.3 Pjesëmarrja e ZRRE në takime të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik

ZRRE-ja ka marrë pjesë në disa takime të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të organizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ku janë trajtuar çështjet e ngritura nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe odat tjera që veprojnë në Kosovë që kanë të bëjnë me tarifat e energjisë elektrike, lidhjet në rrjetet elektrike dhe furnizimin me energji elektrike.

3.2.4 Bashkëpunimi dhe partneriteti me institucione ndërkombëtare

Gjatë vitit 2017, ZRRE ka bashkëpunuar me NARUC- Agjencioni Kombëtar i Komisioneve Rregullative të Shërbimeve Publike ("National Agency of Regulatory Utilities Commissions") në projektin regjional "Southeast Europe Natural Gas Transmission and Distribution Grid Codes Project"- Projekti i Evropës juglindore për kodet e transmetimit dhe shpërndarjes se gazit", me mbështetjen financiare të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)

Ky projekt ka të bëjë me bashkëpunimin regjional të rregullatorëve të Evropës juglindore në sferën e gazit i cili është bashkë-organizuar nga NARUC dhe ERRA (Asociacioni i Rregullatorëve Rajonal të Energjisë) me seli në Budapest.

Përmes këtij bashkëpunimi synohet që ZRRE të jetë në hap me zhvillimet e rregulloreve për kodet teknike sikurse që janë ato të rrjetit te transmetimit dhe shpërndarjes që përforcojnë zhvillimin e legjislacionit sekondarë në momentin e instalimit te infrastrukturës së gazit që planifikohet të përfshij edhe Kosovën sipas projektit ALGOKAP.

Me ndihmën e USAID dhe NARUC, ZRRE është përkushtuar dhe ka nënshkruar "Letrën e Qëllimit" (letter of intention) për të krijuar Mjetin për Krahasimin e çmimeve të energjisë elektrike. Me këtë ZRRE ka për qëllim të ju mundësoj konsumatorëve që në një treg të hapur të kenë një burim kredibil për të krahasuar çmimet që do të ofrojnë furnizuesit e energjisë elektrike, të cilët do të operojnë në tregun e Kosovës.

3.3 Pjesëmarrja e ZRRE-së në aktivitetet ndërkombëtare

Qëllimi i pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ZRRE-ja si një ndër aktivitetet që i shërben forcimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj. Në vijim janë paraqitur aktivitetet kryesore dhe pjesëmarrja aktive në organizatat ndërkombëtare, në konferencat ndërkombëtare, tryezat punuese apo takimet multilaterale dhe bilaterale.

3.3.1 Pjesëmarrja në Bordin Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB)

Komuniteti i Energjisë (KE) është organizatë ndërkombëtare e themeluar përmes Traktatit ndërkombëtar në tetor 2005 në Athinë, ku marrin pjesë vendet e Bashkimit Evropian dhe regjionit të Evropës juglindore dhe të Detit të Zi. Aktivitetet e KE gjatë vitit 2017 janë fokusuar drejt përmbushjes së synimeve të përbashkëta: implementimin e "acquis communautaire", zhvillimin e kornizës rregullative të harmonizuar në nivel regjional, si dhe liberalizimin dhe integrimin e tregjeve të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Palët Kontraktuese të KE janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Moldavia, Ukraina dhe Gjeorgjia. Në cilësinë e pjesëmarrësve janë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, ndërsa Norvegjia, Turqia, Armenia kanë statusin e vëzhguesit.



Fig. 3.1 Shtetet anëtare të Komunitetit për Energji të Evropës Juglindore

Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE) është një komponentë kyçe strategjike e Unionit Evropian (UE) për Evropën Jug-Lindore dhe një mjet efektiv i para-antarësimit, që synon të zgjerojë përfitimet nga Tregu rajonal për Energji, para se vendet e rajonit të bëhen anëtarë të UE.

Institucionet kryesore të KE-së janë: Këshilli i Ministrave (KM), Grupi i përhershëm i nivelit të lartë (GPNL), Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (ECRB), Sekretariati i KE i vendosur në Vjenë, dhe katër forumet këshilluese: për energji elektrike, gaz natyror, çështjet sociale dhe naftën.

Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (ECRB – "Energy Community Regulatory Board") është institucion i themeluar sipas nenit 58 të TKE EJL, që përbëhet nga Autoritet Rregullative të palëve kontraktuese, pjesëmarrësve dhe vëzhguesve. ECRB ka rolin e një trupi koordinues të autoriteteve rregullative për harmonizimin e kornizës rregullative, shkëmbimin e njohurive, dhe zhvillimin e praktikave për zbatimin e Traktatit.

Bazuar në dispozitat e Traktatit të KE, ECRB ka përgjegjësi të:

- Ofroj këshilla Këshillit Ministror si dhe PHLG-së, për çështje statusore, teknike dhe rregullative;
- Lëshoj rekomandime për palët, në pajtim me dispozitat e Traktatit, për mosmarrëveshje ndër-kufitare, etj;
- Merr masa ndaj palëve, nëse autorizohet nga KM;
- Ndihmoj bashkëpunimin dhe koordinimin midis autoriteteve rregullative;

- Jep rekomandime dhe përgatit raporte, në lidhje me funksionimin e tregjeve të energjisë; dhe
- Kërkoj përmbushjen e detyrimeve nga palët sipas TKE.

Për përmbushjen e përgjegjësive, ECRB është e organizuar në grupe punuese të cilat zhvillojnë aktivitetet në fushat përkatëse. ECRB udhëhiqet nga kryetari i zgjedhur për çdo vit nga përfaqësuesit e rregullatorëve nacional, dhe nënkryetari i cili është i deleguar nga Komisioni Evropian.



Fig. 3.2 Struktura e Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë

Sipas obligimeve ndaj KE-së, ZRRE-ja ka të emëruar anëtarët e vet në ECRB dhe në çdo grup punues, si dhe merr pjesë aktivisht në punën e Bordit dhe grupeve punuese përkatëse. Grupet punuese dhe aktivitetet përkatëse janë paraqitur në vijim:

3.3.1.1 Grupi Punues për Energji Elektrike

Ky Grup punues, gjatë vitit 2017, ka zhvilluar aktivitetet dhe takimet e rregullta në të cilat ka marrë pjesë edhe përfaqësuesi i ZRRE-së. Për punë më efikase ky grup ka të formuar edhe nëngrupet (Task Force-TF) e tij, përshkrimi dhe aktivitetet e të cilave janë të paraqitura më poshtë:

- **TF1 – Hapja e tregut me shumicë të energjisë elektrike -** Me qëllim që të mbështes hapjen efektive të tregut, ky nëngrup është fokusuar në aktivitetet për mbështetjen rregullative për alokimin e kapaciteteve dhe integrimin e tregut "një-ditë-para" në Evropën Jug-lindore. Gjithashtu një numër aktivitetesh kanë pasur të bëjnë me dhënien e inputeve të koordinuara për projektet e bashkimit (integrimit) të tregjeve "një-ditë-para" në Evropën Jug-lindore në kuadër të Iniciativës WB 6 (Ballkani Perëndimorë 6 – "Western Ballkans 6").
- **TF2 – Balancimi i tregut të integruar -** Implementimi i mekanizmave balancues të bazuar në treg dhe ndërlidhja e tregjeve nacionale të balancimit në tregun regjional do të promovoj formimin transparent të çmimeve të balancimit, do të nxis konkurrencën në blerjen e shërbimeve të balancimit dhe do të ketë ndikim pozitiv në stabilitetin e rrjetit të transmetimit. Ky proces ka marrë një shtysë (nxitje) shtesë nga Iniciativa WB 6.

Në këtë aspekt aktivitetet e nëngrupit TF-2 kanë rezultuar në: finalizimin e Hulumtimit të modeleve ekzistuese të llogaritjes së imbalanceve në KE, dhe dhënien e inputeve rregullative për projektet regjionale të balancimit të Iniciativës WB 6.

- **TF3 – Monitorimi i tregut me shumicë të energjisë elektrike:**

  Monitorimi i Tregut është një komponentë kyçe e përgjegjësive rregullative, gjë që është përcaktuar edhe me "acquis communautaire"; njoftimi i plotë me performancën e tregut dhe perspektivat zhvillimore mundëson promovimin e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve, efiçiencën e energjisë, investimet dhe sigurinë e furnizimit.

  Në këtë kontekst aktivitetet janë përqendruar në: implementimin e Udhëzimeve për monitorim të tregut dhe Raportin e monitorimit të tregut me shumicë të energjisë elektrike në Palët kontraktuese.

3.3.1.2 Grupi Punues për Gaz (GPG)

Ky grup punues aktivitetet e veta i përqendron në çështjet e rregullimit të sektorit të gazit natyror, harmonizimin e kornizës rregullative në nivel rajonal dhe çështjet tjera të ndërlidhura me zhvillimin e infrastrukturës së gazit natyror në rajonin e EJL. Me qëllim të efikasitetit dhe trajtimit të çështjeve specifike janë krijuar nëngrupet e veçanta ("TaskForce" – TF).

- **TF1 – Tarifat e transmetimit të gazit**

Në kuadër të këtij nëngrupi aktivitetet janë përqendruar fillimisht për të përgatitur rregullatorët e palëve kontraktuese për implementimin e Kodit të Rrjetit për tarifat e transmisionit , përmes marrjes së ekspertizës dhe eksperiencës nga Unioni Evropian. Gjithashtu janë analizuar nivelet dhe strukturat tarifore ekzistuese mes shteteve anëtare të UE dhe palëve kontraktuese të KE-së në kuptim të pajtueshmërisë me Kodin e Rrjetit për tarifat transmisionit të gazit.

- **TF2 – Trajtimi Rregullativ i humbjeve në rrjet**

Në vijim të Hulumtimit për statusin aktual të trajtimit të humbjeve në infrastrukturën e gazit të vendeve regjionale të përgatitur në 2016, aktivitetet në 2017 kanë vazhduar në: metodologjinë e vlerësimit të humbjeve dhe matjen e verifikimin e të dhënave; identifikimin e shkaktarëve kryesorë të humbjeve në rrjet; identifikimin e masave nxitëse për reduktimin e humbjeve; dhe analizimin e efekteve të masave nxitëse të zbatuara për reduktimin e humbjeve.

3.3.1.3 Grupi punues për konsumatorë dhe tregjet me pakicë

Në kuadër të ECRB ekziston grupi punues për konsumatorë me nëngrupet e veta, i cili merret me aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorëve, tarifat dhe çmimet me pakicë, marrëdhëniet kontraktuale mes furnizuesit dhe konsumatorëve, si dhe kualitetin e furnizimit me energji dhe rregullimin e cilësisë së tensionit.

- **TF1 – Vetëdijesimi i konsumatorëve**

Aktivitetet në kuadër të këtij nëngrupi kanë përfshirë informimin dhe vetëdijesimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre në kontekst të një tregu plotësisht të liberalizuar. Po ashtu janë vlerësuar përdorim i aktiviteteve informuese dhe efektet e tyre në Palët kontraktuese. Ky vlerësim

ka shërbyer për të dhënë rekomandimet dhe udhëzimet e mëtejme për përmirësimin e mbrojtjes së konsumatorëve dhe përgatitjen e mjeteve më të përshtatshme të komunikimit me konsumatorët në të ardhmen.

- **TF2 – Monitorimi i tregut me pakicë**

  Monitorimi i tregut është një komponentë themelore e përgjegjësive rregullative; njoftimi i plotë me performancën e tregut dhe perspektivat zhvillimore mundëson që rregullatorët të krijojnë një kornizë efektive që balancon nevojat e pjesëmarrësve të tregut dhe promovimin e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve, efiçiencën e energjisë, investimet dhe sigurinë e furnizimit.

  Në këtë aspekt aktivitetet e këtij nëngrupi përfshijnë: hartimin e Raportit të Monitorimit mbi funksionimin e tregjeve me pakicë të energjisë elektrike dhe gazit natyrorë në KE; dhe dhënia e inputeve për të mbështetur aktivitetet e ACER-it për monitorimin e tregjeve me pakicë të energjisë elektrike dhe gazit.

- **TF3 – Mbrojtja e konsumatorëve në një sistem të mbyllur të shpërndarjes**

  Duke u nisur nga fakti se sistemet e tilla të mbyllura të shpërndarjes mund të shërbejnë që, përveç konsumatorëve të mëdhenj industrial / komercial, të furnizojnë edhe konsumatorët e vegjël komercial dhe shtëpiak, duhet vendosur rregulla të barabarta dhe transparente për mbrojtjen e konsumatorëve. Në këtë kontekst aktivitetet janë fokusuar në: hulumtimin krahasues të kornizave rregullative për sistemet e mbyllura në EU dhe në KE, me synim identifikimin e praktikave më të mira të aplikuara.

- **TF4 – Kualiteti i furnizimit me gaz**

  Sipas Direktivës 2009/73/EC, Autoritetet rregullatore duhet të aprovojnë kërkesat lidhur me kualitetin e furnizimit. Bazuar në eksperiencat e sektorit të energjisë elektrike, në vitin 2017 aktivitetet janë përqendruar në analizimin e standardeve dhe indikatorëve ekzistues, përfshirë edhe ngjashmëritë dhe ndryshimet krahasuar me sektorin e energjisë elektrike. Ky aktivitet ka përfshirë edhe përgatitjen e një dokumenti analitik.

3.3.2 Pjesëmarrja e ZRRE-së në takimet e organizuara nga institucionet ndërkombëtare

ZRRE është pjesëmarrëse në disa institucione ndërkombëtare dhe merr pjesë aktive në takimet që mbahen në kuadër të këtyre institucioneve. Pjesa më e madhe e tyre ka një rol përcaktues për shumë aktivitete të sektorit të energjisë në nivel rajonal dhe nacional.

Më poshtë janë listuar takimet dhe tryezat punuese jashtë vendit në të cilat kanë marrë pjesë përfaqësues të ZRRE-së.

- **08 shkurt 2017** - Takimi 40^{të} i grupit për energji elektrike të ECRB, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Vjenë, Austri;
- **09 shkurt 2017** - 38th ECRB Grupi punuesi i Gazit, organizuar nga Sekretariati I Komunitetit të Energjisë, Vjenë, Austri;
- **20-24 shkurt 2017** – Vizitë studimore në Zagreb ”Zhvillimi i rregullës për monitorimin e Capex” financuar nga USAID Repower;

- **24 mars 2017** – Takimi i ekspertëve ligjorë të palëve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë", organizuar nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, Vjenë Austri;
- **28 mars 2017** – Takimi me temën: Aktivitetet e Gazit në Komunitetin e Energjisë 2020, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë Vjenë, Austri;
- **11-12 maj 2017** – Pjesëmarrje në punëtorinë "A Regional Strategy for Sustainable Hydropower in the Western Balkans", Tiranë;
- **06-09 qershor 2017** – Vizitë studimore në Finlandë "Nevojat për zhvillim në Termokos dhe praktikat më të mira për NQ në Finlandë" - organizuar nga konsulenca e komisionit evropian zyra në Kosovë financuar nga TYEX;
- **06-07-qershor 2017** – Punëtori mbi Harmonizimin dhe Standardizimin e Kodeve të Rrjetit dhe Transmetimit për Gazin Natyror për Rregullatorët e Evropës Juglindorer e organizuar nga USAID NARUC dhe ERRA ne Budapest, Hungari;
- **14 qershor 2017** - Takimi i 37-të i Grupit punues për konsumatorë dhe tregut me pakicë në kuadër të ECRB, organizuar nga Komuniteti ië Energjisë, Vjenë, Austri;
- **19-20 qershor 2017** - Seminari për Sigurinë e Energjisë "Kontributi i vendeve fqinje të BE-së në vendet e Evropës Juglindore për Sigurinë Rajonale të Energjisë: Sfidat dhe Mundësitë për Bashkëpunim", organizuar nga: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Energjisë së Rumanisë në bashkëpunim me RACVIAC – Qendrën për Bashkëpunim të Sigurisë, Rakitje, Kroaci;
- **13 shtator 2017** - Tryeza Punuese me temën "Harmonizimi i Licencave për tregti dhe furnizim me energji elektrike" organizuar nga Sekretariati I Komunitetit të Energjisë, Vjenë, Austri;
- **29 shtator – 02 tetor 2017** – Trajnim Menaxhimi i rrezikut dhe sistemi i kontrollit të brendshëm në Institucionet Publike, FLSA në Ohër Maqedoni;
- **10-11 tetor 2017** – Takim i parë i grupit të energjisë elektrike PECI/PMI dhe Punëtoria – Plani zhvillimor 10 vjeçar i rrjeteve, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Vjenë, Austri;
- **24 tetor 2017** - Takimi 42^{të} i grupit për energji elektrike të ECRB, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Vjenë, Austri;
- **25 -26 tetor 2017** – Punëtoria "Mjeti për krahasimin e çmimeve", organizuar nga NARUC, Sarajevë, Bosnja dhe Hercegovina;
- **07 nëntor 2017** - Takimi i 38-të i Grupit punues për konsumatorë dhe tregut me pakicë në kuadër të ECRB, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Vjenë, Austri;
- **09 nëntor 2017** – Punëtoria lidhur me Transparencën, ENTSOG dhe KE, organizuar nga Sekretariati i Energjisë, Vjene, Austri;
- **17 nëntor 2017** – Takim pune lidhur me bashkëpunimin në tregun e energjisë Kosovë Shqipëri , Tiranë, Shqipëri;

- **21-22 nëntor 2017** – vizitë studimore në Zagreb në Operatorin e tregut të Kroacisë HROTE dhe Rregullatorin e Energjisë së Kroacisë HERA
- **21-22 nëntor 2017** – Vizitë studimore në AIB, dhe në Rregullatorin Flaman, Bruksel, Belgjikë;
- **07 dhjetor 2017** – Trajnim lidhur me "Tregun e energjisë dhe Tregtimi i energjisë", në Vienë, Austri;
- **07-08 dhjetor 2017** - Punëtori "Kodet teknike te shpërndarjes dhe transmetimit te gazit – Projekt nga USAID" mbajtur në Budapest, Hungari, organizuar nga: Agjensioni per zhvillim ndërkombëtar i SHBA-ve (USAID), Asociacioni i Rregullatoreve Rajonal të Energjisë (ERRA), Asociacioni kombetar amerikan i bordit te regullatoreve (NARUC);
- **12 dhjetor 2017** – Pjesëmarrje në punëtorinë "A Regional Strategy for Sustainable Hydropower in the Western Balkans", Shkup, Maqedoni;
- **12 dhjetor 2017** – Takimi i PECI/PMI Selection Group Gas Group SKE, Vjenë, Austri.

3.4 Transparenca dhe përfshirja e publikut në proceset rregullative

Përmes Strategjisë së komunikimit të aprovuar nga Bordi i ZRRE-së, i është dhënë një rëndësi dhe prioritet të veçantë komunikimit me publikun e gjerë. Transparenca e ZRRE-së është garantuar përmes publikimeve të dokumenteve dhe informacioneve që kanë të bëjnë me pjesëmarrësit në sektorin e energjisë.

Janë vënë në diskutim publik të gjitha rregullat që janë amandamentuar me ndryshimin e pakos së tretë legjislative të energjisë. Vlen të theksohet se i gjithë procesi i amandamentimit të rregullave i është nënshtruar publikimeve të drafteve dhe pastaj janë pranuar komentet nga palët e interesuara duke filluar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, të licencuarit, konsumatorët etj. Njoftimet për proceset e shqyrtimeve publike përveç në faqet elektronike janë publikuar edhe si shpallje në gazetat ditore.

Procesi i ndryshimit të strukturës tarifore të energjisë elektrike është paraprirë nga publikimi i dokumentacionit dhe përfshirja e të gjitha palëve të interesuara, çoftë përmes komentimeve me shkrim, seancave dëgjimore si dhe takimeve të veçanta, me Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Odën Ekonomike, OJQ-të e tjera si dhe komunikimet me mediat dhe konsumatorët.

Proces tjetër që është zhvilluar në transparencë të plotë dhe me përfshirje të palëve të tjera ka qenë inicimi i hapjes së tregut të energjisë elektrike, i cili ka filluar me publikimin e "Udhëzuesit për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike" për komentim nga palët dhe pastaj është aprovuar nga Bordi në mbledhje të hapur për publikun.

Faqja elektronike e ZRRE mbetet një nga burimet kryesore të informimit dhe sigurimit të transparencës, ku publikohen të gjitha njoftimet për aktivitete e ZRRE përfshirë mbledhjet e Bordit, të gjitha vendimet e Bordit, regjistrat e aplikuesve për marrjen e autorizimeve, regjistri i licencave për aktivitetet e energjisë, proceset e shqyrtimeve tarifore, legjislacioni primar dhe sekondar dhe shumë informata e dokumente të rëndësishme për sektorin e energjisë. Faqja elektronike e ZRRE

posedon dhe adresën elektronike përmes së cilës pranohen pyetje dhe komente të vazhdueshme nga konsumatorët, investitorët potencial, organizatat e huaja dhe ato joqeveritare, mediat etj.

Për të thelluar edhe më shumë përfshirjen e publikut dhe informimin, ZRRE duke përcjell trendin e përdorimit të rrjeteve sociale nga publiku kosovar, gjatë vitit 2017 ka pasur në funksion edhe faqen e saj në Facebook ku ka publikuar të gjitha njoftimet për aktivitet e ZRRE.

Raportet e ZRRE me mediat janë shumë korrekte, stafi i ZRRE përgjigjet në pyetjet dhe sqarimet që gazetarët shtrojnë për çështjet e rregullimit të sektorit. Me qëllim të mbledhjes së më shumë informatave, në lidhje me zhvillimet në sektor por edhe për të pasur pasqyrë sa më të mirë të përshtypjeve të konsumatorëve për shërbimet e energjisë, ZRRE monitoron në vazhdimësi mjetet e informimit dhe mundohet në vazhdimësi të rrisë transparencën dhe të jap informata të sakta për çështjet rregullative.

4 RAPORTIMI FINANCIAR PËR ZRRE

4.1 Buxheti i ZRRE-së

ZRRE financohet nga të hyrat vetanake, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, kreu 4, përkatësisht nga taksat që mblidhen nga ndërmarrjet dhe operatorët e licencuar në sektorin e energjisë.

Të hyrat

Të gjitha të hyrat e mbledhura të ZRRE janë depozituar në pajtim me nenin 64 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në llogarinë zyrtare bankare të krijuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit.

Në vitin 2017, ZRRE ka mbledhur të hyra në shumë prej 1,412,853.40€. Duke pasur parasysh që shuma totale e buxhetit të shpenzuar nga ZRRE në vitin 2017 është 592,128.02€, të hyrat e pashpenzuara në shume prej 820,725.38€, në pajtim me nenin 23 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, do të derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Tab. 4.1 Të hyrat

Përshkrimi	Shuma
Të hyrat vetjake 2017	1,412,853.40 €
Shpenzimet 2017	(592,128.02) €
Të hyrat e derdhura në Buxhetin e Republikës së Kosovës	820,725.38 €

Buxheti

Kuvendi i Kosovës me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr.05/L-125 për vitin 2017, miratoi buxhetin e ZRRE në shumë prej 768,316€, i cili në tërësi është alokuar si grant qeveritar, edhe pse me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE financohet nga të hyrat vetanake dhe vetëm në rastet kur këto të hyra janë të pamjaftueshme, atëherë ZRRE mund të shfrytëzoj ndarje buxhetore në formë të grantit qeveritar. Sipas kategorive ekonomike buxheti i ZRRE-së është si në vijim:

Tab. 4.2 Buxheti në fillim të vitit

Përshkrimi	Buxheti
Paga dhe mëditje	476,184.00 €
Mallra dhe shërbime	199,332.00 €
Shpenzime komunale	22,000.00 €
Shpenzime kapitale	70,800.00 €
Gjithsej	768,316.00 €

Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës (vendimi nr 01/21) dhe Ligjin Nr. 06/L-002, buxheti i ZRRE-së është shkurtuar për 83,800.00€ dhe atë 25,000.00€ në kategorinë ekonomike “paga dhe mëditje” dhe 58,800.00€ në kategorinë ekonomike “shpenzime kapitale”. Shprehur në përqindje buxheti i ZRRE-së është shkurtuar për 10.90%.

Tab. 4.3 Buxheti final

Përshkrimi	Buxheti
Paga dhe mëditje	451,184.00 €
Mallra dhe shërbime	199,332.00 €
Shpenzime komunale	22,000.00 €
Shpenzime kapitale	12,000.00 €
Gjithsej	684,516.00 €

Shpenzimet buxhetore

Për financimin e aktiviteteve të zhvilluara në vitin 2017, ZRRE ka shpenzuar 592,128.02€.

Sipas klasifikimit ekonomik, shpenzimet e ZRRE-së janë si vijon:

Tab. 4.4 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike

Përshkrimi	Shuma
Paga dhe mëditje	416,031.90 €
Mallra dhe shërbime	149,256.51 €
Shpenzime komunale	18,194.81 €
Shpenzime kapitale	8,644.80 €
Gjithsej	592,128.02 €

Realizimi i buxhetit në raport me buxhetin e mbetur pas shkurtimeve është 86.50%. Realizimi jo i plotë i buxhetit ka ndodhur kryesisht për shkak të ngecjeve të procedurave të prokurimit nga AQP.

Shkalla e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, e shprehur në përqindje, është e paraqitur në tabelën 4.5.

Tab. 4.5 Realizimi i buxhetit i shprehur në përqindje

Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	Ndryshimi	Realizimi në %
Paga dhe mëditje	451,184.00 €	416,031.90 €	35,152.10 €	92.21%
Mallra dhe shërbime	199,332.00 €	149,256.51 €	50,075.49 €	74.88%
Shpenzime komunale	22,000.00 €	18,194.81 €	3,805.19 €	82.70%
Shpenzime kapitale	12,000.00 €	8,644.80 €	3,355.20 €	72.04%
Gjithsej	684,516.00 €	592,128.02 €	92,387.98 €	86.50%



Fig. 4.1 Buxheti dhe shpenzimet për vitin 2017

Në tabelat në vijim pasqyrohen shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Tab. 4.6 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe meditjet	Shuma
Pagat neto	346,715.00 €
Tatimi në të ardhura personale	29,693.70 €
Kontributi pensional i punëdhënësit	19,811.60 €
Kontributi pensional i të punësuarve	19,811.60 €
Gjithsej	416,031.90 €

Në këtë kategori janë shpenzuar gjithsej 416,031.90€ dhe e gjithë shuma është shpenzuar për pagat e rregullta të stafit të ZRRE-së. ZRRE nuk paguan mëditje tjera, me përjashtim të mëditjeve për udhëtime zyrtare jashtë vendit, të cilat paguhen nga *mallrat dhe shërbimet*.

Tab. 4.7 Mallrat dhe shërbimet

Mallrat dhe sherbimet	Shuma
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit	6,470.17 €
Mëditje për udhëtim zyrtar jasht vendit	15,600.05 €
Akomodimi për udhëtime zyrtare jasht vendit	4,986.26 €
Shpenzime tjera për udhëtime zyrtare jasht vendit	1,365.78 €
Shpenzime për Internet	681.48 €
Shpenzimet e telefonisë mobile	11,721.43 €
Shpenzimet postare	159.20 €
Shërbimet arsimit dhe trajnimit	1,540.00 €
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	4,409.75 €
Shërbime shtypjeje	702.98 €
Sherbime kontraktuese tjera	520.00 €
Shpenzimet per anetaresim	4,000.00 €
Mobilje	2,150.00 €
Kompjuter	- €
Hardver per TI	- €
Pajisje tjera	- €
Furnizime për zyrë	6,945.37 €
Furnizim me pije	3,309.89 €
Derivate per gjenerator	98.34 €
Karburant për vetura	3,221.61 €
Regjistrimi i automjeteve	430.00 €
Sigurimi i automjeteve	1,400.87 €
Taksë komunale e rexhistrimit të automjeteve	40.00 €
Sigurimi i ndërtesave	7,015.13 €
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	1,498.30 €
Mirëmbajtja e ndërtesave	4,705.00 €
Mirmbajtja e teknologjisë informative	4,994.00 €
Mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve	907.14 €
Qiraja për ndërtesa	49,140.00 €
Reklamat dhe konkurset	984.00 €
Drekat zyrtare	4,141.90 €
Pagesa e tatimit ne qira	6,117.86 €
Gjithsej	149,256.51 €

Siç shihet nga tabela 4.7, shuma e mjeteve të shpenzuara për këtë kategori është 149,256.51€. Shpenzimet buxhetore në bazë të aktiviteteve janë si vijon:

Tab. 4.8 Shpenzimet sipas aktiviteteve

Shpenzimet sipas aktiviteteve	Shuma
Shpenzimet e udhëtimit	28,422.26 €
Shërbimet e telekomunikimit	12,562.11 €
Shpenzimet për shërbimet	11,172.73 €
Blerja e mobileve dhe pajisjeve	2,150.00 €
Blerje tjera mallra dhe shërbime	10,255.26 €
Derivate dhe lende djegëse	3,319.95 €
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	8,886.00 €
Mirëmbajtja	12,104.44 €
Qiraja	55,257.86 €
Shpenzimet e marketingut	984.00 €
Shpenzimet e përfaqësimit	4,141.90 €
Gjithsej	149,256.51 €

Tab. 4.9 Shpenzimet komunale

Shpenzimet komunale	Shuma
Rryma	16,644.30 €
Uji	501.05 €
Shpenzimet e telefonit	1,049.46 €
Gjithsej	18,194.81 €

Shuma e mjeteve të shpenzuara për kategorinë e shpenzimeve komunale është 18,194.81€. Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2017 është shpenzuar afërsisht shumë e njëjtë e buxhetit.

Tab. 4.10 Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale	Shuma
Softwer	8,644.80 €
Gjithsej	8,644.80 €

5 SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE

5.1 Karakteristikat e sektorit të energjisë elektrike

Kosova posedon parakushte për prodhimin e energjisë elektrike, jo vetëm për të mbuluar nevojat e veta, por edhe për të eksportuar. Sistemi elektroenergjetik i Kosovës është i dizajnuar kryesisht për të prodhuar energji elektrike bazë, e cila bazohet në linjit si lëndë e parë, por jo edhe për mbulimin e ngarkesave maksimale dhe balancimin e sistemit. Për këtë arsye mbetet sfidë e madhe balancimi i sistemit për të gjithë pjesëmarrësit në sektor.

Sektori i energjisë elektrike përbëhet nga gjenerimi, transmetimi, shpërndarja dhe furnizimi i konsumatorëve.



Fig. 5.1 Organizimi i sektorit të energjisë elektrike

Kosova ka kapacitete të instaluara prodhuese prej 1,560 MW, megjithatë kapaciteti operativ konsiderohet rreth 1,038 MW. Pjesa më e madhe e këtyre kapaciteteve prodhuese është e përbërë nga termocentralet (TC) me linjit me rreth 92.5%, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga hidrocentralet, panelet solare dhe centralet me erë. Këto kapacitete japin parakushte, jo vetëm për të mbuluar konsumin, por edhe për të eksportuar, por për shkak të vjetërsisë së termocentraleve dhe jofleksibilitetit të mjaftueshëm për t'iu përshtatur konsumit në periudha të ndryshme e sidomos në kohën e pikut dhe/apo gjatë natës, atëherë nevojiten importe gjegjësisht eksporte për balancimin e sistemit. Gjithashtu kapacitetet tjera gjeneruese hidrike (HC) dhe BRE, përveç që janë të vogla

dhe/apo nuk kanë basene akumuluese, nuk kanë mundësi të ofrojnë shërbime të balancimit të sistemit.

Figura më poshtë paraqet prodhimin dhe importin e energjisë elektrike gjatë dhjetë viteve të fundit.



Fig. 5.2 Prodhimi, importi dhe kërkesa e energjisë 2008 - 2017

Për arsye të ndryshme mund të koincidoj që të ketë import edhe eksport në të njëjtën periudhë madje edhe në të njëjtën orë. Kjo dukuri ndodhë në raste të ndryshme p.sh. kur është kontraktuar eksport, ndërsa në ndërkohë ka rënie të ndonjë njësie gjeneruese, ose kur është kontraktuar import, por njësia gjeneruese është kthyer në sistem më herët se parashikimi apo edhe me rastin e ndryshimit të prodhimit. Ndonjëherë kjo ndodhë edhe për shkak të ndryshimit të madh të kërkesës si p.sh. me rastin e ndryshimit të kushteve atmosferike- ngritje apo rënie e temperaturave.

Futja e gjeneratorëve nga BRE-të rritë kapacitetin operativ të gjenerimit, por në shumicën e rasteve ato janë të pa parashikueshme dhe janë në regjimin e prioritetit të dispeçimit, prandaj nuk kanë ndikim në përmirësimin e balancimit të sistemit energjetik, madje ndonjëherë i rrisin imbalancet. Lidhur me investimet në BRE, institucionet energjetike ndërkombëtare vite më herët kanë konsideruar si të nevojshme që për çdo MW të instaluar të BRE-ve të ketë po aq rezervë gjeneruese konvencionale të instaluar, për të mbuluar kërkesën në rast të ndryshimit të prodhimit apo dështimit të gjeneratorëve nga BRE-të.

5.1.1 Tregu i energjisë elektrike

Liberalizimi i tregut është orientim i të gjitha vendeve të rajonit e po ashtu edhe Kosovës, që në fund rezulton me rritjen e konkurrencës, uljen e çmimeve dhe përmirësimin e shërbimeve për konsumatorët.

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë përfshinë tregtimin bilateral të energjisë elektrike dhe tregtimin për të balancuar sistemin e energjisë elektrike.

Kosova është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, që i hap mundësi bashkëpunimi me vendet e rajonit, por edhe krijon obligime të cilat dalin nga kërkesat e Traktatit dhe kërkesat e Komunitetit të Energjisë të shprehura përmes pakove të legjislacionit të BE-së për energjinë. Këto pako përfshijnë rregulloret, direktivat dhe udhëzuesit për funksionimin e sistemeve energjetike në Komunitetin e Energjisë.

Si parakusht për liberalizim të suksesshëm të tregut është reformimi i sektorit të energjisë, që në Kosovë daton nga viti 2004 kur janë zhvilluar ligjet e energjisë dhe është themeluar ZRRE. Procesi ka vazhduar me shthurjen e kompanisë vertikalisht të integruar KEK, dhe krijimin e Operatorit të sistemit të transmetimit dhe tregut - KOSTT në vitin 2006. KOSTT mbanë funksionin e Operatorit të sistemit të transmetimit dhe Operatorit të tregut dhe i përgjigjet Kuvendit të Kosovës sipas legjislacionit të ri të vitit 2016. Shthurja e mëtejme ka vazhduar me ndarjen e shpërndarjes dhe furnizimit nga KEK-u, dhe pastaj, shpërndarja dhe furnizimi janë privatizuar në maj të vitit 2013. Nga viti 2015 është bërë shthurja ligjore e shpërndarjes nga furnizimi, që ka rezultuar me krijimin e dy kompanive KEDS – Operatori i sistemit të shpërndarjes dhe KESCO – Furnizuesi i energjisë elektrike.

Për të mbështetur liberalizimin e tregut dhe rritjen e konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike, ZRRE në janar të vitit 2017 ka aprovuar dokumentin “Udhëzuesi për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë”. Ky udhëzues përcakton mënyrën, kushtet dhe kohën e liberalizimit të tregut, në aktivitetin e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike.

Bazuar në Udhëzuesin, prodhuesit e energjisë elektrike janë të obliguar t’iu ofrojnë konsumatorëve në tregje me shumicë dhe pakicë duke përfshirë edhe atyre me obligime të shërbimit publik kapacitetin e tyre në mënyrë transparente, jo diskriminuese dhe të bazuar në treg.

Humbjet e energjisë elektrike gjatë vitit 2017 kanë filluar të blihen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në tregun konkurrues të energjisë elektrike. Bazuar në dokumentin “Përshkrimi i trajtimit të energjisë me shumicë në fazën tranzitore”, energjia e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes sigurohen në mënyrë proporcionale nga energjia e mbetur nga KEK pas alokimit të energjisë për shërbimin universal. Nëse energjia e pranuar nga KEK nuk është e mjaftueshme për mbulimin e humbjeve, atëherë pjesa tjetër e energjisë së nevojshme sigurohet nga importi.

Nga tetori i vitit 2016, Feronikeli është duke u furnizuar me energji elektrike me çmime të parregulluara. Mirëpo në muajin shkurt 2017 janë paraqitur pengesa në furnizim për shkak të disa kufizimeve në sistemin e transmetimit në Bullgari, kështu që Feronikeli është furnizuar me çmime të rregulluara, e pas kësaj ka vazhduar me furnizim me çmime të parregulluara.

Në vitin 2017 ka pasur rritje të kërkesës për energji elektrike, ndërsa pjesëmarrja sipas kategorive të ndryshme të konsumit, përfshirë edhe humbjet e sistemit, është paraqitur në figurën e mëposhtme.



Fig. 5.3 Pjesëmarrja e konsumit të rregulluar, të parregulluar dhe humbjeve ndaj kërkesës, 2017

Nga kërkesa e përgjithshme e sistemit prej 5,686 GWh për vitin 2017, 63.8 % merr pjesë konsumi me të drejtën e shërbimit universal, 8.36% konsumi me çmime të parregulluara dhe 27.83% humbjet e përgjithshme të sistemit.

Në tre kuartalet e para të vitit 2017 Kosova ka qenë neto eksportuese e energjisë elektrike ndërsa në kuartalin e katërt ka qenë neto importuese e energjisë elektrike. Ndikimi i tremujorit të katërt ka qenë i madh dhe e ka kthyer Kosovën nga neto eksportuese në neto importuese, ku neto importi i përgjithshëm ka qenë 362 GWh. Kjo situatë përveç tjerash është shkaktuar edhe për shkak të problemit me furnizim me thëngjill të termocentraleve, si pasojë e vonesave në shpronësim të hapësirave të mihjeve, të përshkruar më poshtë te pjesa e prodhimit të energjisë.

Bazuar në Ligjin për Energjinë Elektrike në rast se synimet e shërbimit universal nuk mund të arrihen në kushte të tregut, Rregullatori mund të rregullojë çmimet e energjisë elektrike të blerësve fundorë që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal, me kusht që të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

Siguria e furnizimit të energjisë, si synim kryesorë i sektorit, përveç tjerash varet nga kapacitetet prodhuese, por edhe transmetuese dhe shpërndarëse. Meqenëse TC Kosova A është mjaft e vjetruar mbi 40 vjet, e poashtu edhe TC Kosova B ka një periudhë operimi të konsiderueshme, atëherë nevojiten investime të reja, si të energjisë bazë poashtu edhe në BRE. ZRRE ka lëshuar një numër të konsiderueshëm të autorizimeve për ndërtim të kapaciteteve të reja të energjisë nga BRE.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me datën 20 dhjetor 2017, ka nënshkruar marrëveshjen komerciale me kompaninë Contour Global për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re. Ndërtimi i këtij termocentrali pritet ti jap pavarësi energjetike Kosovës, që poashtu mund të konsiderohet si zëvendësim i TC Kosova A, e cila duhet të dekomisionohet me futjen në operim të TC Kosova e Re.

Kapaciteti i instaluar i TC Kosova e Re do të jetë 500 MW, ndërsa në rrjet do të jap rreth 450 MWh/h. Termocentrali ka edhe mundësinë e përkrahjes së kogjenerimit deri në 10% të kapacitetit

të saj. Parametrat e termocentralit Kosova e Re do të jenë sipas standardeve dhe kritereve të BE për kufizimet e emetimeve të ndotësve të ambientit.

Gjendja teknike e sektorit të energjisë është në përmirësim e sipër gjatë viteve të fundit. Kësaj i kontribuon edhe marrëveshja e nënshkruar për ndërtimin e TC Kosova e Re, por për funksionim të rregullt dhe furnizim të sigurt të vendit me energji elektrike, nevojiten investime edhe në nën-sektorët tjerë.

5.2 Prodhimi dhe konsumi i linjitit

Kosova ka rezerva të mëdha të linjitit që mundësojnë një siguri të prodhimit të energjisë elektrike afatgjate, mirëpo mbetet si problem ndikimi në mjedis për shkak të emetimit të gazrave serrë dhe ndotësve tjerë. Rreth 92.5% të kapaciteteve të instaluara të prodhimit të energjisë elektrike përbëjnë termocentralet të cilat operojnë me linjit, si burim primar të energjisë.

Prodhimi i linjitit në vitin 2017 ka qenë 7.57 mil. ton, ndërsa konsumi 7.65 mil. ton, sasi këto që janë më të vogla në krahasim me vitin 2016, për shkak të pamundësisë së zgjerimit të mihjeve sipërfaqësore për eksploatimin e thëngjillit. Prodhimi dhe konsumi i linjitit sipas muajve, për vitin 2017 është paraqitur në tabelën 5.1.

Tab. 5.1 Prodhimi dhe konsumi i linjitit në vitin 2017

Prodhimi/konsumi i linjitit	Totali	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Prodhimi i linjitit (t*1000)	7,575	682	623	799	623	710	619	501	655	643	672	474	572
Konsumi i linjitit (t*1000)	7,645	859	601	860	590	678	763	530	552	664	727	368	451
Konsumi i linjitit në treg (t*1000)	183.3	14.7	20.1	20.7	20.1	10.6	18.6	22.4	4.9	0.8	20.0	15.3	14.9

Në figurën e mëposhtme mund të shihet prodhimi dhe konsumi i linjit gjatë viteve 2008 – 2017.



Fig. 5.4 Prodhimi dhe konsumi i linjitit në vitet 2008 - 2017

5.3 Prodhimi i energjisë elektrike

5.3.1 Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike

Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike janë:

- Termocentralet;
- Hidrocentralet; dhe
- Burimet e ripërtëritshme të energjisë (HC të vogla, centrale me Erë dhe Panele Fotovoltaike).

Kapaciteti i njësive gjeneruese është paraqitur në tabelën e mëposhtme sipas llojit të lëndës primare, kapacitetit instalues dhe operativ, kufijtë minimal dhe maksimal të prodhimit dhe vitit të futjes në operim.

Tab. 5.2 Kapacitetet gjeneruese në sistemin elektroenergjetik të Kosovës

Njësitë prodhuese	Kapaciteti i njësive (MW)			Futja në operim
	Instaluar	Neto	Min/max	
A1	65	Nuk operon		1962
A2	125	Nuk operon		1964
A3	200	144	100-130	1970
A4	200	144	100-130	1974
A5	210	144	100-135	1975
TC Kosova A	800	432		
B1	339	264	180-260	1983
B2	339	264	180-260	1984
TC Kosova B	678	528		
HC Ujmani	35.00	32.00		1983
HC Lumbardhi	8.08	8.00		(1957) 2006
HC Dikanci	4.02	3.34		(1957) 2013
HC Radavci	1.00	0.90		(1934) 2010
HC Burimi	0.95	0.85		(1948) 2011
Total HC	49.05	45.09		
EGU Belaja	8.06	7.50		2016
EGU Deçani	9.81	9.50		2016
HC Hydroline-Albaniku III	4.27	4.27		2016
HC Brod II	4.80	4.80		2015
Wind Power	1.35	1.35		2010
LedLight	0.10	0.10		2015
Centrali fotovoltaik ONIX	0.50	0.50		2016
Restelica 1&2	2.28	2.28		2016
HC Brezovica	2.10	2.10		2017
Total BRE	33.27	32.40		
Gjithsej	1,560.32	1,037.50		

Kapaciteti i instaluar i termocentraleve do të ishte i mjaftueshëm për të mbuluar kërkesën për energji elektrike, por për shkak të vjetërsisë, kapaciteti operativ i tyre është zvogëluar dukshëm, që

rrjedhimisht ndikon në prodhim të zvogëluar të energjisë elektrike. Po ashtu problem është edhe balancimi i sistemit meqenëse prodhimi kryesisht realizohet nga termocentrale jofleksibile si dhe BRE që po ashtu nuk ndihmojnë në balancim.

Derisa kapaciteti i instaluar i njësive gjeneruese është 1,560.32 MW, kapaciteti operativ është dukshëm më i ulët me rreth 1,037.50 MW. Prej këtij kapaciteti, termocentralet kanë kapacitet operativ rreth 960 MW, ndërsa pjesa tjetër e kapaciteteve prodhuese është nga hidrocentrali Ujmani, Lumbardhi dhe BRE-të me kapacitet të gjithmbarshëm të prodhimit prej 77.5 MW.

Gjatë viteve të fundit ka rritje në kapacitetet e instaluara gjeneruese nga BRE-të, të cilat vazhdojnë të futën në operim si investime private.

5.3.2 Prodhimi i energjisë elektrike

Prodhimi i gjithmbarshëm i energjisë elektrike në vitin 2017 ka qenë 5,300 GWh, ndërsa në vitin 2016 ka qenë 5,835 GWh, që do të thotë se ka një zvogëlim prej 9.01 % në krahasim me vitin 2016. Po ashtu, krahasuar me bilancin e energjisë elektrike për vitin 2017 prodhimi është realizuar vetëm rreth 90.96 % kryesisht për shkak të problemeve rreth mihjeve të reja. Prodhimi përfshirë edhe shpenzimet vetanake sipas njësive dhe muajve gjatë vitit 2017 është paraqitur në tabelën 5.3.

Tab. 5.3 Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2017

Prodhuesit MWh	Gjithsej	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
TC A3 bruto	458,139	0	66,295	0	0	52,483	86,443	107,834	72,966	4,152	67,966	0	0
TC A4 bruto	824,241	78,033	66,152	103,730	96,498	47,713	104,957	107,559	45,560	81,302	0	29,563	63,172
TC A5 bruto	801,622	106,129	36,606	111,781	105,504	101,313	1,127	0	89,735	102,775	71,307	75,346	0
TC A Shpenz vet	257,121	25,602	21,658	25,448	24,406	25,986	22,189	23,757	25,104	22,366	18,204	14,049	8,351
TC A prag	1,826,881	158,561	147,395	190,063	177,596	175,522	170,339	191,637	183,157	165,863	121,068	90,860	54,821
TC B1 bruto	1,857,690	194,596	132,152	191,261	141,834	181,991	186,332	187,346	64,634	91,907	203,352	141,522	140,765
TC B2 bruto	1,784,271	206,930	181,709	203,049	114,048	188,001	190,903	41,169	138,012	181,835	183,757	63,467	91,391
TC B Shpenz vet	347,786	37,967	30,677	36,736	25,428	34,548	35,147	22,478	19,517	25,346	35,534	20,150	24,257
TC B prag	3,294,175	363,558	283,184	357,574	230,453	335,444	342,087	206,037	183,129	248,395	351,574	184,840	207,898
Ujman+Lumb.	136,308	10,286	10,100	20,745	18,631	22,404	14,508	8,662	5,161	4,356	4,707	6,172	10,575
HC Distributive	42,951	1,602	3,217	4,984	6,153	8,395	5,314	1,949	1,196	1,004	1,362	2,243	5,532
Gjithsej	**5,300,315**	**534,006**	**443,896**	**573,366**	**432,833**	**541,765**	**532,249**	**408,286**	**372,643**	**419,618**	**478,712**	**284,115**	**278,826**
Bilanci 2017	5,827,106	533,123	478,692	545,553	459,634	562,254	538,251	394,583	330,032	465,808	551,789	416,854	550,533
Raporti tot./bil	90.96%	100.17%	92.73%	105.10%	94.17%	96.36%	98.88%	103.47%	112.91%	90.08%	86.76%	68.16%	50.65%

Duhet të theksohet se 10.56% e energjisë nga bruto prodhimi i termocentraleve është konsumuar nga vet termocentralet si shpenzim vetanak. Një pjesë e këtyre shpenzimeve vetanake (për të dy gjeneratorët TC Kosova A dhe TC Kosova B) realizohet drejtpërsëdrejti nga impiantet e brendshme, ndërsa pjesa tjetër futet në sistemin e transmetimit dhe kthehet mbrapa në termocentrale.

Figura e mëposhtme paraqet pjesëmarrjen e gjeneratorëve në prodhimin e përgjithshëm të energjisë elektrike në vitin 2017.



Fig. 5.5 Prodhimi i njësive gjeneruese në vitin 2017

Deri në muajin tetor të vitit 2017 prodhimi i përgjithshëm ka tejkaluar konsumin për të njëjtën periudhë, kështu që eksporti i energjisë ishte shumë më i lartë se importi, por nga nëntori kjo gjendje ka ndryshuar për shkak të problemeve të pazgjidhura me shpronësimin e fshatrave Hade dhe Shipitullë. Në këtë periudhë rezervat e thëngjillit të KEK kanë qenë të pakta, e mundësia për shfrytëzimin e hapësirave të reja ka qenë e pamundur deri në gjetjen e një zgjidhjeje për kompensimin e pronave.

Kjo situatë e krijuar rreth shpronësimit e ka dëmtuar KEK-un financiarisht duke pasur parasysh se kërkesat për kompensim të pronave kanë arritur vlera shumë më të larta se çmimi i vlerësuar paraprakisht vite më parë. E tërë kjo ka shkaktuar që operimi i gjeneratorëve të KEK-ut në muajin nëntor dhe dhjetor të përgjysmohet dhe si rezultat i kësaj janë imponuar importe të shtuara për të mbuluar energjinë elektrike të pa prodhuar. Përveç kësaj, KEK është dëmtuar financiarisht edhe për shkak të zvogëlimit të prodhimit e me këtë i janë zvogëluar të hyrat e realizuara krahasuar me parashikimin sipas bilancit energjetik.

Shtimi i importit për shkak të prodhimit të zvogëluar të KEK, si dhe çmimet e larta të importit gjatë kësaj periudhe, kanë afektuar edhe furnizuesin (përfshirë edhe operatorin e rrjetit të shpërndarjes për mbulimin e humbjeve në shpërndarje) për shkak të ndryshimit të çmimit të energjisë së parashikuar që furnizuesi do të pranonte nga KEK dhe çmimit të energjisë së importuar.

Po ashtu kjo situatë ka afektuar edhe operatorin e sistemit të transmetimit meqë energjinë për mbulimin e humbjeve në transmetim, në vend se ta pranon nga KEK-u si kthim borxhi i përcaktuar nga ZRRE, KOSTT është detyruar që këtë energji ta importoj me çmime mjaft të larta.

Prodhimi i BRE-ve në vitin 2017 ka qenë 42,951 MWh dhe është më i ulët për 20.5% se në vitin 2016.



Fig. 5.6 Prodhimi i BRE-ve në vitin 2017

Operimi i njësive gjeneruese

Operimi i njësive gjeneruese gjatë vitit 2017 deri në dy muajt e fundit të vitit ka qenë i kënaqshëm, i përafërt me parashikimet në bilancin energjetik, si për orët në operim po ashtu edhe për energjinë e dhënë në sistem. Numri i daljeve nga operimi i njësive gjeneruese në termocentrale ka qenë më i lartë krahasuar me vitin e kaluar, dhe këto ndalesa mund të ndahen në ndalje të planifikuara, ndalje të paplanifikuara dhe rënie.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura të gjitha llojet e ndaljeve dhe disponueshmëria e termocentraleve për vitin 2017.

Tab. 5.4 Ndalesat e njësive gjeneruese 2017

2017	TC Kosova A			TC Kosova B	
	A3	A4	A5	B1	B2
Ndalesat e planifikuara	3	3	4	3	4
Ndalesat e paplanifikuara	6	4	1	8	5
Rëniet	1	4	1	7	6
Gjithsej ndalesa	10	11	6	18	15

Orët e operimit të njësive gjeneruese të TC Kosova A dhe TC Kosova B në formë grafike janë paraqitur në figurën e mëposhtme dhe kanë qenë më të ulëta, e sidomos kjo vlen për njësinë A3 e cila ka punuar vetëm 37.57% të kohës.



Fig. 5.7 Operimi i njësive gjeneruese në vitin 2017

Figura e mëposhtme paraqet trendin e prodhimit të njësive gjeneruese për periudhën 2008 – 2017.



Fig. 5.8 Prodhimi i energjisë elektrike për vitet 2008 – 2017

5.4 Sistemi i transmetimit

Sistemi i transmetimit në Kosovë, operohet nga KOSTT që është përgjegjës për sigurinë dhe besueshmërinë e operimit të sistemit elektroenergjetik, i cili ka kapacitete të mjaftueshme për të përballuar rrjedhat e energjisë në sistem. KOSTT bënë koordinimin në mes operimit të sistemit dhe këtyre rrjedhave të energjisë përmes rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike i cili ndërlidhet me sistemin elektroenergjetik të rajonit dhe Evropës përmes linjave të këtyre vendeve:

- Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë – me linja 400 kV;
- Shqipërinë dhe Serbinë – me linja 220 kV; dhe
- Serbinë - me dy linja 110 kV.

Linja interkonektive 400 kV NS Kosovë B – NS Kashar (Tiranë) është finalizuar në vitin 2016 përfshirë lëshimin me sukses në punë testuese, por për shkaqe politike ende nuk është futur në operim të rregullt. Marrëveshja e nënshkruar për Rregullimin Sekondar Frekuencë/Fuqi në mes të KOSTT dhe OST të Shqipërisë po ashtu mbetet e pa implementuar meqë KOSTT ende nuk ka filluar të operoj si zonë/bllok rregullues në kuadër të ENTSO-E.

Rrjeti i transmetimit të sistemit elektroenergjetik të Kosovës është i ndërlidhur mirë me sistemin rajonal dhe plotëson nevojat vendore të transmetimit si dhe kriterin N-1, përveç linjës Prizren 2 – Rahovec e cila mbetet me furnizim radial.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur kapacitetet transformuese dhe linjat e rrjetit të transmetimit, sipas nivelit të tensionit:

Tab. 5.5 Nënstacionet në rrjetin e transmetimit

Transformimi (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia (MVA)
400/220	KOSTT	1	3	1,200
400/110	KOSTT	2	4	1,200
220/110	KOSTT	3	9	1,350
220/35	Feronikel	1	2	320
220/35/10(20) (Besiana)	KOSTT	1	1	40
220/10(20) (Besiana)	KOSTT	-	1	40
110/35/10(20)	KOSTT	7	7	278
110/35/6.3	Trepça	1	2	126
110/6.3	Trepça	-	2	63
110/35	Ujmani	1	1	20
110/6.3	Sharri	1	2	40
110/10(20)	KOSTT	11	22	790
110/35	KOSTT	6	19	641
110/10	KOSTT	3	8	252
35/110 (Deçan)	Kelkos	-	1	40
Gjithsej		38	84	6,399

Tab. 5.6 Linjat në rrjetin e transmetimit

Tensioni (kV)	Pronari	Gjatësia (km)
400	KOSTT	279.5
220	KOSTT	231.8
110	KOSTT	841.8
Gjithsej		1,353.1

5.4.1 Rrjedhat e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit

Nëpër rrjetin e transmetimit ka rrjedha të konsiderueshme të energjisë për të mbuluar kërkesën e konsumatorëve nga prodhimi vendor dhe importi por edhe për eksportet eventuale të tepricave të energjisë elektrike, e po ashtu edhe për energjinë e cila transitohet nga vendet tjera. Transiti i energjisë elektrike nëpër rrjetin e Kosovës në vitin 2017 ka qenë rreth 26% krahasuar me konsumin, dhe kjo energji ngarkon rrjetin duke shtuar humbjet, amortizimin e rrjetit, si dhe nevojën për mirëmbajtje të rrjetit të transmetimit.

Figura e mëposhtme paraqet rrjedhat e energjisë nëpër të gjitha linjat ndërlidhëse (interkonektive) në të dyja drejtimet (hyrje, dalje).



Fig. 5.9 Rrjedhat e energjisë nëpër linjat ndërlidhëse (interkonektive)

Kompensimi për shpenzimet e transitit dhe obligimet për importet dhe eksportet bëhet përmes Mekanizmit ITC ku kalkulohen obligimet dhe kërkesat, dhe në fund bëhet barazimi i gjendjes përfundimtare për tërë rajonin. Nga 1 janar 2016, KOSTT-i merr pjesë në ITC Mekanizmin për kalkulimin e kompensimit për shpenzimet e transitit dhe obligimet për importet dhe eksportet. Vlen

të theksohet se pjesëmarrja e transitit në rrjetin e sistemit të transmetimit në periudha më të hershme ka qenë shumë më e lartë (madje edhe mbi 50%), por ka trend të rënies sidomos me rritjen e kërkesës vendore.

Lidhur me operimin e rrjetit transmetues duhet përmendur edhe pamundësinë e KOSTT-it për alokimin e kapaciteteve transmetuese për shkak të mos njohjes së KOSTT-it si zonë/bllok rregulluese. Alokimi i kapaciteteve do të krijonte të hyra për KOSTT-in që mund të shfrytëzoheshin për riparimin dhe mirëmbajtjen e kapaciteteve transmetuese, si dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja transmetuese aty ku paraqiten ngulfatje të rrjetit. Edhe më tutje alokimin e kapaciteteve për linjat e Kosovës e bënë Operatori i sistemit të transmetimit të Serbisë (EMS), si dhe mbledhë të hyrat financiare nga ky alokim.

Implementimi i marrëveshjes së nënshkruar për energjinë elektrike në mes Kosovës dhe Serbisë ende nuk është realizuar edhe pse ka qenë i paraparë qysh në nëntor 2015, por ka qenë i kushtëzuar me licencimin dhe operacionalizimin e një furnizuesi me energji elektrike në veri të Kosovës. Kjo nuk është realizuar ende, dhe për këtë arsye implementimi i marrëveshjes së kyçjes së KOSTT-it në ENTSO-E edhe më tej nuk ka ndodhur.

Për sigurinë e furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike përveç funksionimit të rregullt të rrjetit të transmetimit ndikim kanë edhe faktorët tjerë siç janë gjenerimi, konsumi, importi, eksporti i energjisë elektrike.

Në figurën 5.10 është paraqitur rrjedha e energjisë elektrike nga gjenerimi, transmetimi deri te shpërndarja te konsumatorët, si dhe rrjedhat e energjisë elektrike drejt rrjeteve rajonale përfshirë transitin.



Fig. 5.10 Rrjedhat e energjisë elektrike në sistem në vitin 2017

5.4.2 Investimet në sistemin e transmetimit

Për nivel të qëndrueshëm të furnizimit me energji elektrike, zvogëlim të humbjeve dhe përmirësim të sigurisë dhe kualitetit të shërbimeve, nevojiten investime në pjesë të caktuara të rrjetit, si dhe mirëmbajtje adekuate e kapaciteteve ekzistuese.

Investimet në sistemin e transmetimit mund t'i kategorizojmë si:

- Projektet e filluara në vitet e mëparshme e që kanë përfunduar në vitin 2017 dhe janë në afat garantues; dhe
- Projektet e filluara në vitet 2016/2017 dhe vazhdojnë më tutje.

Projektet e filluara në vitet e mëparshme e që kanë përfunduar në vitin 2017 dhe janë në afat garantues

- Paket Projekti "Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit faza IV & V":

  LOT1- Nënstacionet - *projekti i përfunduar*
  - Rehabilitimi i ndërprerësve në NS 220/110 kV Prishtina 4;
  - Instalimi i Grupeve Matëse në linjat interkonektive;
  - Fushat transformatorike 400/110 kV në NS Peja 3 *(projekt i përfunduar në vitin 2016)*
  - NS 110/35/10 kV Peja 1 – stabilimentet GIS *(5 fusha 110 kV, janë kompletuar vitin 2016 - 79%). GIS është energjizuar (*2 fushat 110 kV të GIS, në NS Peja 1*, janë përfunduar në vitin 2017 - 21%) .*

  LOT 3 - Linjat transmetuese – *projekti i përfunduar*
  - Rehabilitimi i linjës 110 kV, NS Peja 2 – NS Deçan;

  LOT 4 - Rehabilitimi i 19 nënstacioneve - *projekti i përfunduar*;
  - Ndërrimi i pajisjeve të TL (Tensionit të Lartë) dhe TM (Tensionit të Mesëm) në NS Viti;
  - Ndërrimi i pajisjeve të TL dhe TM në NS Lipjan;
  - Furnizimi dhe instalimi i transformatorit të fuqisë TR 3 – 40 MVA, në NS Lipjan;
  - Ndërrimi i ndarësve të fuqisë në NS 220/110 kV Prishtina 4;
  - Ndërrimi i shpenzimeve vetanake AC/DC në nënstacionet 110 kV;
  - Ndërrimi i sistemit të kontrollit në NS Kosova B, NS Besiana dhe NS Prishtina 5;
- Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispeçerike dhe në Qendrën Emergjente Dispeçerike - *projekti i përfunduar;*
- Instalimi i grupeve matëse në kufirin e ri mes KOSTT dhe KEK/OSSH - *Projekti është i përfunduar në total 95%*. Mbeten të pa realizuara punët në NS Vallaq dhe NS Ujman (për shkak të situatës politike) dhe NS Theranda për shkak të mos krijimit të kushteve për punë;
- Instalimi i TR 2 ne NS 110/10(20) - Skenderaj dhe instalimi i TR në NS Burim - *projekti i përfunduar*;
- Revitalizimi i nënstacioneve 110kV, ana 35kV (Gjilani 1 dhe Ferizaji 1) - *projekti i përfunduar;*

- Projekte tjera nga PZH: Furnizimi me ndërprerës 400kV, Renovimi i Lokalit 200m^2 në Kurriz, Furnizimi me bateri 48V DC për rrjetin e pajisjeve transmetuese telekomunikuese, etj.

Projektet e filluara në vitet 2016/2017 dhe që vazhdojnë më tutje

Në Q3 të vitit 2016 janë nënshkruar kontratat për projektet që financohen nga BERZH/KOSTT dhe duhet të përfundojnë në Q4 2018 dhe Q3 2019. Këto projekte janë në fazën e dizajnimit, prodhimit dhe liferimit të pajisjeve. Punët ndërtimore dhe ato instaluese pritet të fillojnë në momentin e krijimit të kushteve për punë pas marrjes së lejeve për ndërtim.

LOT 1 – Nënstacionet GIS në vazhdimësi,

- 110/10(20) kV – NS Prishtina 6 dhe 110 kV HIS në NS Prishtina 4 (*dizajni 80 %, liferimi i pajisjeve është 80 %);*
- 110/10(20) kV – NS Mitrovica 2 *(dizajni 80 %, liferimi i pajisjeve është 80 %);*
- 220/10(20) kV – NS Drenasi 2 *(dizajni 80 %, liferimi i pajisjeve është 80 %);*
- Në NS 110/35/10 kV Theranda - Rehabilitimi i nënstacionit, kanë filluar punët ndërtimore dhe ato instaluese *(dizajni 90 %, liferimi i pajisjeve është 80 % dhe punët ndërtimore 60%)*

LOT 2 – Transformatorët e fuqisë: 40MVA

- 2x40 MVA NS Prishtina 6, 2x40 MVA në NS Mitrovica 2, dhe 2x40 MVA në NS Drenasi 2, janë në fazën e dizajnimit dhe prodhimit të transformatorëve 65% ;

LOT 3 **–** Linjat transmetuese: janë përfunduar kryesisht punët e dizajnit 70%, prodhimi dhe liferimi i kabllove 100%,

- linja 110 kV e njëfishtë ajrore NS Rahoveci – NS Theranda,
- linja 110 kV e dyfishtë ajrore dhe kabllovike, NS Fushë Kosova,
- linja 220 kV e dyfishtë ajrore Drenasi 2,
- linja 110 kV e dyfishtë kabllovike NS Mitrovica 2, dhe
- linja 110 kV e dyfishtë kabllovike, NS Pristina 6 – NS Prishtina 4.

  Punët janë në fazën e dizajnimit të linjave 70%, prodhimi dhe liferimi i kabllove pjesërisht ka përfunduar 100%.

Në tabelën e mëposhtme janë prezantuar investimet kapitale të lejuara dhe të realizuara të KOSTT për periudhën e parë të shqyrtimit periodik shumë-vjeçar tarifor 2013 -2017.

Tab. 5.7 Investimet në KOSTT në 5 vitet e fundit

INVESTIMET NË KOSTT PËR PERIUDHËN SHUMËVJEÇARE		
Operatori Sistemi Transmisioni dhe Tregu		
Viti	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)
2013	33.65	21.29
2014	31.18	12.46
2015	26.90	36.91
2016	15.45	24.62
2017	13.06	27.48
Gjithsej	120.25	122.76

5.4.3 Ngarkesat maksimale dhe kërkesa për energji në sistemin elektroenergjetik

Për të analizuar funksionimin e sistemit elektroenergjetik, ndër të tjera rëndësi ka edhe vlera e ngarkesave maksimale (pikut) e për këtë merren zakonisht pesë (5) ngarkesat maksimale të realizuara në orë dhe ditë të ndryshme të vitit. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vlerat e ngarkesave maksimale (pikut) për vitin 2017.

Tab. 5.8 Vlerat e ngarkesave maksimale (pikut) në vitin 2017

Ngarkesa maksimale Pmax (MW)	Data	Ora
1,161	11.01.2017	20.0
1,151	09.01.2017	19.0
1,139	12.01.2017	19.0
1,122	31.12.2017	18.0
1,100	22.01.2017	19.0

Ngarkesa maksimale në sistemin elektroenergjetik të Kosovës është regjistruar me 11 janar 2017 në orën 20:00 në vlerë 1,161 MW, që është më e lartë se ngarkesa maksimale në vitin 2016 (1,160 MW).

Kërkesa ndryshon në periudha ditore dhe sezonale, dhe për shkak të këtij ndryshimi vështirësohet balancimi i sistemit. Për të parë këtë ndikim, sidomos për rastin e sistemit elektroenergjetik të Kosovës, është me rëndësi analiza e diagramit ditor të konsumit për çdo orë të ditës për tërë periudhën vjetore.

Në diagramin më poshtë është paraqitur kërkesa dhe prodhimi, nga ku shihet se prodhimi është më e lartë se kërkesa gjatë orëve të natës, ndërsa gjatë periudhës ditore, posaçërisht në orët e mbrëmjes, kërkesa ka rritje të dukshme dhe është më e lartë se prodhimi. Pra, brenda të njëjtës ditë, në orët e ditës (tarifa e lartë) prodhimi nuk e mbulon kërkesën dhe nevojitet të importohet energji elektrike, ndërsa gjatë natës (tarifa e ulët) ka teprica të energjisë të cilat duhet të eksportohen.



Fig. 5.11 Diagrami ditor i nxjerrë si mesatare vjetore për 24 orë për vitin 2017

Balancimi i sistemit elektroenergjetik në vendin tonë është mjaft kompleks dhe i vështirë. Kjo sidomos ndikohet nga dy faktor kryesor siç janë: jofleksibiliteti i njësive gjeneruese dhe ndryshimi i madh i kërkesës për energji elektrike (periudha ditë/natë). Dallimet e kërkesës për energji në të njëjtën ditë në orë të ndryshme paraqet pengesë serioze për përcjelljen e diagramit të kërkesës dhe mbajtjen e devijimit të sistemit në kufijtë e lejuar.

Dallimi në mes të mesatares së maksimumeve dhe minimumeve ditore të konsumit gjatë muajve të vitit 2017 është paraqitur në diagramin e mëposhtëm.



Fig. 5.12 Mesatarja mujore e kërkesës dhe ngarkesat maksimale/minimale ditore 2017

Reduktimet si pasojë e mungesës së energjisë elektrike

Me gjithë përpjekjet për eliminimin e reduktimit të furnizimit për shkak të mungesës së energjisë, ende paraqitet nevoja për reduktime të furnizimit me energji elektrike.

Në tabelën më poshtë janë të paraqitura reduktimet mujore të energjisë elektrike për vitin 2017, ndërsa në figurën më poshtë reduktimet sipas viteve.

Tab. 5.9 Reduktimet e energjisë elektrike

2017	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Reduktimet MWh	6,420	9,770	1,895	2,059	1,780	0	0	0	0	0	0	678	22,602

Reduktimet ndryshojnë nga viti në vit me tendencë të zvogëlimit, dhe në vitin 2017 këto reduktime kanë qenë në nivel prej 22,602 MWh.



Fig. 5.13 Reduktimet e konsumit gjatë viteve 2008 - 2017

5.4.4 Kërkesa për energji elektrike dhe humbjet në rrjetin e transmetimit

Kërkesa e përgjithshme e energjisë elektrike në vitin 2017 ka qenë 5,686 GWh dhe paraqet një rritje prej 6.43% krahasuar me vitin 2016, kur ka qenë 5,342 GWh. Krahasuar me parashikimin në bilancin elektroenergjetik 2017 kërkesa është për 4.06% më e lartë.

Në tabelën 5.10 është paraqitur kërkesa e përgjithshme dhe humbjet në transmetim të realizuara në vitin 2017 dhe të krahasuara me bilancin elektroenergjetik 2017.

Tab. 5.10 Kërkesa e përgjithshme dhe humbjet në rrjetin e transmetimit në vitin 2017

2017	Kërkesa bruto realizim	Kërkesa bruto bilanci	Raporti Realiz./Bilanc	Humbjet në transmetim realizimi		Humbjet në transmetim bilanci	
	MWh	MWh	%	MWh	%	MWh	%
Janar	677,620	554,662	122.17	16,907	2.50	10,952	1.97
Shkurt	513,651	494,757	103.82	11,658	2.27	9,805	1.98
Mars	494,867	491,651	100.65	8,952	1.81	10,515	2.14
Prill	452,389	451,654	100.16	7,339	1.62	9,059	2.01
Maj	408,950	423,294	96.61	7,896	1.93	10,302	2.43
Qershor	370,667	383,540	96.64	6,474	1.75	9,917	2.59
Korrik	396,341	397,675	99.66	8,512	2.15	7,562	1.90
Gusht	407,448	387,286	105.21	9,443	2.32	7,038	1.82
Shtator	380,227	402,987	94.35	8,142	2.14	8,752	2.17
Tetor	461,739	438,407	105.32	9,088	1.97	10,688	2.44
Nëntor	505,502	469,555	107.66	11,107	2.20	8,051	1.71
Dhjetor	616,382	568,048	108.51	12,427	2.02	10,262	1.81
Gjithsej	5,685,783	5,463,515	104.07	117,945	2.07	112,904	2.07

Kërkesa për energji elektrike ka pasur rritje të vazhdueshme deri në vitin 2011, ndërsa nga viti 2011 ka stabilizim të kërkesës, me luhatje nga viti në vit, që mund të shihet në figurën e mëposhtme. Në

vitin 2017 ka rritje të kërkesës së përgjithshme krahasuar me vitin 2016, për të cilën ndikim të konsiderueshëm ka pasur rritja e konsumit të Feronikelit si rezultat i operimit optimal të ndërmarrjes gjatë vitit.



Fig. 5.14 Kërkesa e përgjithshme në sistemin elektroenergjetik 2008-2017

Kërkesa e përgjithshme e energjisë elektrike ndahet në konsumin e konsumatorëve të kyçur në rrjetin e transmetimit, konsumin në sistemin e shpërndarjes (përfshirë humbjet), konsumin vetanak për nevojat e stabilimenteve prodhuese, si dhe humbjet e transmetimit, dhe kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme e ndarë sipas kategorive për vitin 2017.

Tab. 5.11 Kërkesa sipas kategorive dhe humbjet e energjisë

Kërkesa për energji 2017	Total MWh
Konsumi bruto në shpërndarje*	4,996,637
Ferronikeli	384,398
Trepça + Sharrcemi	90,844
Konsumi intern i KEK-ut	95,959
Humbjet në transmetim	117,945
Kërkesa e përgjithshme	**5,685,783**
Shpenzimet vetanake të KEK nga transmetimi	134,909

(*) Energjia elektrike e pranuar në shpërndarje nga transmetimi + prodhimi distributiv

Vlera e energjisë elektrike për shpenzime vetanake në vitin 2017, që merret nga rrjeti i transmetimit është 107 GWh për gjeneratorët e TC Kosova A dhe 28 GWh për TC Kosova B, apo gjithsej 135 GWh.

Kërkesa për energji elektrike ndryshon sipas periudhës së shpenzimit por edhe sipas kategorive të konsumatorëve, dhe kjo është paraqitur në formë grafike në figurën në vijim ku janë përfshirë edhe humbjet në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes (humbjet teknike dhe komerciale).



Fig. 5.15 Pjesëmarrja e kategorive të ndryshme në kërkesën e përgjithshme 2017

Në figurën 5.15 paraqitet ndryshimi i kërkesës sipas muajve, te disa kategori ky ndryshim është mjaft i theksuar, si p.sh. konsumi familjar dhe humbjet komerciale që janë më të larta në sezonin dimëror, gjë që është kryesisht për shkak të shfrytëzimit të energjisë elektrike për ngrohje.

Humbjet në sistemin e transmetimit, viteve të fundit janë në nivel të pranueshëm falë investimeve të bëra nga KOSTT-i, dhe në vete përfshijnë edhe humbjet e shkaktuara nga transiti.



Fig. 5.16 Humbjet në përqindje në rrjetin e transmetimit 2008-2017

Humbjet në rrjetin e transmetimit të Kosovës janë përafërsisht në të njëjtin nivel me humbjet në rrjetet transmetuese në rajon dhe Evropë. Në figurën 5.16 janë paraqitur humbjet në përqindje në rrjetin e transmetimit ndaj kërkesës përgjithshme të sistemit elektroenergjetik të Kosovës. Në figurë përqindja e humbjeve është kalkuluar ndaj kërkesës vendore, ndërsa për nivelin e humbjeve në transmetim ndikon e tërë energjia e futur në sistemin e transmetimit. Pra për kalkulimin e

përqindjes së humbjeve ndaj ngarkimit të rrjetit të transmetimit duhet që të përfshihen përveç kërkesës vendore edhe rrjedhat tjera siç është transiti si dhe energjia për shpenzimet vetanake të gjeneratorëve, etj. Përqindja e humbjeve në transmetim e llogaritur në këtë formë është 1.45%.

Kostoja e humbjeve të energjisë elektrike

Humbjet e energjisë elektrike në sistem janë të përbëra nga humbjet në transmetim, humbjet në shpërndarje (teknike dhe komerciale), dhe energjia e pafaturuar në katër komunat e veriut të vendit. Këto humbje shkaktojnë kosto të madhe për sistemin elektroenergjetik dhe janë të paraqitura në tabelën në vijim për periudhën 2013-2017.

Tab. 5.12 Kërkesa sipas kategorive dhe humbjet e energjisë

Përshkrimi	Njësia	2013	2014	2015	2016	2017
Humbjet teknike	GWh	769	709	722	627	614
Humbjet komerciale	GWh	717	590	519	548	585
Humbjet në veri	GWh	218	227	247	252	265
Humbjet në transmetim	GWh	110	109	110	120	118
Çmimi	€/MWh	30.21	27.30	28.20	34.11	35.43
Humbjet teknike	mil€	23,231	19,353	20,371	21,390	21,739
Humbjet komerciale	mil€	21,659	16,096	14,645	18,709	20,743
Humbjet në veri	mil€	6,590	6,206	6,953	8,595	9,399
Humbjet në transmetim	mil€	3,333	2,971	3,102	4,109	4,179
Vlera	mil€	54,814	44,627	45,071	52,803	56,060

ZRRE nuk pranon në tarifa të paguajnë konsumatorët tejkalimin e humbjeve mbi cakun zvogëlimit të humbjeve të vendosur përmes vlerave hyrëse në kuadër të shqyrtimit shumë-vjeçar tarifor. Diferenca në mes të cakut të lejuar të humbjeve dhe atyre të realizuara nuk përfshihet në tarifa por mbulohet nga vet operatori përkatës.

Vlen të theksohet se, nga sasia prej 265 GWh për energjinë e pafaturuar në katër komunat në veri të vendit e prezantuar në tabelën e mësipërme ZRRE ka pranuar në tarifa vlerën prej 237 GWh, ndërsa pjesa tjetër nuk është trajtuar në tarifa bazuar në vendimin për masën e përkohshme të Gjykatës së Apelit që ka filluar të aplikohet nga 1 dhjetori 2017.

5.5 Sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike

Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga linjat e tensionit 35 kV, 10(20) kV, 6 kV dhe 0.4 kV, si dhe nënstacionet përkatëse të nivelit 35/x kV, 10(20)/0.4 kV dhe 6/0.4 kV.

Të dhënat bazike të nënstacioneve dhe linjave përfshirë kapacitetin, transformimin dhe gjatësinë e linjave të sistemit të shpërndarjes janë paraqitur në tabelat në vijim.

Tab. 5.13 Nënstacionet dhe transformatorët sipas nivelit të tensionit në OSSH

Transformimi (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia e instaluar (MVA)
35/10	KEDS	44	94	660
35/10kV	Privat	8	12	62
35/6kV	Privat	5	8	43
35/0.4kV	Privat	16	22	20
10(20)/0.4	KEDS	2,458	2,550	1,296
10(20)/0.4	Privat	2,017	2,027	946
10/0.4	Privat	1,247	1,253	606
10/0.4	KEDS	2,865	2,865	868
6(3)/0.4	KEDS	65	65	9
Gjithsej		8,725	8,896	4,509

Tab. 5.14 Linjat në OSSH

Tensioni (kV)	Pronari	Rrjeti ajror (km)	Rrjeti kabllor (km)	Gjithsej (km)
35 kV	KEDS	481	20	501
10(20) kV	KEDS	1,416	393	1,809
10 kV	KEDS	4,165	904	5,070
6 kV	KEDS	42	8	50
3 kV	KEDS	4	1	4
0.4 kV	KEDS	16,867	2,345	19,211
Gjithsej		22,975	3,671	26,646

5.5.1 Investimet në sistemin e shpërndarjes

Gjatë vitit 2017 janë bërë investime të konsiderueshme në rrjetin e shpërndarjes në nivelet e tensionit të mesëm dhe të ulët. KEDS si operator i shpërndarjes ka investuar rreth 23.4 milion euro në rrjetin e shpërndarjes, të cilat janë përmbledhur në projektet kryesore si në vijim:

- Ndërtimi Qendrës Dispeçerike të OSSh-së;
- Përforcimi i rrjetit, ndërrimi i linjave 10kV dhe 0.4kV, shtyllat dhe transformatorët 10/0.4kV të përzgjedhur në 7 distriktet e Kosovës;
- Furnizimi me kthina me tension të mesëm 35kV dhe 10 (20) kV në NS 110kV dhe 35kV;
- Eliminimi i fyteve të ngushta në linjat e shpërndarjes - Linjat e mbingarkuara 35kV dhe 10kV;
- Transformatorët e Shpërndarjes 10 (20) /0.4kV;
- Përmirësimi i pikave matës për konsumatorët shtëpiak dhe llogaritja e energjisë;
- Investimet në makineri të rënda për operim, sistemi i ndjekjes së automjeteve, blerje të licencave, blerje të pajisjeve të shëndetit dhe sigurisë dhe pajisjeve të punës etj;
- Investimet në mirëmbajtjen e rrjetit etj;

OSSH ka bërë investime të konsiderueshme në rrjet bazuar në planin 5 vjeçar të investimeve të aprovuar nga ZRRE.

Objektivat kryesore të investimeve janë si në vijim:

- Sigurimi i qëndrueshëm me furnizim të energjisë elektrike kualitative duke përkrahur edhe rritjen e ngarkesës
- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale
- Rehabilitimi dhe modernizimi i rrjetit elektrik

Në vitin 2017 investimet janë zhvilluar kryesisht në linjat e tensionit të mesëm, përfshirë edhe kalimin nga niveli 10kV në nivelin 20kV të përmbledhura si:

- **Investimet në ngritjen e kapaciteteve në trafostacionet e tensionit të mesëm (TM)**

  Investimet e lartpërmendura kanë përforcuar furnizimin e daljeve, rritur kapacitetet, eliminuar avaritë për shkak të vjetërsisë, etj.

- **Investimet e filluara në vitin 2016 dhe janë energjizuar gjatë vitit 2017**
  - Ndërtimi i largpërçuesit 10kV Letanci dhe Llausha në Podujevë - ka mbetur vetëm demolomi i disa shtyllave dhe pranimi teknik
  - Ndërtimi i LP Drenica-Komoran është përfunduar, ka mbetur të zgjidhen disa probleme lidhur me shtyllat e tensionit të mesëm. Ndërtimi i largpërçuesit të ri përfshinë 1/3 e daljes Drenica, e cila furnizohet nga TS Magura, dhe furnizohet nga stabilimenti shpërndarës në Komoran.
  - Ndërtimi i LP të ri në daljen Bablak, me 63 trafostacione të TM/TU
  - Ndërtimi i largpërçuesit 10kV Gllobar dhe Shtrubullovë, është në përfundim, i cili eliminon një pjesë të rrjetit të vjetër.
  - Ndërtimi i largpërçueseve kabllorë Klina 1, Klina 2, që furnizojnë stabilimentin shpërndarës në Klinë që eliminon rrjetin ajror të tensionit të mesëm i cili kalon nëpër komunën e Klinës.

- **Investimet në LP e tensionit të mesëm 10kV**
  - Projekti Bellobradi-Bresana – investim i linjës së re, dhe rehabilitim i rrjetit.
  - Linjë e dyfishtë ajrore në daljen Gjinovci si dhe rehabilitim i prishjeve
  - Projekti I rehabilitimit të degëzimit të Lubinjës në Zhupë.
  - Projekti I ndërtimit të linjës me kabëll nëntokësor dhe ajror në daljen Lumi Madh.
  - Projekti I daljes Orllani pranë liqenit të Batllavës.
  - Projekti i linjave të Kllokotit, Tërpezës dhe Stacionarit për zvogëlim të humbjeve teknike dhe rënieve, si dhe përmirësim të tensionit.
  - Projekti Shala me linjë të dyfishtë është në process e sipër.

- **Investimet në LP e tensionit të mesëm 20kV**
  - Në vitin 2017, OSSh ka filluar me dy pilot projekte për konvertim të daljeve 10kV në 20kV. Daljet e përzgjedhura kanë qenë dalja Drenica në distriktin e Ferizajit dhe dalja Breznica në distriktin e Prishtinës.

- **Investimet në Përforcimin e rrjetit –Projektet e mëhershme**

Duhet theksuar se në vitin 2017 janë bartur disa projekte të përforcimit të rrjetit të viteve të kaluara, të cilat kanë filluar punën në vitet përkatëse por energjizimi i tyre është bërë këtë vit:

- Projektet që kanë filluar në vitin 2015 dhe kanë përfunduar në vitin 2017 janë 58
- Projektet që kanë filluar në vitin 2016 dhe kanë përfunduar në vitin 2017 janë 33.

➢ **Investimet në Përforcimin e rrjetit**

Investimet në përmirësimin e rrjetit janë: Vendosja e TS të rinjë, ndërrimi i TS-it ekzistues me TS të ri, zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit 10(20)kV, rehabilitimi i rrjetit të tensionit të ultë, vendosja e MMO-ve dhe kyçja e konsumatorëve shtëpiak në njehsorët e vendosur jashtë shtëpive

➢ **Investimet në Mirëmbajtje të Rrjetit;**

- Janë investuar 31.73km përçues ajror dhe 7.36 km përçues nëntokësor të ri
- Janë investuar 49 TR të rinj që i kanë shtuar vlerë aseteve prej 13.2MVA
- Janë investuar 1km kabllo të rrjetit 35kVnë rrjetin e tensionit 10(20)kV, si dhe është ndërruar rrjeti ekzistues ajror prej 19km dhe ai kabllovik prej 20km
- Në rrjetin e tensionit të ultë është investuar në 163.83km rrjet ekzistues ajror dhe 4.24km rrjeti ekzistues kabllovik

➢ **Investimi në transformatorët e mbingarkuar të nivelit TM/TU**

Në vitin 2017 janë ndërruar 138 TR të TM/TU të atyre me fuqi të ulët të instaluar, të cilat janë zëvendësuar me TR me fuqi më të lartë.

➢ **Investimet në pikën matëse**

Gjatë vitit 2017 janë investuar në rreth 60,000 njehsorë, prej të cilëve :

- 5,274 njehsorë me matje direkte me komunikim GSM GPRS,
- 3,852 njehsorë me matje direkte me PLC
- 522 njehsorë me matje gjysëm indirekte dhe indirekte
- 20,797 njehsorë mekanik që janë ndërruar me digjital dhe
- 26,900 njehsorë të dedikuar për lidhje të reja

➢ **Investimet në SCADA**

- OSSH ka filluar zbatimin e sistemit SCADA, i cili do të jetë në tri faza. Faza e parë e projektit ka filluar gjatë vitit të kaluar dhe pritet të përfundojë gjatë vitit 2018.

Me investimet e reja është rritur cilësia e tensionit të konsumatorëve, përformanca e rrjetit duke shkarkuar mbingarkesat e linjave, janë zvogëluar humbjet, është rritur siguria e furnizimit të konsumatorëve me energji. Në vendbanime (qytete dhe qyteza) tentohet të eliminohet rrjeti ajror duke u zëvendësuar me rrjetin kabllovik. Poashtu bazuar në investimet e bëra në disa pjesë të sistemit janë ndërtuar stabilimente shpërndarëse të cilat mundësojnë zvogëlimin e numrit të linjave radiale.

Investimet kapitale në tensionin e ulët kanë përforcuar rrjetin e tensionit të ultë, me ç'rast është rritur edhe siguria e konsumatorit, janë zvogëluar humbjet teknike dhe komerciale dhe është lehtësuar qasja për leximin e njehsorit.

Në tabelën e mëposhtme janë prezantuar investimet kapitale të lejuara dhe të realizuara të KEDS për periudhën e parë të shqyrtimit periodik shumë-vjeçar tarifor 2013 -2017.

Tab. 5.15 Investimet në OSSH në 5 vitet e fundit

INVESTIMET NË KEDS PËR PERIUDHËN SHUMËVJEÇARE		
Operatori I Sistemit të Shpërndarjes		
Viti	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)
2013	21.65	16.57
2014	21.23	17.64
2015	21.39	20.64
2016	21.56	23.65
2017	21.42	23.39
Gjithsej	107.25	101.89

5.5.2 Konsumi dhe humbjet në shpërndarje

OSSH është e organizuar në shtatë distrikte: Prishtina, Mitrovica, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaji dhe Gjilani të paraqitura në figurën në vijim. Të dhënat për konsumin, humbjet teknike dhe komerciale si dhe të dhëna tjera janë të llogaritura sipas muajve të vitit dhe sipas distrikteve.

Fig. 5.17 Shtrirja e sistemit të shpërndarjes së Kosovës në distrikte

Kërkesa e energjisë elektrike në shpërndarje në vitin 2017 është realizuar në vlerën 4,997 GWh, ndërsa në vitin 2016 ka qenë 4,807 GWh, që paraqet një rritje përafërsisht 3.95%.

Konsumi më i lartë është realizuar në distriktin e Prishtinës me 31.6% ndaj konsumit të përgjithshëm në shpërndarje, ndërsa konsumi më i ulët është në distriktin e Gjilanit me 8.3% të konsumit të përgjithshëm.

Konsumi në sistemin e shpërndarjes ka rritje të vazhdueshme, sikurse edhe kërkesa e përgjithshme, dhe kjo rritje është paraqitur në figurën 5.18, ku janë paraqitur të dhënat nga viti 2008 deri 2017.

Edhe përkundër investimeve të realizuara deri më tani në rrjetin e shpërndarjes, humbjet e energjisë elektrike ende mbeten të larta dhe paraqesin problem shqetësues për sektorin e energjisë elektrike. Humbjet po ashtu kanë ndikim negativ edhe në furnizimin e konsumatorëve dhe qëndrueshmërinë financiare të operatorëve të furnizimit dhe shpërndarjes, si dhe tërë sektorin e energjisë.



Fig. 5.18 Kërkesa për energji elektrike në sistemin e shpërndarjes 2008-2017

Në tabelën 5.16 janë paraqitur kërkesa (ngarkesa), energjia e faturuar si dhe humbjet teknike dhe komerciale në shpërndarje.

Tab. 5.16 Konsumi dhe humbjet në shpërndarje në vitin 2017

Muajt	Ngarkesa	Energjia e faturuar	Humbjet teknike		Humbjet komerciale		Humbjet gjithsej	
	MWh	MWh	MWh	%	MWh	%	MWh	%
Janar	609,683	365,942	82,497	13.53	161,244	26.45	243,741	39.98
Shkurt	460,175	301,617	58,512	12.72	100,045	21.74	158,557	34.46
Mars	434,080	294,440	53,687	12.37	85,953	19.80	139,640	32.17
Prill	393,256	274,433	47,532	12.09	71,291	18.13	118,823	30.22
Maj	351,467	268,131	38,793	11.04	44,543	12.67	83,336	23.71
Qershor	318,235	253,303	33,457	10.51	31,474	9.89	64,932	20.40
Korrik	338,162	273,958	36,201	10.71	28,003	8.28	64,204	18.99
Gusht	348,849	283,692	38,958	11.17	26,199	7.51	65,157	18.68
Shtator	322,605	256,515	35,479	11.00	30,611	9.49	66,090	20.49
Tetor	400,784	280,788	45,629	11.38	74,367	18.56	119,996	29.94
Nëntor	465,518	318,398	58,622	12.59	88,498	19.01	147,120	31.60
Dhjetor	553,824	361,099	84,202	15.20	108,522	19.60	192,725	34.80
Gjithsej realizuar	4,996,637	3,532,316	613,570	12.28	850,751	17.03	1,464,321	29.31
Gjithsej sipas bilancit	4,564,440	3,243,702	503,131	11.02	514,229	11.27	1,320,738	22.29

Humbjet teknike sipas të dhënave të dërguara nga OSSH arrijnë vlerën 12.28 %, ku ndikim në nivelin e lartë të këtyre humbjeve kanë vjetërsia e rrjetit, gjatësia e linjave, kualiteti dhe lloji i përçuesve dhe transformatorëve, ngarkimi i pajisjeve, si dhe mirëmbajtja e tyre. Për zvogëlimin e humbjeve teknike nevojiten investime mjaft të mëdha.

Humbjet komerciale janë të larta, dhe përbëjnë 11.72% të gjithsej kërkesës në shpërndarje, por kësaj duhet shtuar edhe energjia e pa faturuar në pjesën veriore të Kosovës që përbën 5.31% (265 GWh) të kërkesës së përgjithshme në shpërndarje me gjithsej humbje joteknike 17.03%.

Rrjedhat e energjisë në shpërndarje sipas distrikteve përfshirë edhe humbjet e energjisë elektrike janë paraqitur në tabelën 5.17.

Tab. 5.17 Konsumi dhe humbjet në shpërndarje sipas distrikteve për vitin 2017

Distriktet	Ngarkesa në distrikte	Energjia e faturuar	Humbjet teknike		Humbjet komerciale		Humbjet gjithsej	
	MWh	MWh	MWh	%	MWh	%	MWh	%
Prishtina	1,580,153	1,180,312	188,138	11.91	211,702	13.40	399,841	25.30
Mitrovica	730,697	293,925	67,818	9.28	368,954	50.49	436,772	59.77
Peja	546,030	385,251	73,325	13.43	87,455	16.02	160,780	29.45
Gjakova	450,835	327,951	71,485	15.86	51,399	11.40	122,884	27.26
Prizreni	645,749	489,705	82,312	12.75	73,731	11.42	156,044	24.16
Ferizaji	628,441	498,934	84,111	13.38	45,395	7.22	129,506	20.61
Gjilani	414,732	356,238	46,380	11.18	12,114	2.92	58,495	14.10
Gjithsej	4,996,637	3,532,316	613,570	12.28	850,751	17.03	1,464,321	29.31

Zvogëlimi i humbjeve komerciale ka ndikim pozitiv edhe në uljen e konsumit, e me këtë edhe në ngarkimin e rrjetit dhe humbjet teknike.

Në fillim të vitit 2012 ZRRE ka përcaktuar caqet e lejuara të humbjeve në shpërndarje duke u bazuar në nivelin e humbjeve të vitit 2011 si pikë fillestare por dhe të trendit të zvogëlimit të humbjeve në vitet paraprake, duke përcaktuar shkallën e zvogëlimit të humbjeve prej 3 pikë përqindje për tri vitet e para dhe 2.5 pikë përqindje për tri vitet tjera. Humbjet të cilat ZRRE ia pranon operatorit të shpërndarjes në tarifa bazohen në këto caqe.

Kostoja e humbjeve të energjisë mbulohet nga tarifa e konsumatorëve që janë pagues të rregullt të energjisë elektrike që paraqet një ngarkim shtesë për këta konsumatorë, por që për funksionimin e rregullt të sistemit është e pashmangshme. Operatori i sistemit të shpërndarjes bënë përpjekje të vazhdueshme për zvogëlimin e humbjeve në shpërndarje, posaçërisht atyre komerciale, duke pasur parasysh se realizimi i zvogëlimit të tyre kërkon më pak investime. Pavarësisht zvogëlimit të humbjeve ndër vite, OSSH nuk ka arritur të përmbush caqet e përcaktuara nga ZRRE, që do të thotë se kostoja e mosrealizimit të këtyre caqeve bartet nga vet OSSH.

Më poshtë është paraqitur grafiku me të dhënat për humbjet teknike, komerciale dhe humbjeve gjithsej nga viti 2008 deri 2017.



Fig. 5.19 Humbjet teknike dhe komerciale në shpërndarje për periudhën 2008-2017

5.6 Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike gjatë vitit 2017 është realizuar nga furnizuesi me obligim të shërbimit universal, i cili ka furnizuar konsumatorët me çmime të rregulluara dhe konsumatorët me çmime të parregulluara për të cilët është mbajtur llogari e veçantë.

Pjesëmarrja e konsumatorëve familjarë në konsumin e përgjithshëm të faturuar në shpërndarje edhe më tutje mbetet dominues - rreth 57.17%. Në figurën më poshtë është paraqitur pjesëmarrja në përqindje e kategorive të konsumit krahasuar me konsumin e përgjithshëm (e paraqitur me humbje dhe pa humbje në shpërndarje).





Fig. 5.20 Pjesëmarrja e kategorive të konsumit - me dhe pa humbje 2017

5.6.1 Faturimi dhe arkëtimi

Ndër vite energjia e faturuar ka pasur rritje të vazhdueshme, e posaçërisht rritje më të theksuar ka pasur në arkëtim. Niveli i arkëtimit ndaj faturimit në shpërndarje për vitin 2017 ka qenë 99.01%, ndërsa kur llogariten edhe konsumatorët e kyçur në rrjetin e transmetimit te të cilët arkëtimi është 100%, atëherë arkëtimi i përgjithshëm arrin në 99.09%.

Konsumi i kategorizuar sipas nivelit të tensionit dhe grupeve të konsumatorëve që shfrytëzojnë energjinë elektrike për vitin 2017 është dhënë në tabelën 5.18.

Tab. 5.18 Energjia elektrike e faturuar sipas kategorive tarifore 2017

Kategoritë e konsumit (MWh)	Gjithsej 2017	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
220 kV	384,398	34,847	29,882	35,308	34,562	32,648	32,034	34,948	32,893	32,832	34,733	14,446	35,266
110 kV	90,844	5,389	4,291	8,292	9,249	9,178	7,268	8,821	8,867	8,676	8,520	6,145	6,147
35 kV	43,587	2,553	2,541	4,010	3,487	3,572	3,537	4,171	4,121	3,607	3,844	4,101	4,045
10 kV	312,102	27,286	23,049	25,875	24,482	24,168	23,670	26,068	27,084	24,412	26,589	28,768	30,652
Familjar	2,290,962	249,590	203,066	191,419	180,730	174,303	161,135	168,891	171,436	164,765	180,445	206,379	238,803
0.4 kV I	348,392	32,317	26,820	29,283	26,494	26,731	26,779	29,871	32,352	25,469	27,835	31,173	33,268
0.4 kV II	516,022	52,118	44,319	41,816	37,699	37,959	36,897	43,606	47,159	36,641	40,065	45,850	51,893
Ndriqimi publik	21,251	2,079	1,823	2,037	1,540	1,399	1,286	1,352	1,540	1,620	2,011	2,127	2,438
Gjithsej faturuar	4,007,557	406,177	335,790	338,039	318,245	309,957	292,605	317,727	325,452	298,023	324,040	338,990	402,512
Konsumi KEK	95,959	10,795	7,646	8,235	7,983	7,760	6,656	5,898	7,396	7,972	8,614	8,286	8,719
Humbjet KEDS	1,464,321	243,741	158,557	139,640	118,823	83,336	64,932	64,204	65,157	66,090	119,996	147,120	192,725
Humbjet KOSTT	117,945	16,907	11,658	8,952	7,339	7,896	6,474	8,512	9,443	8,142	9,088	11,107	12,427
Gjithsej	**5,685,783**	**677,620**	**513,651**	**494,867**	**452,389**	**408,950**	**370,667**	**396,341**	**407,448**	**380,227**	**461,739**	**505,502**	**616,382**

Energjia elektrike e faturuar në vitin 2017 është 4,008 GWh, e që shprehur në vlerë monetare (përfshirë edhe TVSH) është 296.1 mil€, ndërsa arkëtimi është 293.4 mil€. Tabela e mëposhtme paraqet faturimin, arkëtimin, si dhe raportin mes tyre të paraqitur në përqindje e që është mbi 99%.

Tab. 5.19 Faturimi dhe arkëtimi në vitin 2017

2017	Ngarkesa	Realizimi	Faturimi	Arkëtimi	Ark/Fat
	MWh	MWh	€	€	%
Shpërndarja	4,996,637	3,532,316	270,224,014	267,539,783	99.01%
Ferronikeli	384,398	384,398	4,863,406	4,863,406	100.00%
Trepça+Sharrcemi	90,844	90,844	21,014,345	21,014,345	100.00%
Gjithsej	5,471,879	4,007,557	296,101,765	293,417,534	99.09%

Tabela 5.20 paraqitet faturimin, arkëtimin si dhe raportin mes tyre në shpërndarje sipas muajve për vitin 2017, ku shihet se në disa muaj ky raport është më i lartë se vlera 100%, që nënkupton se në këta muaj është arkëtuar energjia elektrike e faturuar për muajt paraprak si dhe borxhi i vjetër.

Tab. 5.20 Faturimi dhe arkëtimi sipas muajve në shpërndarje për vitin 2017

Shpërndarja 2017	Ngarkesa	Realizimi	Faturimi	Arkëtimi	Ark/Fat
	MWh	MWh	€	€	%
Janar	609,683	365,942	30,938,760	25,468,357	82.32%
Shkurt	460,175	301,617	25,444,818	26,703,349	104.95%
Mars	434,080	294,440	25,066,058	24,940,018	99.50%
Prill	393,256	274,433	20,170,830	22,536,438	111.73%
Maj	351,467	268,131	19,992,524	20,589,122	102.98%
Qershor	318,235	253,303	18,983,179	18,811,508	99.10%
Korrik	338,162	273,958	20,717,573	24,073,131	116.20%
Gusht	348,849	283,692	21,578,202	22,063,534	102.25%
Shtator	322,605	256,515	19,086,575	19,451,313	101.91%
Tetor	400,784	280,788	21,009,275	19,298,530	91.86%
Nëntor	465,518	318,398	22,687,672	19,916,955	87.79%
Dhjetor	553,824	361,099	24,548,548	23,687,528	96.49%
Gjithsej	4,996,637	3,532,316	270,224,014	267,539,783	99.01%

Energjia elektrike e faturuar dhe arkëtuar në shpërndarje nga viti 2008 deri në 2017 është paraqitur në figurën e mëposhtme ku shihet një rritje e vazhdueshme nga viti në vit.



Fig. 5.21. Faturimi dhe arkëtimi në shpërndarje gjatë viteve 2008-2017

Çmimi mesatar i energjisë elektrike

Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike është i ndryshëm varësisht nga kategoria e konsumatorëve, niveli i tensionit në të cilin janë të kyçur konsumatorët dhe shfrytëzimi i energjisë elektrike në tarifa të ndryshme sipas kohës në të cilën është shfrytëzuar energjia. Çmimi mesatar ndryshon për konsumatorët familjar dhe jo-familjar, dhe në figurën 5.22 mund të shihet çmimi mesatar i shitjes sipas këtyre kategorive (pa TVSH). Çmimi mesatar i shitjes ndryshon edhe sipas distrikteve varësisht nga koncentrimi i aktiviteteve komerciale/industriale që shfrytëzojnë energji elektrike në periudha të caktuara. Për kategorinë e konsumatorëve familjar çmimi mesatar i energjisë është 6.04 €cent/kWh, ndërsa për konsumatorët jo-familjar çmimi mesatar i energjisë është 7.94 €cent/kWh.



Fig. 5.22 Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike 2017 (pa TVSH)

Në figurën e mëposhtme është paraqitur çmimi mesatare pa TVSH për konsumatorët familjar për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 për disa shtete, të nxjerra nga Eurostat, meqë mungojnë ende të dhënat për gjashtëmujorin e dytë. Të dhënat e Eurostat-it janë të kategorizuara sipas konsumit, dhe në figurë është paraqitur vlera e konsumit prej 2500-5000 kWh, që më së afërmi i korrespondon konsumit mesatar të një familjeje kosovare.



**Burimi i të dhënave nga EUROSTAT*

Fig. 5.23 Çmimet mesatare për konsumatorët familjar për 6 mujorin e parë 2017 (pa TVSH)

5.7 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike

Duke pasur parasysh konfigurimin e njësive gjeneruese, për përcjelljen e konsumit dhe balancimin e sistemit elektroenergjetik, përveç prodhimit vendor nevojitet edhe import i energjisë elektrike, ndërsa në disa raste paraqiten teprica që duhet të eksportohen.

5.7.1 Importi i energjisë elektrike

Për të plotësuar nevojat vendore për energji elektrike, KESCO dhe KOSTT kanë importuar sasi të konsiderueshme të energjisë elektrike nga tregu rajonal përmes kontratave komerciale të lidhura me tregtarë, por një sasi e energjisë është marrë në formë shkëmbimi me Korporatën Energjetike të Shqipërisë (KESH).

Nga muaji prill 2017, KESCO sipas kërkesave rregullative ka filluar ti ndaj sasitë e importeve për mbulimin e nevojës së konsumatorëve me të drejtën e shërbimit universal nga sasitë e importeve për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, ndërsa për konsumatorët e parregulluar (Feronikeli) që nga tetori 2016.

Bazuar në obligimet nga legjislacioni, KOSTT duhet të siguroj vetë energjinë për mbulimin e humbjeve në transmetim përmes kontratave nga prodhimi vendor dhe importi. Deri në fund të muajit gusht të vitit 2017, KESCO ka bërë importin edhe për mbulimin e humbjeve në transmetim,

ndërsa nga shtatori KOSTT ka filluar të realizoj vet importet për mbulimin e humbjeve në transmetim.

Për mbulimin e kërkesave të sistemit elektroenergjetik KOSTT dhe KESCO kanë importuar energji në sasi prej 1,242,255 MWh. Kjo sasi përfshinë energjinë elektrike të importuar për konsumatorët e rregulluar dhe të parregulluar, humbjet në rrjetin e transmetimit, humbjet në rrjetin e shpërndarjes dhe humbjet e shkaktuara nga energjia e pafaturuar në katër komunat e veriut të vendit.

Energjia elektrike e importuar nga KOSTT për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe për energjinë e pafaturuar në katër komunat në veri të vendit duke filluar nga shtatori i vitit 2017 ka qenë 39,692 MWh në vlerë prej 2,687,381 € dhe me çmim mesatar 67.71 €/MWh. Përveç kësaj KOSTT ka blerë sasinë e energjisë prej 9,442 MWh me çmim mesatar 64.12 €/MWh nga KESCO në kushtet e njëjta sikur me tregtarët tjerë, por kjo sasi është e deklaruar si import nga KESCO dhe si e tillë në këtë rast konsiderohet si import i KESCO-së.

Tab. 5.21 Importi i energjisë elektrike nga KOSTT

Importi nga KOSTT nga shtatori 2017			
Muaji	Sasia (MWh)	Çmimi (€/MWh)	Vlera (€)
Shtator	725	61.64	44,690
Tetor	6,098	60.42	368,458
Nëntor	23,734	77.68	1,843,745
Dhjetor	9,135	47.13	430,488
Gjithsej	39,692	67.71	2,687,381

Energjia elektrike e importuar me kontrata komerciale nga KESCO gjatë vitit 2017 ka qenë 1,112,734 MWh në vlerë prej 65,968,953 €, me çmim mesatar prej 58.76€/MWh, ndërsa energjia elektrike e importuar në vitin 2016 ka qenë 556,884 MWh me çmim mesatar prej 45.80 €/MWh.

Të dhënat për gjithsej importet nga KESCO dhe shkëmbimet janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tab. 5.22 Importi i energjisë elektrike nga KESCO me kontrata dhe si shkëmbim 2017

Importi i realizuar nga KESCO-2017				Shkëmbim	Gjithsej
Muaji	Sasia MWh	Çmimi €/MWh	Vlera (€)	Sasia MWh	Sasia MWh
Janar	153,918	79.51	12,237,488	-	153,918
Shkurt	92,720	70.73	6,558,058	-	92,720
Mars	43,206	39.02	1,685,894	-	43,206
Prill	97,289	42.84	4,167,981	-	97,289
Maj	51,579	40.66	2,097,270	-	51,579
Qershor	38,724	39.73	1,538,343	-	38,724
Korrik	59,256	55.62	3,296,013	-	59,256
Gusht	72,808	62.99	4,586,505	-	72,808
Shtator	42,909	56.00	2,402,737	-	42,909
Tetor	54,970	52.16	2,867,315	-	54,970
Nëntor	181,062	67.99	12,309,728	6,225	187,287
Dhjetor	234,293	52.16	12,221,621	73,574	307,867
Gjithsej	1,122,734	58.76	65,968,953	79,799	1,202,533

Bazuar në legjislacionin në fuqi dhe dokumentin "Udhëzuesi për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike", nga muaji prill 2017 operatorët e sistemeve obligohen që energjinë për mbulimin e humbjeve dhe shërbimeve tjera ndihmëse t'i blejnë në tregun konkurrues, prandaj KESCO ka filluar që të ndajë importin për konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal dhe importin për mbulimin e humbjeve në OSSH. Nga gjithsej 1,122,734 MWh sa ka importuar KESCO, 416,677 MWh kanë qenë import për konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal, 315,260 MWh për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, 381,355 MWh për konsumatorët me çmime të parregulluara dhe 9,442 MWh për tregtim me KOSTT.

Tab. 5.23 Importi i KESCO për konsumatorët e shërbimit universal, mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, dhe tregtim me KOSTT

Importi nga KESCO për konsumatorët e shërbimit universal				Importi nga KESCO për mbulimin e humbjeve në shpërndarje			Importi nga KESCO për tregëtim me KOSTT		
Muaji	Sasia MWh	Çmimi €/MWh	Vlera €	Sasia MWh	Çmimi €/MWh	Vlera €	Sasia MWh	Çmimi €/MWh	Vlera €
Janar	117,174	92.15	10,798,088	-	-	-	-	-	-
Shkurt	92,720	70.73	6,558,058	-	-	-	-	-	-
Mars	5,313	48.54	257,914	-	-	-	-	-	-
Prill	33,335	46.10	1,536,551	27,234	46.10	1,255,487	-	-	-
Maj	11,979	47.34	567,096	3,256	47.34	154,142	-	-	-
Qershor	1,381	69.42	95,846	1,343	69.42	93,249	-	-	-
Korrik	3,011	63.61	191,521	19,789	63.61	1,258,724	-	-	-
Gusht	9,266	68.04	630,450	27,734	68.04	1,886,994	-	-	-
Shtator	2,398	56.88	136,406	4,511	56.88	256,601	-	-	-
Tetor	1,096	67.72	74,213	16,564	67.72	1,121,779	60	76.12	4,567
Nëntor	63,631	68.50	4,358,977	95,736	68.50	6,558,297	6,011	66.01	396,809
Dhjetor	75,373	49.93	3,763,688	119,093	49.93	5,946,809	3,371	60.53	204,047
Gjithsej	416,677	69.52	28,968,808	315,260	58.78	18,532,083	9,442	64.12	605,422

Përveç importit të energjisë elektrike me kontrata, po ashtu është importuar një sasi e energjisë elektrike edhe në formë shkëmbimi (energji me energji) gjithsej 79,799 MWh. I tërë shkëmbimi në vitin 2017 është realizuar në mes të KEK dhe Korporatës Energjetike të Shqipërisë (KESH), e që krahasuar me vitin 2016 (75,405 MWh) kjo sasi është 6% më e lartë.

Për Feronikelin gjatë vitit 2017 si konsumator me çmime të parregulluara është importuar energji në sasi prej 381,355 MWh me vlerë totale 17,862,639 € me çmim mesatar prej 46.84 €/MWh, përveç në muajin shkurt ku për shkak të disa kufizimeve në sistemin e transmetimit në Bullgari është furnizuar me çmime të rregulluara.

Tab. 5.24 Importi i energjisë elektrike për 2017 për konsumatorë me çmime të parregulluara

Importi i energjisë elektrike per konsumator te parregulluar (Feronikeli) 2017			
Muaji	Sasia (MWh)	Çmimi (€/MWh)	Vlera (€)
Janar	36,744	39.17	1,439,400
Shkurt	-	-	-
Mars	37,893	37.68	1,427,979
Prill	36,720	37.47	1,375,942
Maj	36,344	37.86	1,376,033
Qershor	36,000	37.48	1,349,248
Korrik	36,456	50.63	1,845,767
Gusht	35,808	57.78	2,069,061
Shtator	36,000	55.83	2,009,730
Tetor	37,250	44.75	1,666,756
Nëntor	15,684	63.48	995,646
Dhjetor	36,456	63.28	2,307,078
Gjithsej	381,355	46.84	17,862,639

Sasia totale e importeve me kontrata në vitin 2017 ka qenë 1,162,426 MWh me çmim mesatar prej 59.06 €/MWh, dhe krahasuar me vitin 2016 kjo sasi është për 109% më e lartë (556,884 MWh), e poashtu edhe çmimi mesatar i importit ka qenë për 29% më i lartë se në vitin paraprak.

Tab. 5.25 Importi i energjisë elektrike për 2017 sipas kategorive

Importi i realizuar në vitin 2017			
Importi për kategoritë	Sasia MWh	Çmimi €/MWh	Vlera (€)
Konsumator me shërbim universal	416,677	69.52	28,968,808
Humbje në rrjetin e shpërndarjes	315,260	58.78	18,532,083
Konsumator me çmime të parregulluara	381,355	46.84	17,862,639
KESCO për KOSTT	9,442	64.12	605,422
Gjithsej KESCO	**1,122,734**	**58.76**	**65,968,953**
KOSTT	39,692	67.71	2,687,381
Gjithsej import me kontrata	**1,162,426**	**59.06**	**68,656,334**
Shkëmbim KEK nga KESH	79,799	-	-
Gjithsej import	**1,242,225**	**-**	**68,656,334**

Figura në vijim paraqet importin me kontrata dhe çmimin, si dhe shkëmbimin me KESH të realizuar gjatë vitit 2017 për konsumatorët e rregulluar.



Fig. 5.24 Importi i energjisë elektrike me kontrata dhe si shkëmbim për vitin 2017

5.7.2 Eksporti i energjisë elektrike

Duke pasur parasysh lakoren e konsumit gjatë orëve brenda ditës, dhe jo-fleksibilitetin e njësive gjeneruese për të përcjellë konsumin, shihet se në raste të ndryshme paraqiten mungesa dhe teprica të energjisë, madje kjo ndodhë edhe në të njëjtën ditë. Pra në disa orë të së njëjtës ditë ka importe të energjisë, ndërsa në orë të tjera paraqiten teprica të energjisë të cilat duhet të eksportohen.

Tepricat e energjisë elektrike janë kryesisht në orët e natës (në kohën e tarifës së ulët). Në këto periudha edhe në sistemet rajonale paraqiten teprica, rrjedhimisht rriten ofertat për energji gjatë natës, dhe kjo ndikon që çmimet e eksportit të jenë dukshëm më të ulëta se sa çmimet e importit.

Energjia elektrike e eksportuar me kontrata komerciale gjatë vitit 2017 ka qenë 876,229 MWh me vlerë prej 32,757,947 €, me çmim mesatar prej 37.39 €/MWh, ndërsa energjia elektrike e eksportuar në vitin 2016 ka qenë 1,064,184 MWh, me çmim mesatar 29.73 €/MWh. Sasia e energjisë elektrike e eksportuar është për 18% më e ulët se në vitin 2016, përderisa çmimi mesatar ka qenë për 26% më i lartë krahasuar me vitin 2016.

Tab. 5.26 Eksporti i energjisë elektrike me kontrata dhe si shkëmbim 2016

Eksporti i energjisë elektrike me kontrata-2017				Shkëmbim	Gjithsej
Muaji	Sasia MWh	Çmimi €/MWh	Vlera (€)	Sasia MWh	Sasia MWh
Janar	12,030	51.66	621,528	1,900	13,930
Shkurt	14,730	34.80	512,531	133	14,863
Mars	114,692	33.10	3,796,327	936	115,628
Prill	77,095	34.67	2,672,578	72	77,167
Maj	188,476	38.51	7,258,324	0	188,476
Qershor	194,160	39.89	7,744,555	0	194,160
Korrik	68,215	37.18	2,536,131	479	68,694
Gusht	35,596	36.35	1,293,918	161	35,757
Shtator	90,634	35.92	3,255,252	0	90,634
Tetor	80,601	38.05	3,066,803	0	80,601
Nëntor	0		0	0	0
Dhjetor	0		0	0	0
Gjithsej	876,229	37.39	32,757,947	3,681	879,910

Eksporti me kontrata është realizuar me tregtarë të ndryshëm, ndërsa eksporti si shkëmbim, në vitin 2017, është realizuar vetëm nga KEK-u me KESH-in.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur eksporti me kontrata dhe në formë shkëmbimesh.



Fig. 5.25 Eksporti i energjisë elektrike me kontrata dhe si shkëmbim për vitin 2017

Duke pasur parasysh sasinë e energjisë elektrike të importuar dhe të eksportuar gjatë vitit 2017 shihet se Kosova ka qenë neto importuese e energjisë elektrike dhe atë në sasi prej 362,315 MWh, të paraqitura sipas muajve në figurën e mëposhtme.



Fig. 5.26 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike në vitin 2017

Çmimi i importit dhe eksportit të energjisë elektrike gjatë viteve 2000 - 2017 ka shënuar ngritje dhe rënie. Më poshtë është dhënë figura ku janë paraqitur çmimet e importit dhe eksportit nga viti 2000 deri 2017.



Fig. 5.27 Çmimi mesatar i importit dhe eksportit gjatë viteve

5.8 Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike

Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike janë element i rëndësishëm i rregullimit të sektorit të energjisë. Këto standarde përcaktohen në mënyrë që cilësia e furnizimit dhe e shërbimit me energji elektrike te konsumatorët të përmirësohet vazhdimisht prej ndërmarrjes së energjisë.

Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike definohen dhe monitorohen sipas fushave në vijim:

- Kontinuiteti i furnizimit;
- Cilësia e tensionit; dhe
- Cilësia komerciale.

5.8.1 Kontinuiteti i furnizimit

Kontinuiteti i furnizimit është i ndërlidhur me disponueshmërinë e sistemit energjetik, përkatësisht paraqet numrin dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve për çdo konsumator brenda një viti.

Kontinuiteti i furnizimit me energji elektrike gjatë vitit 2017 është monitoruar nga ZRRE për të dy operatorët e sistemit: Operatorin e sistemit të transmetimit dhe Operatorin e sistemit të shpërndarjes (OSSH).

Kontinuiteti i furnizimit matet me anë të indekseve:

- SAIDI - Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjeve në sistem;
- SAIFI - Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve në sistem; dhe
- ENS - Energjia e pafurnizuar.

5.8.1.1 Indekset matëse të raportuara nga OST

Indekset matëse të raportuara nga KOSTT për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike për vitin 2017 janë të paraqitur më poshtë.

- SAIDI - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 4.29 orë;
- SAIDI - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 0.37 orë;
- SAIFI - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 0.56;
- SAIFI - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 0.46;
- ENS - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 4.847 GWh; dhe
- ENS - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 0.489 GWh.







Fig. 5.28 Indikatorët matës SAIDI, SAIFI dhe ENS për KOSTT për vitin 2017

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur indekset matëse të raportuara nga KOSTT për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike përgjatë viteve 2012 – 2017.







Fig. 5.29 Indikatorët SAIDI, SAIFI dhe ENS për KOSTT për periudhën 2011 - 2017

Sipas të dhënave të raportuara nga KOSTT për indeksin matës SAIDI, konstatohet se në total ky indeks ka rritje prej 6.86% gjatë vitit 2017 në krahasim me vitin 2016, e kjo kryesisht për shkak të punimeve të bëra në rrjetin e transmetimit. Duhet theksuar se te indeksi SAIDI gjatë vitit 2017 në krahasim me vitin 2016 kemi rritje të ndërprerjeve të planifikuara dhe atë për 26.65%, ndërsa kemi zbritje të ndërprerjeve të paplanifikuara prej -164.82%, që vërteton stabilitetin në operimin e rrjetit të transmetimit.

Për indeksin matës SAIFI, nga të dhënat e raportuara konstatohet se në total ky indeks ka zbritje prej -122.55% gjatë vitit 2017 në krahasim me vitin 2016, respektivisht kemi zbritje të këtij indeksi te ndërprerjet e planifikuara prej -119.64% dhe te ndërprerjet e paplanifikuara prej -126.09%.

Ndërsa sa i përket energjisë së pafurnizuar – ENS, gjatë vitit 2017 kemi rritje të këtij indeksi për 82.30% nga viti 2016, ku te ndërprerjet e planifikuara kemi rritje prej 172.76%, ndërsa zbritje te ndërprerjet paplanifikuara prej -135.17%. Rritja e këtij indeksi është kryesisht si rezultat i punimeve të kryera në rrjetin e transmetimit.

5.8.1.2 Indekset matëse të raportuara nga OSSH

Indekset matëse të raportuara nga OSSH mbi standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike për vitin 2016 janë të paraqitur më poshtë.

- SAIDI - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka 50.80 orë;
- SAIDI - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 50.18 orë;
- SAIFI - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 33.61 ;
- SAIFI - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 26.45;
- ENS - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 33.00 GWh; dhe
- ENS - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 33.48 GWh.



Fig. 5.30 Indekset matës SAIDI, SAIFI dhe ENS për OSSH për vitin 2017

Në figurat e mëposhtme kemi paraqitur indekset matëse të raportuara nga OSSH për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike përgjatë viteve 2011 – 2017



Fig. 5.31 Indikatorët SAIDI, SAIFI dhe ENS për OSSH për periudhën 2011-2017

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se indekset matëse SAIDI, SAIFI dhe ENS në vitin 2017 në përgjithësi janë përmirësuar krahasuar me vitin 2016, e kjo pasi që gjatë vitit 2016 OSSH ka realizuar numër më të madh të ndërprerjeve të planifikuara me qëllim të mirëmbajtjes së rrjetit elektrik.

Sipas të dhënave të raportuara për indeksin matës SAIDI gjatë vitit 2017, vërehet se ka përmirësim të këtij indeksi krahasuar me vitin 2016, e që sipas të dhënave vërehet se në përgjithësi në vitin 2017 kemi zbritje të ndërprerjeve për -30.38% në krahasim me vitin 2016. Duhet theksuar se gjatë analizave më detale të bëra për indeksin – SAIDI, vërehet se në vitin 2017 kemi zbritje për ndërprerjet e planifikuara prej -62.09% në krahasim me vitin 2016, ndërsa kemi rritje për ndërprerjet e paplanifikuara për 1.74% në vitin 2017 në krahasim me vitin 2016.

Nga analiza e bërë indeksit matës SAIFI, vërehet se gjatë vitit 2017 kemi përmirësim të këtij indeksi krahasuar me vitin 2016, e që sipas të dhënave vërehet se në vitin 2017 kemi zbritje të shpeshtësisë së ndërprerjeve të energjisë elektrike për konsumator – SAIFI dhe atë për -19.15% në krahasim me vitin 2016. Gjatë analizave më detale të bëra indeksit – SAIFI, vërehet se në vitin 2017 kemi zbritje të shpeshtësisë së ndërprerjeve të planifikuara për konsumator (SAIFI) për -31.60% në krahasim me vitin 2016, si dhe zbritje të shpeshtësisë së ndërprerjeve të paplanifikuara për konsumator për -3.3% në krahasim me vitin 2016.

Gjatë vitit 2017 energjia e pafurnizuar (ENS) në përgjithësi ka përmirësim krahasuar me vitin 2016, e që sipas të dhënave vërehet se në vitin 2017 kemi zbritje për -8.65% në krahasim me vitin 2016. Në vitin 2017 ka zbritje të energjisë së pafurnizuar për ndërprerje të planifikuara për -40.27% në

krahasim me vitin 2016, ndërsa ka rritje të energjisë së pafurnizuar për ndërprerje të paplanifikuara për 29.07%, në krahasim me vitin 2016.

5.8.2 Cilësia e tensionit

Cilësia e tensionit është e ndërlidhur me aspektin teknik të sistemit të energjisë elektrike dhe krahasohet ndaj tensionit nominal, që kryesisht gjatë kësaj periudhe është monitoruar përmes regjistrimit të ankesave të konsumatorëve lidhur me cilësinë e tensionit.

Gjatë vitit 2017 numri i ankesave të parashtruara nga konsumatorët lidhur me cilësinë e tensionit në OSSH ka qenë 1,175 ankesa, prej të cilave janë zgjidhur 1,051 apo 89%, në proces të shqyrtimit janë 21 apo 2%, ndërsa të pa zgjidhura kanë mbetur 103 ankesa apo 9%.



Fig. 5.32 Ankesat e konsumatorëve për cilësi të tensionit në vitin 2017

Më poshtë në figurë janë paraqitur ankesat e konsumatorëve për cilësi të tensionit sipas viteve, ku shihet se ka rritje të vazhdueshme të ankesave të konsumatorëve për cilësi të tensionit.



Fig. 5.33 Ankesat për cilësi të tensionit sipas viteve

Standardet e cilësisë së tensionit janë të përcaktuara në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, në Kodin e Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes së Shpërndarjes.

5.8.3 Cilësia komerciale

Cilësia komerciale përcakton efikasitetin dhe saktësinë e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve. Rregullimi i cilësisë komerciale merr parasysh marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet konsumatorëve dhe furnizuesit.

Me qëllim të analizimit të cilësisë komerciale, të dhënat e marra nga i licencuari janë paraqitur në dy kategori të cilat prekin drejtpërdrejt çështjet e konsumatorëve. Këto kategori janë:

- Kyçjet/lidhjet e reja, dhe
- Ankesat e konsumatorëve

5.8.3.1 Lidhjet e reja

Në standardet e cilësisë komerciale, përveç tjerash, hyjnë edhe lidhjet e reja, përmes së cilave evidentohet se sa shpejtë ndërmarrja e energjisë merr masa për realizimin e kyçjeve/lidhjeve të reja.

Gjatë vitit 2017 në KESCO janë regjistruar gjithsej 27,804 kërkesa të rregullta për lidhje të re për grupet tarifore 4, 5, 6, 7 dhe 8, kërkesa për lidhje të re të bartura nga viti paraprak kanë qenë 855, ndërsa gjatë vitit 2017 janë aprovuar 26,481 kërkesa për lidhje të re.

Nga të dhënat e KESCO-s shihet se nga numri i përgjithshëm i kërkesave për regjistrim të lidhjeve të reja më së shumti ka pasur kërkesa nga konsumatorët shtëpiak (grupi tarifor 5, 6 dhe 7) 22,500 apo 80.92%, kërkesa për regjistrim të lidhjeve të reja të grupit tarifor komercial 0.4 kV Kategoria II – grupi tarifor 4 kanë qenë 3,550 apo 12.77%, ndërsa kërkesa për grupit tarifor 8 - Ndriçimi publik kanë qenë 219 apo 0.79%. Prej numrit të përgjithshëm të kërkesave për lidhje të reja, 1,535 kërkesa apo 5.90% kanë qenë të kategorive të padefinuara, për shkak se konsumatorët në kërkesat e tyre nuk kanë specifikuar kategorinë e konsumatorit.

Gjithashtu shihet se nga numri i përgjithshëm i regjistrimeve të konsumatorëve në programin e faturimit “CCP”, konsumatorë shtëpiak janë 22,285 apo 84.15%, pasuar nga grupi tarifor 4 (0.4 kV Kategoria II – komercial) me 3,956 regjistrime apo 14.94%, si dhe grupi tarifor 8 (ndriçimi publik) me 8 regjistrime apo 0.52%. Duhet theksuar se numri më i lartë i regjistrimeve krahasuar me kërkesat për lidhje të reja është për shkak se kemi regjistrime të konsumatorëve të cilët janë bartur nga viti i kaluar dhe të cilët disa prej tyre janë regjistruar këtë vit.



Fig. 5.34 Lidhjet e reja sipas distrikteve për vitin 2017

Nga diagrami i mësipërm vërehet se për vitin 2017, nga numri i përgjithshëm i kërkesave për lidhje të reja, më së shumti kërkesa janë regjistruar në distriktin e Prishtinës prej 10,057 apo 36.17%, pasuar nga distrikti i Ferizajit prej 3,901 apo 14.03%, ndërsa më së paku kërkesa për lidhje të reja janë regjistruar në distriktin e Gjakovës prej 2,371 apo 8.53%. Gjithashtu, duhet theksuar se sa i përket regjistrimeve të lidhjeve të reja të konsumatorëve në programin e faturimit, nga numri i përgjithshëm, më së shumti regjistrime kanë qenë në distriktin e Prishtinës prej 9,522 apo 35.96%, pasuar nga distrikti i Ferizajit prej 3,587 apo 13.55%, ndërsa më së paku regjistrime janë evidentuar në distriktin e Gjilanit prej 2,280 apo 8.61%.

Duhet theksuar se gjatë vitit 2017 kemi pasur 9.49% kërkesa për lidhje të reja më shumë se sa në vitin 2016, dhe 5.04% më shumë regjistrime të konsumatorëve se sa në vitin 2016.

5.8.3.2 Pëlqimet Elektroenergjetike

Nga të dhënat e prezantuara shihet se gjatë vitit 2016 në KESCO janë parashtruar 804 kërkesa për Pëlqim Elektroenergjetik, ndërsa kërkesa të bartura nga viti 2015 kanë qenë 26, të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Tab. 5.27 Pëlqimet Elektroenergjetike për vitin 2017

Distriktet	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Prishtina	13	11	17	18	25	36	42	40	27	28	23	35	315
Mitrovica	3	1	10	7	11	7	6	9	7	8	7	4	80
Peja	12	10	9	7	15	10	14	7	15	13	19	9	140
Gjakova	7	11	18	19	1	15	18	7	5	12	3	3	119
Prizreni	9	6	8	8	15	12	12	12	11	8	11	7	119
Ferizaj	12	15	14	14	13	37	20	23	20	31	28	23	250
Gjilani	3	7	7	6	13	11	17	11	16	14	14	14	133
Gjithsej	**59**	**61**	**83**	**79**	**93**	**128**	**129**	**109**	**101**	**114**	**105**	**95**	**1,156**

Sipas tabelës së mësipërme vërehet se nga numri i përgjithshëm i kërkesave për Pëlqim elektroenergjetik për vitin 2017, në distriktin e Prishtinës janë regjistruar më së shumti kërkesa dhe atë 315 apo shprehur në përqindje 27.25%, pasuar nga distrikti i Ferizajit prej 250 apo 21.63%, ndërsa më së paku kërkesa ka pasur në distriktin e Mitrovicës prej 80 apo 6.92%.

Tab. 5.28 Pëlqimet Elektroenergjetike sipas distrikteve për vitin 2017

Distriktet	Kërkesa për PEE 2017	Të shqyrtuara	Në proces	Dërguar departamenteve tjera
Prishtina	315	282	9	24
Mitrovica	80	73	1	6
Peja	140	130	2	8
Gjakova	119	102	0	17
Prizreni	119	108	1	10
Ferizaj	250	228	11	11
Gjilani	133	117	6	10
Gjithsej	**1,156**	**1,040**	**30**	**86**

Nga tabela e mësipërme vërehet se nga 1,156 kërkesa të aplikuesve për Pëlqim Elektroenergjetik (PEE) janë shqyrtuar 1,040 kërkesa, ndërsa sipas të dhënave të KEDS 86 kërkesa tjera janë shqyrtuar por që sipas departamentit të Pëlqimeve Elektroenergjetike në kuadër të KEDS-it është konstatuar se këto kërkesa nuk kualifikohen si kërkesa për t'iu lëshuar Pëlqimi Elektroenergjetik, por janë kërkesa për shërbime tjera dhe janë përcjellë në departamente përkatëse, ndërsa 30 kërkesa të aplikuesve janë në proces të shqyrtimit.

Nga diagrami i mëposhtëm vërehet se kemi rritje të kërkesave të konsumatorëve për Pëlqime Elektroenergjetike.



Fig. 5.35 Kërkesat për Pëlqimet Elektroenergjetike për periudhën 2014 – 2017

5.8.3.3 Ankesat e konsumatorëve te furnizuesi - KESCO

Sipas të dhënave të furnizuesit KESCO, gjatë vitit 2017 numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve të regjistruara është 11,350 dhe të bartura nga viti i kaluar kanë qenë 1008 ankesa, ndërsa janë zgjidhur/përfunduar 11,359 ankesa.

Më poshtë është paraqitur grafiku i ankesave të konsumatorëve të regjistruara dhe të zgjidhura për vitin 2017 sipas distrikteve.



Fig. 5.36 Ankesat dhe numri i konsumatorëve sipas distrikteve, 2017

Nga figura e mësipërme shihet se përqindja më e lartë e ankesave të konsumatorëve të regjistruar te furnizuesi KESCO gjatë periudhës janar – dhjetor 2017 është në distriktin e Prishtinës 57.16%, pasuar nga distrikti i Pejës me 10.02%, ndërsa përqindja më e ulët është në distriktin e Gjakovës prej 4.78%. Duhet theksuar se numri më i madh i ankesave në distriktin e Prishtinës është kryesisht se Distrikti i Prishtinës ka edhe numrin më të madh të konsumatorëve në Kosovë.

Përqindja më e lartë e ankesave të konsumatorëve të zgjidhura nga KESCO në krahasim me numrin e përgjithshëm të ankesave të zgjidhura në nivel vendi është në distriktin e Prishtinës, dhe atë prej 56.37%, pasuar nga distrikti i Pejës me 10.51%, ndërsa përqindja më e ulët është në distriktin e Gjakovës dhe Gjilanit prej 4.60%.

Më poshtë është paraqitur tabela me numrin e ankesave të konsumatorëve të regjistruara dhe zgjidhura te furnizuesi KESCO për vitin 2017 sipas muajve.



Fig. 5.37 Ankesat e konsumatorëve në KESCO sipas muajve për periudhën janar - dhjetor 2017

Nga të dhënat vërehet se përqindja më e lartë e ankesave të përfunduara në raport me ankesat e regjistruara për vitin 2017 është realizuar në distriktin e Mitrovicës (raporti ankesa të përfunduara/ distriktin e Gjilanit me 94.40%. Duhet theksuar se në disa distrikte kemi përqindje më të lartë se 100% për arsye se përveç ankesave të regjistruara të asaj periudhe, distriktet kanë arritur t'i shqyrtojnë dhe zgjidhin edhe disa ankesa të bartura nga viti i kaluar.

Në figurën e mëposhtme kemi paraqitur numrin e ankesave të regjistruara dhe të përfunduara sipas natyrës së ankesave për periudhën janar – dhjetor 2017.



Fig. 5.38 Ankesat e konsumatorëve sipas natyrës për periudhën janar - dhjetor 2017

Më poshtë janë paraqitur përshkrimet e natyrës së ankesave:

B1 - Pagesë e pa regjistruar

B2 - Bilanci fillestar gabim

B3 - Mosmarrja e faturave

B4 - Mbilimiti

B5 - Ndryshim i paushallit

B6 - Lexim jo korrekt

B7 - Lexim jo i rregullt

B8 - Njehsori jo i saktë

B9 - Kërkesa për shlyerje të borxhit

B10 - Ngarkuar me TVSH

B11 - Rikthimi i humbjeve

B12 - Të tjera

Sipas të dhënave të KESCO, në vitin 2016 ankesat e konsumatorëve të regjistruara e të cilat kanë qenë lidhur me gabimet në lexim në pikën matëse (lexim jo korrekt dhe lexim jo i rregullt) kanë qenë 3,955 apo shprehur në përqindje 34.85% nga numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve të parashtruar, në vitin 2016 numri i ankesave që kanë qenë lidhur me gabimet në lexim të pikës matëse kanë qenë 4,504, si dhe në vitin 2015 kanë qenë 5,312. Nga kjo shihet qartë se numri i ankesave të konsumatorëve lidhur me gabimet në lexim të pikës matëse është në rënie e sipër dhe kjo fal mënyrës së re të leximit të pikës matëse me anë të pajisjes së dorës (ang. "Held Hand Unit"), e cila ka përmirësuar dukshëm leximin e pikave matëse dhe ka zvogëluar mundësinë e gabimeve gjatë leximit të pikës matëse.

Më poshtë është paraqitur figura me të dhënat e ankesave të zgjidhura nga KESCO për periudhën janar – dhjetor 2017, apo më saktësisht statusi i ankesave të zgjidhura.



Fig. 5.39 Statusi i ankesave të konsumatorëve të zgjidhura për periudhën janar - dhjetor 2017

Në figurën e mësipërme vërehet se KESCO nga 11,359 ankesa të zgjidhura të konsumatorëve, prej tyre 6,048 ankesa i ka aprovuar në favor të konsumatorëve apo 53.24%, ndërsa 5,311 i ka refuzuar, apo e shprehur në përqindje 46.76%.

Më poshtë është paraqitur raporti i ankesave të konsumatorëve të parashtruara në KESCO me numrin e konsumatorëve sipas muajve.

Tab. 5.29 Raporti i ankesave dhe numrit të konsumatorëve sipas muajve për vitin 2016

Muaji	Ankesa	Numri i konsumatorëve	Raporti ankesa/konsumator
Janar	1,720	537,765	0.32%
Shkurt	1,606	539,767	0.30%
Mars	1,432	541,481	0.26%
Prill	936	542,809	0.17%
Maj	878	545,019	0.16%
Qershor	730	547,028	0.13%
Korrik	756	549,139	0.14%
Gusht	692	551,456	0.13%
Shtator	559	553,637	0.10%
Tetor	646	556,035	0.12%
Nëntor	685	558,818	0.12%
Dhjetor	710	561,809	0.13%
Gjithsej	**11,350**	**6,584,763**	**0.17%**

Nga të dhënat e raportuara nga furnizuesi KESCO shihet se numri i ankesave të regjistruara gjatë vitit 2017 është 11,350 e që paraqet 2.02% të numrit total të konsumatorëve, gjegjësisht 0.17% ndaj numrit të përgjithshëm të faturave vjetore.

Numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve të regjistruara në vitin 2017 është 11,350, në 2016 është 11,180, në vitin 2015 ka qenë 12,926, ndërsa në vitin 2014 ka qenë 17,655 siç janë paraqitur në figurën e mëposhtme.



Fig. 5.40 Ankesat e konsumatorëve në KESCO sipas viteve

6 SEKTORI I ENERGJISË TERMIKE

Sektori i energjisë termike në Kosovë përbëhet nga katër sisteme: NQ Termokos – Prishtinë, NQ Gjakova – Gjakovë, NQ Termomit – Mitrovicë, dhe NQ në Zveçan. Ky sektor ka një shtrirje mjaft të kufizuar në shkallë vendore, që plotëson 3 - 5% të kërkesës së përgjithshme për ngrohje në Kosovë.

6.1 Zhvillimet kryesore në sektorin e energjisë termike

6.1.1 Zhvillimet në NQ Termokos

Furnizimi kualitativ dhe i qëndrueshëm me energji termike në vitet e fundit, ka bërë që të shtohet interesimi për përfshirje sa më të gjerë të konsumatorëve të qytetit të Prishtinës në sistemin e NQ Termokos. Në këtë kuptim, gjatë vitit 2017 është zhvilluar faza përgatitore e projektit për zgjerimin, rehabilitimin e rrjetit dhe modernizimin e pajisjeve përbërëse, që ka përfshirë fazën e tenderimit për ekzekutim dhe mbikëqyrje të punimeve ndërtimore dhe instaluese.

Komponentët kryesor të projektit:

- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues – zëvendësimi 3.4 km të tubacioneve;
- Zgjerimi i rrjetit – rrjet / tubacion i ri 3.6 km;
- Instalimi i 153 nënstacioneve termike – për 103 nënstacione ekzistuese zëvendësimi komplet i pajisjeve ekzistuese me pajisje të reja dhe 50 nënstacione të reja (aty ku zgjerohet rrjeti);
- Instalimi i 100 valvolave rregulluese (kontrolluese) të presionit diferencial.

Ky projekt, i cili vlerësohet rreth 8.8 mil.€, do të financohet kryesisht nga donacioni i Komisionit Evropian në vlerë prej rreth 8.3 mil. €, ndërsa Komuna e Prishtinës pritet të participoi me një vlerë dukshëm më të vogël (250,000 €), si dhe një shumë e vogël (rreth 250,000 €) vetëfinancim nga NQ Termokos.

Gjithashtu në fazën fillestare përgatitore është projekti i përkrahur nga KfW me të cilin planifikohet të përfshijë rehabilitimi dhe zgjerimin e rrjetit ekzistues e po ashtu rehabilitim-modernizim të nënstacioneve. Ky projekt parashihet të jetë në vlerë 10 mil € (ne faza 5 mil € + 5 mil.€), mjete që janë zotuar si donacion nga Gjermania, Luksemburgu dhe Suedia fonde që do të ndahen dhe menaxhohen përmes KfW.

Në kuadër të mbështetjes nga Qeveria Gjermane përmes KfW, gjatë vitit 2017 është përgatitur Master Plani i Zhvillimit të rrjetit / sistemit të NQ Termokos ku është elaboruar detajisht zhvillimi i rrjetit të NQ Termokos – zgjerimet e rrjetit dhe zgjerimi i bazës së konsumatorëve / shtimi i sipërfaqës ngrohëse, kapacitetet shtese prodhuese (sidomos te kogjenerimi).

Në kuadër të Programit MCM të SHBA-ve ("Millenium Challenge Corporation") i nënshkruar në shtator 2017, parashihet komponenta e instalimit të matësve të energjisë termike për konsumatorët e NQ Termokos, me synim që të kalohet në faturimin e bazuar në matjen e konsumit me ç' rast arrihet shfrytëzimi efikas i energjisë termike.

Vlen të theksohet se në prill 2017 me sukses ka përfunduar projekti për rekonstruimin dhe modernizimin e 50 nënstacioneve të energjisë termike të rrjetit të shpërndarjes. Ky projekt, që

kryesisht është financuar nga Qeveria gjermane përmes KfW, ka mundësuar përmirësim të dukshëm në cilësinë e furnizimit me energji termike në disa pjesë ku cilësia ka qenë më dobët, e gjithashtu efektet janë edhe në zvogëlimin e humbjeve të energjisë termike.

6.1.2 Zhvillimet në NQ Gjakova – Projekti i ndërrimit të lëndës djegëse dhe kogjenerimi

Sa i përket NQ Gjakovës, fillimisht duhet theksuar se, përkundër vështirësive financiare për sigurimin e sasive të mjaftueshme të lëndës djegëse – mazutit, falë subvencioneve nga buxheti i Kosovës, NQ Gjakova ka arritur që në fillim të nëntorit 2017 të startoj me prodhimin dhe furnizimin e konsumatorëve me energji termike.

Lidhur me projektin për Ngrohtoren e re me biomasë të NQ Gjakovës, vlen të përmendet se gjatë vitit 2017 ka vazhduar zhvillimi i projektit, më konkretisht është proceduar me fazën e tenderimit për ekzekutimin dhe mbikëqyrjen punimeve ndërtimore dhe instaluese. Ky projekt në vlerë prej rreth 12.5 milion €, përkrahet financiarisht nga Komisioni Evropian - Zyra në Kosovë përmes fondeve të IPA-2015.

Komponentët kryesor të projektit për ndërtimin e ngrohtores së re me biomasë janë:

- 2 njësi prodhuese vetëm të energjisë termike: me kapacitet 7 MW_{TH} dhe 2 MW_{TH};
- ndërsa njësia e tretë parashihet bashkëprodhim i energjisë termike dhe asaj elektrike me kapacitet prej 8 MW_{TH} dhe 1.57 MW_{EL}.;
- Instalimet e pajisjeve përkatëse të ngrohtores së re dhe kyçja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike respektivisht të energjisë elektrike.

6.2 Karakteristikat teknike të sistemeve të energjisë termike

Sektori i energjisë termike në Kosovë përbëhet nga 4 sisteme të ngrohjes qendrore me një kapacitet të instaluar i cili vlerësohet të jetë rreth 332 MW_{TH}. Ngrohtorja Termomit dhe e Zveçanit, për shkak të rrethanave të njohura, nuk i përgjigjen kërkesave për licencim / rregullim dhe monitorim nga ZRRE-ja, kështu që pamundësohet sigurimi i të dhënave përkatëse të azhurnuara; për këtë arsye në vijim paraqiten të dhëna të detajuara për NQ Termokos dhe NQ Gjakova.

6.2.1 Impiantet e gjenerimit

Impiantet për gjenerimin e energjisë termike të NQ Termokos përbëhen nga ngrohtorja kryesore me kapacitet të përgjithshëm të instaluar prej 120 MW_{TH}, dhe ngrohtorja ndihmëse në Qendrën klinike universitare me kapacitet prej 14 MW_{TH}. Me kyçjen e stacionit të ekstraktimit të energjisë termike në njësitë B1 dhe B2 të TC Kosova B, këtij kapaciteti i është shtuar edhe kapaciteti i instaluar i kogjenerimit prej 140 MW_{TH}. Duhet theksuar se kaldajat me mazut në ngrohtoren e NQ Termokos nuk janë dekomisionuar por ato do të shërbejnë si kapacitet rezervë për t'u aktivizuar në rastet e ndonjë avarie eventuale në njësitë e TC Kosova B.

Ngrohtorja e qytetit Gjakova është e pajisur me dy kaldaja me mazut me kapacitet të përgjithshëm të instaluar prej 38.6 MW_{TH} – njëra me kapacitet gjenerues 20 MW_{TH} dhe tjetra me kapacitet 18.6 MW_{TH}.

6.2.2 Sistemet e Shpërndarjes të Energjisë Termike

Sistemet e shpërndarjes së energjisë termike në Kosovë përbëhen nga rrjeti primar i shpërndarjes që shtrihet deri në pikën e furnizimit në nënstacione, dhe nga rrjeti sekondar i cili shtrihet nga pika e furnizimit në nënstacione gjer tek shfrytëzuesit përfundimtarë.

Rrjeti primar i shpërndarjes i NQ Termokosit ka një gjatësi prej rreth 38.5 km. Pjesë integrale e rrjetit të shpërndarjes është edhe stacioni i pompimit dhe shkëmbyesve të nxehtësisë i cili gjendet në Bregun e Diellit dhe 385 nënstacione aktive të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar.

Përpos rrjetit ekzistues të shpërndarjes, në vitin 2014 është ndërtuar edhe rrjeti i transportimit të energjisë termike TC Kosova B – NQ Termokos, në gjatësi prej rreth 10.5 km.

Rrjeti primar i shpërndarjes i NQ Gjakova shtrihet në gjatësi prej rreth 13.5 km. Pjesë përbërëse e këtij rrjeti janë edhe rreth 175 nënstacione aktive të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar.

Një përmbledhje e karakteristikave teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore të NQ Termokos dhe NQ Gjakova, paraqitet në tabelën më poshtë.

Tab. 6.1 Të dhënat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore

Kompania (Qyteti)	Kapaciteti i instaluar [MW]	Kapaciteti operacional [MW]	Rrjeti i shpërndarjes	
			Gjatësia e rrjetit [km]	Nr. i nënstacioneve
TERMOKOS (Prishtinë)	2 x 58 = 116 2 x 7 = 14 2 x 0,81 = 1.62 1 x 4 = 4 2 x 70 = 140 [Kogjenerimi]	2 x 58 = 116 2 x 7 = 14 1 x 4 = 4 2 x 70 = 140	36.5	347 (324 aktive)
Nën-total	275.6	274.0	36.5	347
NQ GJAKOVA (Gjakovë)	1 x 20 = 20 1 x 18.6 = 18.60	1 x 20 = 20	13.5	300 (251 aktive)
Nën-total	38.6	20.0	13.5	300
Total	314.2	294.0	50.0	647

6.3 Përformanca e ndërmarrjeve të energjisë termike

Në sezonin 2016/2017 NQ Termokos ka vijuar me një vazhdimësi të prodhimit dhe furnizimit të qëndrueshëm me energji termike, duke ofruar furnizim të pandërprerë 24h, që kryesisht është rrjedhojë e realizimit të projektit të kogjenerimit por edhe projekteve rehabilituese.

Sa i përket NQ Gjakovës duhet përmendur se falë Subvencioneve nga Qeveria e Kosovës dhe ndihmës financiare nga Komuna e Gjakovës ka arritur që në sezonin 2016/2017 të startoj prodhimin dhe furnizimin me energji termike. Megjithatë, për shkak të kufizimeve financiare, NQ Gjakova, ka qenë e detyruar të shkurtoj sezonin e ngrohjes në rreth 3 muaj (dhjetor 2016 – shkurt 2017). Gjithashtu ka ofruar furnizim me orar të reduktuar ditor si dhe ka reduktuar dukshëm sipërfaqen ngrohëse gjegjësisht numrin e konsumatorëve që u ka ofruar furnizim, duke u përqendruar në konsumatorët pagues më të rregullt si dhe në pjesët e rrjetit ku ka më pak humbje të energjisë termike.

6.3.1 Prodhimi, furnizimi dhe humbjet në NQ Termokos

- **Prodhimi i energjisë termike**

NQ Termokos e ka bazuar prodhimin e energjisë termike nga impiantet e kogjenerimit në TC Kosova B; në fakt në sezonin 2016/2017 i tërë prodhimi i energjisë termike ishte nga impiantet e kogjenerimit në TC Kosova B, ashtu që nuk ka qenë e nevojshme aktivizimi i kaldajave me mazut në Ngrohtoren e Termokosit.

Sasia e energjisë termike e ekstraktuar nga kogjenerimi në sezonin 2016/2017 ka qenë 225,438 MWh_{TH}. Ndërsa sasia e pranuar e energjisë termike në stacionin e shkëmbimit të nxehtësisë në NQ Termokos ka qenë 221,058 MWh_{TH}. Duhet theksuar se kjo paraqet një rritje prej rreth 13.5% në krahasim me prodhimin e sezonit të kaluar.

Të dhënat e përmbledhura të prodhimit të energjisë termike nga kogjenerimi, janë paraqitur në tabelën vijuese:

Tab. 6.2 Prodhimi i energjisë termike nga kogjenerimi

Energjia Termike nga Kogjenerimi – NQ Termokos, Sezoni 2016/2017			
Muaji	Njësia	En.term. e ekstraktuar (matur në TC Kosova B)/Prodhimi Bruto	En.term. e pranuar (matur në NQ Termokos)/Prodhimi neto
Tetor 2016	MWh_{TH}	13,499	12,801
Nëntor 2016	MWh_{TH}	33,966	33,392
Dhjetor 2016	MWh_{TH}	45,031	44,500
Janar 2017	MWh_{TH}	50,119	49,211
Shkurt 2017	MWh_{TH}	35,351	34,903
Mars 2017	MWh_{TH}	30,239	29,600
Prill 2017	MWh_{TH}	17,233	16,651
Gjithsej	MWh_{TH}	225,438	221,058

- **Furnizimi me energji termike**

NQ Termokos në sezonin 2016/2017 ka shënuar një përmirësim të dukshëm të sasisë dhe kualitetit të furnizimit me energji termike, që kryesisht është rrjedhojë e përmirësimit në vazhdimësi të prodhimit të energjisë termike dhe të përmirësimit të mirëmbajtjes dhe riparimeve në rrjet.

Furnizimi i konsumatorëve me energji termike (ngrohje qendrore), në këtë sezonë vlerësohet të jetë 196,462 MWh_{TH}, që paraqet rritje prej 31,493 MWH_{TH} ose rreth 19% në krahasim me sezonin paraprak 2015/2016 (164,969 MWh_{Th}). Ky furnizim i realizuar është mjaft i kënaqshëm dhe ka përmbushur planifikimet dhe objektivat për një furnizim të mjaftueshëm dhe cilësor.

- **Humbjet në sistem**

Sistemi i energjisë termike i NQ Termokos ka specifikat e veta sa i përket humbjeve në sistem, për shkak të integrimit të energjisë termike nga kogjenerimi. Pra, humbjet në rrjet përfshijnë dy komponentë: humbjet në rrjetin e transportit nga TC Kosova B – NQ Termokos dhe humbjet në rrjetin primar të shpërndarjes.

Humbjet në rrjetin e transportimit të energjisë termike TC Kosova B – NQ Termokos, në gjatësi prej 10.5km, janë përcaktuar nga matjet që janë kryer në stacionin e ekstraktimit të energjisë termike në TC Kosova B dhe në stacionin e pranimit të energjisë termike në NQ Termokos. Nga matjet që janë kryer në periudhën tetor 2016 – prill 2017 rezulton se humbjet sasiore në këtë periudhë janë 4,380 MWh_{TH} gjegjësisht 1.94%. Në tabelën vijuese janë dhënë detaje për humbjet në rrjetin e transportimit të energjisë termike.

Tab. 6.3 Humbjet e energjisë termike në rrjetin e transmetimit TC Kosova B – NQ Termokos

Energjia dhe humbjet 2016/2017	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Total
Energjia termike e ekstraktuar - matur në TC Kosova B [MWh]	13,499	33,966	45,031	50,119	35,351	30,239	17,233	225,438
Energjia termike e pranuar - matur në NQ Termokos [MWh}	12,801	33,392	44,500	49,211	34,903	29,600	16,651	221,058
Humbjet në sasi të energjisë [MWh]	698	574	531	908	448	639	582	4,380
Humbjet në [%]	5.17%	1.69%	1.18%	1.28%	1.46%	1.30%	1.30%	1.94%

Humbjet në rrjetin primar të shpërndarjes së energjisë termike normalisht përcaktohen nga matjet e energjisë termike në hyrje të rrjetit të shpërndarjes dhe nga furnizimi i energjisë termike në nënstacionet e konsumatorëve. Mirëpo, në mungesë të matjes së tërësishme të furnizimit të energjisë termike (në nënstacione), për llogaritjen e furnizimit janë bërë disa përafrime duke përdorur në radhë të parë parametrat si: kërkesën specifike për kapacitetin ngrohës (W/m^2) dhe orët e ngarkesës së plotë respektivisht konsumin specifik (kWh/m^2). Pra vlera e përllogaritur e konsumit është 196,462 $MWh_{Th.}$ Duke zbritur këtë vlerë të konsumit nga sasia e energjisë termike e futur në rrjetin e shpërndarjes (220,108 MWh_{Th}) rezulton se humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes për sezonin 2016/2017 janë 23,646 MWh_{Th}, që në përqindje paraqet 10.74%.

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat e përmbledhura për prodhimin, furnizimin dhe humbjet e tërësishme në sistem:

Tab. 6.4 Performanca energjetike e NQ Termokos – sezoni 2016/2017

NQ Termokos - Sezoni i Ngrohjes 2016-2017		
Përshkrimi	Njësia	Vlera
Prodhimi bruto në stabilimentet e ngrohtores	[MWh_{th}]	0.00
Prodhimi bruto ne stabilimentet e kogjenerimit	[MWh_{th}]	225,438.00
Humbja sasiore në rrjetin e transportit (TC Kosova B - NQ Termokos)	[MWh_{th}]	4,380.00
Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	[%]	1.94
Konsumi vetanak	[MWh_{th}]	950.00
Prodhimi neto i energjise termike	[MWh_{th}]	220,108.00
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	[MWh_{th}]	23,646.00
Humbjet në perqindje në rrjetin e shpërndarjes	[%]	10.74
Furnizimi I konsumatorëve me energji termike	[MWh_{th}]	196,462.00

6.3.2 Prodhimi, furnizimi dhe humbjet në NQ Gjakova

- **Prodhimi i energjisë termike**

NQ Gjakova, prodhimin e energjisë termike e ka bazuar në kaldajat me lëndën djegëse mazut. Siç u theksua më lartë, në sezonin 2016/2017 prodhimi i energjisë termike ka qenë mjaft i reduktuar – prodhimi bruto ka qenë 6,699 MWh_{TH} ndërsa prodhimi neto i energjisë termike 6,249 MWh_{TH}. Për këtë prodhim në këtë sezon janë shpenzuar 847 ton të lëndës djegëse mazut. Duhet të theksohet se, sipas të dhënave të raportuara nga ndërmarrja, është shënuar një efikasitet termik i ulët i ngrohtores rreth 70%.

- **Furnizimi me ngrohje**

NQ Gjakova gjatë sezonit 2016/2017 ka ofruar një furnizim të reduktuar, si pasojë e përgjysmimit të sezonit të ngrohjes dhe zvogëlimit të sipërfaqes ngrohëse. Furnizimi i konsumatorëve me energji termike në këtë sezon ka qenë 4,687 MWh_{TH}, sasi kjo që as për së afërmi nuk e plotëson kërkesën për ngrohje të gjithë konsumatorëve të kyçur në sistemin e NQ Gjakovës.

- **Humbjet në sistem**

Sa i përket humbjeve në prodhimin e energjisë termike, fillimisht duhet theksuar se, për arsye se disa matje mungojnë gjegjësisht konsiderohen si jo shumë të besueshme për shkak të vjetërsisë së pajisjeve, përcaktimi i humbjeve përfshin edhe disa parametra të paravlerësuar si p.sh efikasiteti i kaldajave dhe vlera e konsumit vetanak. Efikasiteti i kaldajave për prodhimin e energjisë termike është vlerësuar mjaft i ulët rreth 70%, që shkakton një humbje të konsiderueshme gjatë procesit të transformimit të energjisë së lëndës djegëse në energji termike, e cila vlerësohet të jetë 2,872 MWh_{TH}.

Humbjet në rrjetin primar të shpërndarjes llogariten si diferenca në mes të sasisë së energjisë termike të futur në rrjetin e shpërndarjes dhe furnizimit/konsumit. Në mungesë të matjes së sasisë së furnizuar të energjisë termike (në nënstacione), për llogaritjen e furnizimit janë bërë disa përafrime duke përdorur në radhë të parë parametrat si: kërkesën specifike për kapacitetin ngrohës (W/m^2) dhe orët e ngarkesës së plotë respektivisht konsumin specifik (kWh/m^2). Pra vlera e përllogaritur e konsumit është 4,678$MWh_{Th.}$ Duke zbritur këtë vlerë të konsumit nga sasia e energjisë termike e futur në rrjetin e shpërndarjes (6,249 MWh_{Th}) rezulton se humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes për sezonin 2016/2017 janë 1,571 MWh_{Th}, që në përqindje janë rreth 25%.

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat e përmbledhura për prodhimin, furnizimin dhe humbjet e tërësishme në sistem.

Tab. 6.5 Performanca energjetike e NQ Gjakova

NQ Gjakova - Sezoni i Ngrohjes 2016-2017		
Përshkrimi	Njësia	Vlera
Sasia e lendës djegëse -mazutit	[ton]	847.00
Vlera kalorifike	[MWh_{th}/ton]	11.30
Energjia e futur nga lënda djegëse -mazuti	[MWh_{th}]	9,571.10
Efikasiteti i kaldajave	[%]	70.00
Prodhimi bruto i energjisë termike	[MWh_{th}]	6,699.77
Konsumi vetanak	[MWh_{th}]	450.00
Prodhimi neto i en.termike / Energjia e futur në rrjetin e shpërndarjes	[MWh_{th}]	6,249.77
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	%	1,562.00
Humbjet në përqindje	[MWh_{th}]	25.00
Furnizimi i konsumatorëve me energji termike	[MWh_{th}]	4,687.00

6.4 Prodhimi, furnizimi dhe humbjet e gjithmbarshme të energjisë termike

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat e prodhimit, furnizimit dhe humbjeve në sistem të përmbledhura për tërë sektorin e energjisë termike.

Tab. 6.6 Performanca energjetike e sektorit të energjisë termike – sezoni 2016/2017

Sektori i Energjisë Termike - Sezoni 2016/2017				
Përshkrimi	Njësia	NQ Termokos	NQ Gjakova	Gjithsej
Prodhimi bruto i energjisë termike	[MWh_{th}]	225,438	6,700	232,138
Humbjet në rrjetin e transportit	[MWh_{th}]	4,380	0	4,380
Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	[%]	1.94	0.00	1.94
Konsumi vetanak	[MWh_{th}]	950	450	1,400
Prodhimi neto i energjise termike	[MWh_{th}]	220,108	6,250	226,358
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	[MWh_{th}]	23,646	1,562	25,208
Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes	[%]	10.74	25.00	11.14
Furnizimi I konsumatorëve me energji termike	[MWh_{th}]	196,462	4,687	201,149

6.5 Faturimi, arkëtimi dhe sipërfaqja e ngrohjes

6.5.1 Faturimi dhe arkëtimi

Në lidhje me faturimin fillimisht duhet përmendur se edhe në sezonin 2016/2017, faturimi i konsumatorëve të energjisë termike kryesisht ka qenë i bazuar në sipërfaqen e ngrohjes (për metër katror). Megjithëse faturimi sipas konsumit ka shënuar një rritje krahasuar me sezonin e kaluar (nga 51 në 97 konsumatorë), numri i konsumatorëve të faturuar sipas konsumit të matur të energjisë termike është i kufizuar në rreth 97 konsumatorë, kryesisht komercial e institucional.

NQ Termokos në sezonin 2016/2017 ka shënuar një rritje të faturimit në krahasim me sezonin e kaluar 2015/2016, që është kryesisht rrjedhojë përmirësimit të vazhdueshëm të furnizimit. Faktikisht faturimi në sezonin 2016/2017 ka qenë 5,970,336 €, që paraqet një rritje prej 501,392 € në krahasim me sezonin 2015/2016 (5,468,944 €). Megjithatë edhe në këtë sezon nuk është arritur niveli i planifikuar i faturimit kryesisht për shkak të: i) zbritjeve në faturim për shkak të ditëve pa ngrohje dhe për shkak të kualitetit të dobët të furnizimit (në disa lagje të Prishtinës); dhe ii) zbritjet në sipërfaqen ngrohëse pas verifikimit në terren.

Si rrjedhojë e faturimit të shtuar edhe arkëtimi si shumë monetare ka pësuar një rritje në krahasim me sezonin e kaluar – në sezonin 2016/2017 shuma e arkëtuar ka qenë 3,950,382 € ndërsa shuma e arkëtuar në sezonin 2015/2016 ka qenë 3,771,663 €, që paraqet një rritje prej 178,719 € ose 4.52%. Përkundrazi nëse i referohemi përqindjes së arkëtimit, në këtë sezon vërehet një rënie e vogël e përqindjes së arkëtimit në krahasim me sezonin e kaluar – në sezonin 2016/17 përqindja e arkëtimit ishte 62.24% ndërsa në sezonin 2015/16 përqindja e arkëtimit ka qenë 63.86% që paraqet një rënie prej 1.62%. Megjithatë siç mund të shihet nga tabela dhe diagramet më poshtë, me startimin e kogjenerimit, arkëtimi në vazhdimësi ka shënuar rritje.

Sa i përket NQ Gjakovës, siç u theksua më lartë, gjatë sezonit 2016/2017 ka ofruar një furnizim të reduktuar, si pasojë e përgjysmimit të sezonit të ngrohjes dhe zvogëlimit të sipërfaqes ngrohëse. Rrjedhimisht faturimi në këtë sezon ka qenë mjaft i vogël – 242,069 €, ndërsa arkëtimi si shumë monetare ka arritur vlerën prej 190,993 €, që paraqet një shkallë mjaft të lartë të arkëtimit prej 79%.

Detajet në lidhje me faturimin dhe arkëtimin janë treguar në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tab. 6.7 Faturimi dhe arkëtimi– sezoni 2016/2017

Sezoni i ngrohjes 2016/2017	Sipërfaqja ngrohëse [m^2]	Pjesëmarrja në përqindje	Faturimi perfshirë TVSH [€]	Arkëtimi perfshirë TVSH [€]	Shkalla e arkëtimit [%]
NQ "Termokos" Prishtina					
Amvisëri	681,197	57.54%	2,963,185	1,379,704	46.56%
Komercial e Institucional	502,752	42.46%	3,384,745	2,570,678	75.95%
Gjithsej	1,183,949		6,347,930	3,950,382	62.23%
NQ "Gjakova" Gjakovë					
Amvisëri	27,215	37.83%	77,106	61,325	79.53%
Komercial e Institucional	44,718	62.17%	164,963	129,668	78.60%
Gjithsej	71,933		242,069	190,993	78.90%



Fig. 6.1 Faturimi dhe arkëtimi NQ Termokos dhe NQ Gjakova – sezoni 2016/2017

6.5.2 Sipërfaqja për ngrohje

NQ Termokos, në sezonën 2016/2017 ka pasur sipërfaqen e përgjithshme ngrohëse të konsumatorëve prej 1,235,382 m^2 prej, që paraqet një rritje prej 59,767 m^2 ose rreth 5% në krahasim me sipërfaqen ngrohëse në sezonin 2015/2016 (1,175,615 m^2).

Ndërsa NQ Gjakova, për arsyet e përmendura më lartë, në sezonin 2016/2017 dukshëm ka zvogëluar sipërfaqen ngrohëse në vetëm 71,933 m^2.

Në grafiket e mëposhtëm paraqiten sipërfaqet ngrohëse të NQ Termokos dhe NQ Gjakova, të ndara sipas grupeve të konsumatorëve.



Fig. 6.2 Sipërfaqja ngrohëse sipas grupeve të konsumatorëve në sezonin 2016/2017

7 SEKTORI I GAZIT NATYROR

7.1 Perspektiva e zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Kosovë

Përkundër faktit se në Kosovë nuk ekziston infrastrukturë funksionale dhe tregu i gazit natyror, Kuvendi i Kosovës, me qëllim të hapjes së perspektivës së zhvillimi të sektorit të gazit natyror dhe përmbushjes së obligimeve që Kosova i ka ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë, në qershor 2016, në kuadër të pakos së ligjeve të energjisë, ka miratuar Ligjin për Gazin Natyror, Nr.05/L-082.

Ligji për gazin natyror shtron bazat për kornizën ligjore dhe rregullative për transmisionin, shpërndarjen, deponimin dhe furnizimin me gaz natyror dhe për operimin e sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes së gazit. Rrjedhimisht me këtë ligj përcaktohet organizmi dhe funksionimi i sektorit të gazit natyror dhe qasja në rrjetet dhe tregun e gazit.

Strategjia e energjisë e Kosovës 2017-2026 (e miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 26 janar 2018) në Objektivin 4 ka përfshirë Zhvillimin e Infrastrukturës së gazit natyror, përmes lidhjes (kyçjes) me projektet e infrastrukturës së gazit në rajonin e Evropës Juglindore, sidomos me projektin e gazsjellësit TAP ("Trans-Adriatik-Pipeline" – Gazsjellësi Përtej Adriatikut) dhe me Unazën e Gazit të Komunitetit të Energjisë. Lidhur me këtë duhet theksuar se projekti i gazifikimit respektivisht zhvillimit të infrastrukturës së gazit është renditur në listën *e projekteve prioritare infrastrukturore - fusha e energjisë, të miratuar nga Këshilli Kombëtar për Investime dhe nga Qeveria e Kosovës.*

Vlerësohet se projekti i gazsjellësit TAP do ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Komunitetin e Energjisë respektivisht në rajonin e Evropës Juglindore, duke ofruar mundësi për lidhjen e projekteve të planifikuara rajonale si gazsjellësi Jon-Adriatik dhe ALKOGAP, dy këto projekte që e plotësojnë të ashtuquajturën 'Unaza e Gazit e Komunitetit të Energjisë'.

TAP aktualisht është në fazën e ndërtimit (ka filluar në fillim të vitit 2016). Planifikohet që në 2019 të fillojnë rrjedhat e para të gazit përmes TAP, ndërsa në 2020 operimi i plotë i gazsjellësit TAP. Kapaciteti fillestarë i TAP planifikohet të jetë 10 miliardë metër kub (bcm) për vit, me mundësi shtimi gjer në 20 bcm për vit. TAP do lejoj kyçjet interkonektive (intekonekcionet) përgjatë gazsjellësit për të furnizuar me gaz projektet tjera regjionale. Pra me marrëveshjet shtetërore me shtetet "nikoqire" (Greqia, Shqipëria dhe Italia) janë para-përcaktuar vendet e kyçjes dhe sasitë respektivisht kapacitetet e gazit.

7.1.1 Projekti: Gazsjellësi Shqipëri – Kosovë (ALKOGAP – "Albania-Kosovo Gas Pipeline")

Është vlerësuar si një opsion i favorshëm lidhja e Kosovës përmes Shqipërisë me projektet TAP respektivisht IAP. Në këtë drejtim Kosova bashkarisht me Shqipërinë kanë aplikuar me një projekt të përbashkët për gazin natyror për t'u përfshirë në listën e Projekteve të Interesit për Komunitetin e Energjisë (PECI – "Projects of Energy Community Interest"). Furnizimi me gaz parashihet të bëhet direkt nga gazsjellësi TAP ose përmes gazsjellësit IAP. Pra projekt-propozimi është hartuar bashkarisht, duke përfshirë të dhënat dhe informatat specifike për të dy vendet. Siç mund shihet në figurën e mëposhtme ky projekt paraqet një devijim nga koncepti fillestar".



Fig. 7.1 Projektet e Infrastrukturës rajonale të gazit dhe opcionet për kyçjen e Kosovës (përshirë ALKOGAP)

7.1.2 Detajet e projektit ALKOGAP

Ky Projekt, me gjatësi të përgjithshme rreth 260km, synon të krijojë një rrugë të re të furnizimit për gazin natyror nga Lindja e Mesme dhe Rajoni i Kaspikut, përmes gazsjellësit TAP, drejt zonës veriore të Shqipërisë, Kosovës e më tutje drejt shteteve tjera të regjionit.

Linja e gazsjellësit do të vlerësohet në dy skenarë:

1. Lezhe- Prishtinë: Ky skenar pre-supozon se projekti i gazsjellësit IAP avancon në fazën e zbatimit dhe furnizimi bëhet përmes këtij gazsjellësi;
2. Fier-Lezhë-Prishtinë: Ky skenar do të konsiderohet në rast se haset në mos progres me zbatimin e IAP-it, pra në këtë rast parashihet furnizimi me gaz direkt nga gazsjellësi TAP.

Projekti, do të krijonte parakushtet për zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve të gazit natyror të Shqipërisë dhe krijimin dhe zhvillimin e tregjeve të gazit natyror të Kosovës në nivelin e parashikuar vjetor prej 2 bcm (1- 1.3 bcm për Shqipërinë dhe 0.5-0.7 bcm për Kosovën). Kostoja e projektit vlerësohet të jetë rreth 200 milion €.

<u>Statusi aktual i projektit ALKOGAP</u>

Pas vlerësimit të Grupit Punues të Komunitetit të Energjisë për "PECI", sipas kritereve të përcaktuara të vlerësimit, ky projekt është kualifikuar për listën "PECI", e cila listë është miratuar nga Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, në fund të vitit 2016.

Shqipëria dhe Kosova po ashtu kanë aplikuar bashkërisht në WBIF – "Western Balkans Investment Framework" për mbështetje financiare të projektit ALKOGAP dhe Komiteti drejtues i WBIF ka vendosur që nga platforma WBIF të akordohen 300 mijë euro për të përgatitur Studimin e Parafizibilitetit. Institucion financiar udhëheqës është Banka Evropiane për Zhvillim (EBRD). Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017 janë hartuar Termat e Referencës për përgatitjen e Studimit të Parafizibilitetit i cili pritet të filloj në gjysmën e parë të vitit 2018.

Duhet theksuar se ZRRE në bashkëpunim me MZHE kanë dhënë inputet përkatëse lidhur me hartimin e projekt-propozimit për projektin ALKOGAP, si dhe në punën e Grupit punues të Komunitetit të Energjisë për "PECI". Gjithashtu ZRRE merr pjesë aktivisht në punën e Komunitetit të Energjisë, më konkretisht në Grupin Punues të Gazit të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë dhe Forumin e Gazit.

Adresat e ZRRE-së

Zyra e Rregullatorit për Energji
Rruga: Dervish Rozhaja nr. 12
Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 247 615
Fax: +381 (0) 38 247 620
Email: info@ero-ks.org

Web: www.ero-ks.org

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:

Tel: +381 (0) 38 247 615 lok. 101

Sekretaria:

Tel: + 381 (0) 38 247 615 lok. 104

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve:

Tel. + 381 (0) 38 247 615 lok. 116 dhe 125

Email: ankesa.dmk@ero-ks.org